



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 201 Akti

Nr. 352 Vendimi
Tiranë, më 1.3.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Relator
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 24.2.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*) Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Iliba Bezati**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila në seancën dëgjimore publike, të datës 24.2.2021, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Znj. Iliba Bezati, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*. Në këto kushte, ka filluar procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 17.9.2018, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Lulzim Hamitaj dhe Brunilda Bekteshi.
- iv. Trupi gjykues i lartpërmendur, pasi administroi dhe analizoi të tria raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 – 44, të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 24.9.2018 dhe vendimin nr. 1/1, datë 23.1.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Olsi Komici, gjithashtu, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Në vlerësim të provave të administruara përgjatë procesit të rivlerësimit për subjektin znj. Iliba Bezati, trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 14.1.2021, vendosi të mbyllë fazën e hetimit administrativ dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, të çmojë që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohet në të tria kriteret e rivlerësimit, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
- vi. Në datën 15.1.2021, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën e barrës së provës – për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.
- vii. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen përkatëse në Komision, ka kërkuar kohë shtesë për shkaqe objektive dhe ka paraqitur shpjegimet dhe parashtrimet e veta, brenda

afatit të ricaktuar, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

- viii. Gjithashtu, në datën 15.2.2021, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 24.2.2021, duke e njoftuar përmes postës elektronike, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin e Komisionit, znj. Iliba Bezati, ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, të cilat i ka paraqitur edhe me shkrim, së bashku me dokumentacionin provues përkatës.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 24.2.2021 u mbyll, për të rifilluar më 1.3.2021 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ kryesisht.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, së bashku me argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (viii) faktet e njohura botërisht.

VLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*

➤ *bashkëshorti i subjektit ka përfituar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mundesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

A. RIVLERËSIMI I KRITERIT TË PASURISË

1. Apartament banimi me sipërfaqe 82 m², në Vlorë

1. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003, me çmim blerje 1,900,000 lekë dhe me burim krijimi të ardhurat nga kursimet në vite nga familja e origjinës së bashkëshortit dhe, më pas, në deklaratën *Vetting* vlera e saj është specifikuar 6,000,000 lekë dhe burimi i krijimit të pasurisë është deklaruar nga të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit e të bashkëshortit, kursimet familjare dhe kursimet e prindërve të bashkëshortit.
2. Apartamenti në fjalë është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes me nr. ***, datë 8.3.2002, me një çmim prej 1,900,000 lekësh, por në këtë kontratë janë përfshirë edhe kostot e blerjeve shtesë, të disa materialeve hidrosanitare, pllakave dhe pajisjeve të mobilimit të banesës, kundrejt një vlere totale prej 4,100,000 lekësh, shumë e cila nuk është përfshirë në çmimin e shitjes së banesës¹.
3. Lidhur me këtë shitblerje, pasi i janë kërkuar qartësime nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se çmimi i blerjes së apartamentit ka qenë 1,900,000 lekë, ndërsa shuma prej 6,000,000 lekësh² ka qenë shuma e shpenzuar në total, së bashku me vlerën e mobilimit të banesës. Gjithashtu, subjekti është shprehur se çmimi prej 1,900,000 lekësh ka qenë çmimi i pasurisë sipas tregut të lirë të kohës dhe, për këtë qartësim, i ka bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, edhe nëntë kontrata të ngjashme shitblerjeje në Vlorë, për apartamente me të njëjtën përbërje (dy dhoma e kuzhinë), në të cilat çmimi i shitjes varionte në vlerat 200,000 lekë – 1,950,000 lekë.
4. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin që vijon:
 - i. Kontratë shitblerjeje me nr. ***, datë 8.3.2002, në të cilën pala shitëse N., V., J. dhe E. D. i kanë shitur bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. L. B., pasurinë e llojit apartament me nr. pasurie ***, të ndodhur në z. k. ***, kundrejt çmimit 1,900,000 lekë³. Palët kanë rënë dakord në këtë kontratë për blerjen gjithashtu të materialeve

¹ Sipas kontratës së shitblerjes, vlera prej 4,100,000 lekësh nuk përfshihet në çmimin e shitjes së banesës.

² Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije gjithashtu se në DIPP-në e vitit 2003 nuk ka pasur formularë për deklarimin e vlerës së investuar në mobilim apo arredim, si dhe nga ILDKPKI-ja nuk i është kërkuar të deklarojë vlerën e apartamentit së bashku me vlerën e investimeve në të, për këtë arsye ka deklaruar vetëm çmimin e blerjes.

³ Shuma prej 1,900,000 lekësh është likuiduar jashtë zyrës noteriale, sipas kontratës së shitjes. Ndërkohë që rezultoi se shuma prej 6,000,000 lekësh të jetë bërë me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së nga llogaria e shtetasve M. ose O. B. në favor të palës shitëse.

hidrosanitare, pllakave dhe pajisjeve të mobilimit të banesës që kapin shumën prej 4,100,000 lekësh, shumë kjo e cila nuk përfshihet në çmimin e shitjes.

- ii. Certifikatë për vërtetimin e pronësisë së datës 25.11.2004, për pasurinë e llojit “apartament” me sip. 82 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, regjistruar në emër të z. L. B..
- iii. Transaksion bankar i BKT-së, datë 13.3.2002, për kreditimin e vlerës prej 6,000,000 lekësh nga llogaria e shtetasve M. ose O. B.⁴ në llogarinë e z. N. ose znj. V. D. me përshkrimin “blerje shtëpie”.
- iv. ZVRPP-ja Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2018 dhe ASHK-ja Vlorë, me shkresat nr. *** prot., datë 29.10.2019 dhe nr. *** prot., datë 22.1.2020, kanë konfirmuar pasurinë e llojit “apartament” me sip. 82 m², z. k. ***, me nr. pasurie ***, në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. L. B..

1.1. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

5. Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, për të qartësuar dhe specifikuar konkretisht pjesët përbërëse të secilës pagesë të kryera për këtë apartament dhe burimin e ligjshëm për shumat përkatëse të secilit kontribuues.
6. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit bëri me dije se kontributi i saj dhe i bashkëshortit ka pasur si burim të ardhurat e realizuara nga pagat e tyre deri në atë kohë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se prindërit e bashkëshortit kanë pasur të ardhura: (i) nga pagat e tyre deri në daljen në pension; (ii) nga pensionet e përfituara nga shteti shqiptar; (iii) pensioni i përfutur nga shteti grek i vjehrrit të saj; (iv) të ardhura nga shitja e pasurive të trashëguara nga vjehrra e subjektit të rivlerësimit, znj. M. B..
7. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se kontributi i prindërve të bashkëshortit, i dhënë në mars të vitit 2002 për blerjen e apartamentit në fjalë, ka qenë në masën totale prej 5,307,404 lekësh⁵. Kjo shumë ka qenë pjesë e të ardhurave të përfituara nga vjehrra M. Bezati⁶ nga shitja e pjesëve takuese të saj mbi pasuritë e paluajtshme, të përfituara prej kësaj të fundit nga trashëgimia ligjore dhe dhurimi, nga ku ka përfutur shumën totale prej 6,463,220 lekësh, të detajuara si vijojnë:
 - a. shuma prej 19,400 USD (e konvertuar në shumën 2,838,220 lekë)⁷ nga shitja e truallit me sip. 9,700 m², pjesa takuese 1/5 e çmimit total prej 97,000 USD, referuar kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., datë 22.10.1997;
 - b. shuma prej 2,500,000 lekësh nga shitja e pjesës takuese 1/2 të pasurisë ndërtesë dykatëshe (ish-hoteli i punëtorisë), të çmimit total prej 5,000,000 lekësh, referuar kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 21.6.2001;
 - c. shuma prej 1,125,000 lekësh nga shitja e pjesës takuese të truallit me sip. 957 m², pjesa takuese 1/4 e çmimit total prej 4,500,000 lekësh referuar kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 21.6.2001.

⁴ Në mandatin e transfertës bankare rezultojnë të ketë firmosur z. L. B..

⁵ Nga të ardhurat e realizuara prej tyre nga shitja e pasurive të paluajtshme në masën 6,463,220 lekë, shuma prej 5,307,404 lekësh iu është dhënë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit për blerjen e apartamentit në Vlorë. Diferencën prej 1,100,000 lekësh, subjekti i rivlerësimit ka shtuar se shtetasit O. dhe M. B. ia kanë dhënë në vitin 2005 për blerjen e apartamentit në Tiranë.

⁶ Njerka e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

⁷ Kursi i këmbimit 1 USD = 146.3 lekë në vitin 22.10.1997. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar konvertimin në vlerën 2,854,904 lekë (kursi këmbimit 1 USD = 147.16 lekë).

8. Lidhur me të ardhurat e realizuara nga znj. M. B., nga shitjet e sipërcituara, janë përlllogaritur dhe zbritur nga Komisioni, detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi⁸ dhe ka rezultuar se të ardhurat *neto* të realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme në fjalë kanë qenë në total në shumën 6,305,573 lekë.
9. Sa i përket pagimit të detyrimeve tatimore përkatëse për të ardhurat e realizuara nga shitjet e pasurive të sipërcituara, ka rezultuar se për pasurinë truall me sip. 9,700 m², në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dy faqe të regjistrit të ZVRPP-së Lezhë, nga ku konstatohet kalimi i kësaj pasurie nga nr. ind. *** (në emër të bashkëpronarëve K.), në nr. ind. ***, në datën 27.10.1997 sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., datë 22.10.1997, me çmimin 97,000 USD dhe pronari i ri P. F. Sh., çka përputhet me kontratën e shitblerjes së paraqitur. Lidhur me dy pasuritë e tjera në pikat b) dhe c), subjekti i rivlerësimit ka depozituar praktikën nga ZVRPP-ja Lezhë, nga ku është konstatuar kalimi i pronësisë së tyre në favor të blerësit N. Ç., provuar kjo me kartelat e pasurive përkatëse me sip. 957 m² dhe 300 m², në z.k. ***, në emër të këtij të fundit.
10. Në ligjin nr. 7786, datë 27.1.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të hipotekës nuk regjistrojnë kalimin e pronësisë pa u paraqitur dokumenti që vërteton pagimin e tatimit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni”*. Nisur nga sa më sipër, për sa kohë pasuritë e sipërcituara janë regjistruar në emër të blerësve përkatës, konsiderohet se janë përmbushur edhe detyrimet tatimore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi asokohe.
11. Nga analiza e dokumentacionit të administruar nga Komisioni dhe dokumentacionit të sjellë nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka rezultuar se të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, për periudhën 1994 – 2001, kanë rezultuar në total në vlerën 1,968,010 lekë⁹. Komisioni ka përlllogaritur gjithashtu shpenzimet jetike gjatë periudhës 1994 – 2001, në shumën prej 1,159,351 lekësh¹⁰.
12. Komisioni i ka drejtuar sërish pyetje subjektit të rivlerësimit lidhur me mënyrën dhe vendin ku janë mbajtur shumat monetare të përfituara nga vjehrra e saj, znj. M. B., nga shitja e pasurive të paluajtshme, përgjatë periudhës nga përfitimi deri në momentin e përdorimit të tyre për blerjen e apartamentit në fjalë, në mars të vitit 2002. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, datë 28.4.2020, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Shumat janë depozituar në sistemin bankar, një pjesë në BKT dhe një pjesë janë mbajtur në banesë nga ana e vjehrrës M. B., sa ajo kujton pasi ka kaluar një kohë e gjatë”*.
13. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur pyetësorit nr. 4, shkresën e BKT-së Dega Vlorë me nr. *** prot., datë 24.1.2019, në të cilën banka ka vërtetuar se shtetasit O. ose M. B. kanë pasur një llogari depozite në BKT, me vlerën 6,000,000 lekë, të mbyllur në datën

⁸ Shuma prej 72,500 lekësh për kontratat e vitit 2001, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe 85,146 lekë për kontratën e vitit 1997, referuar ligjit nr. 8189, datë 30.1.1997, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1673, datë 20.12.1996, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, ndryshuar.

⁹ Këtu janë përlllogaritur edhe të ardhurat e vitit 2000, në të cilën subjekti i rivlerësimit ka qenë me raport paaftësie për periudhën janar – prill 2000 dhe me raport leje lindje korrik 2000 – maj 2001 (ku janë bërë përlllogaritjet në masën 70% të të ardhurave të vitit të mëparshëm për raportin e paaftësisë dhe 80% të lejes së lindjes për 150 ditët e para dhe më pas me 50%).

¹⁰ Shpenzimet jetike janë përlllogaritur për 2 persona (subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti) deri në korrik të vitit 2001 dhe për 3 persona në vijim. Për periudhën 1994 – 1996, shpenzimet jetike janë përlllogaritur në masën 70% të të ardhurave, më pas periudha 1997 – 1999, në masën 5,000 lekë/muaj për person dhe më pas sipas standardit të përdorur nga ILDKPKI-ja, bazuar në shkresat e dërguara nga INSTAT-i pranë kësaj të fundit. Për personat e tjerë të lidhur O. dhe M. B. nuk janë përlllogaritur shpenzimet jetike, duke qenë se të ardhurat e marra në konsideratë janë me burim nga shitja e pasurive të paluajtshme. Shpenzimet jetike për këta të fundit (periudha 1998 – tetor 2005) janë përlllogaritur në tabelën nr. 2, ku përcaktohet mundësia e tyre për dhurimin e shumë 2,700,000 lekë, në vitin 2005.

13.3.2002. Banka ka sqaruar gjithashtu se dokumentacioni për periudhën para vitit 2005 është asgjësuar për shkak të kalimit të afateve ligjore për ruajtjen e dokumentacionit¹¹.

Tabela nr. 1 – Përlllogaritja e burimeve të përdorura për blerjen e apartamentit

Përshkrimi	Shuma
Blerje apartamenti në Vlorë	(6 000 000)
Të ardhura nga shitja e pasurive të M. B. deri në vitin 2001	5 307 404
Të ardhura nga pagat SR dhe bashkëshorti për periudhën 1994-2001	1 968 010
Shpenzime jetese 1994-2001	(1 055 539)
Rezultati	219 875

14. Në konkluzion të hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri Komisioni i ka njoftuar subjektit rezultatet që vijojnë:
- i. Duket se ka mospërputhje ndërmjet vlerës së deklaruar të pasurisë në DIPP-në e vitit 2003 – ku vlera është deklaruar 1,900,000 lekë – krahasuar me vlerën në deklaratën *Vetting* dhe kontratën e shitblerjes së pasurisë prej 6,000,000 lekësh.
 - ii. Duket se ka mospërputhje midis deklaramit të burimit të krijimit të kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2003 – ku burimi është deklaruar nga kursimet e familjes së origjinës së bashkëshortit – krahasuar me deklaramin në deklaratën *Vetting*, ku përmenden të ardhurat nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, kursimet familjare dhe kursimet e prindërve të bashkëshortit.
 - iii. Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 burimin e të ardhurave të shumës prej 4,100,000 lekësh, të përdorura për blerjen e materialeve hidrosanitare, pllakave dhe pajisjeve të mobilimit të banesës.
 - iv. Duket se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur kanë pasur mundësi në vitin 2002, për blerjen e kësaj pasurie me burime të ligjshme financiare, ndonëse nuk rezultojnë e provuar pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga shitjet e pasurive të paluajtshme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

15. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, është shprehur se: *“Në DPV-në e vitit 2003 kam deklaruar vlerën e apartamentit vetëm si pasuri e paluajtshme në shumën 1,900,000 lekë, duke e veçuar këtë vlerë nga vlera e mobilimit, e arredimit apo e pajisjeve të blera, pasi në DPV-në e vitit 2003 formulari nuk ka pasur rubrikë që duhet ta plotësoja për deklaramin e vlerës së investuar në mobilim, arredim, etj. Gjithashtu, duke qenë se ishte viti i parë i deklaramit, edhe mungesa e udhëzimeve të sakta në plotësimin e DPV-së, është bërë shkak për moscitimin e kësaj vlere. Për më tepër, nga ana e ILDKPKI-së nuk më është kërkuar asnjëherë të saktësoj këtë deklaratë e të deklaroj vlerën totale të apartamentit, së bashku me vlerën e investimeve në të dhe prandaj kam deklaruar vetëm çmimin e blerjes së apartamentit vetëm si pasuri e paluajtshme.”* [...] *‘Kemi jetuar së bashku me prindërit e bashkëshortit deri në mars të vitit 2002. Edhe apartamentin e banimit në vitin 2002 bashkëshorti e ka*

¹¹ Referuar ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat” dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

blerë në të njëjtin pallat, në katin e parë të tij, ku vazhdojmë të jetojmë edhe sot e kësaj dite. Kur jam shprehur në DPV-në e vitit 2003 për familjen e origjinës së bashkëshortit, kam pasur parasysh faktin se ai është pjesë e familjes së origjinës së vet, si edhe përfshirjen e kontributit financiar të vetë bashkëshortit tim e pas martesës, përfshirjen edhe të kontributit tim financiar. Sa më sipër, nuk konstatoj në deklarinimin e burimit të kësaj pasurie ndonjë mospërputhje, pasi në deklaratën Vetting, në thelb kam deklaruar të njëjtën gjë, por në formë më detajuese dhe konkretizuese në lidhje me kontributet e secilit prej anëtarëve të kësaj familjeje ku kemi bërë pjesë.’ [...] ‘Pavarësisht se në DPV-në e vitit 2003 nuk është deklaruar burimi, ai është deklaruar i saktë në deklaratën Vetting, që është dokumenti themelor, në bazë të të cilit zhvillohet procesi i Vettingut. Në kushtet që si bashkëshorti dhe unë, ashtu edhe prindërit e tij kishim burime të ligjshme për ta blerë apartamentin, duke pasur parasysh kontributin e përbashkët financiar të gjithë anëtarëve të kësaj familjeje, dua ta siguroj Komisionin se, nga ana ime nuk ka pasur asnjë qëllim apo shkak për shmangien për të deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave edhe për blerjen e investimit në banesë.’ [...] ‘Në periudhën që është realizuar kontrata e parë e shitjes, datë 22.10.1997, me vlerë 97.000 USD, në fuqi ka qenë ligji nr. 7729, datë 20.7.1993, ‘Për tatimin’ i ndryshuar me ligjin nr. 8022, datë 20.11.1995 dhe në bazë të këtij ligji, të ardhurat e realizuara nga shitja e pasurisë nuk kanë qenë objekt i këtij ligji. Gjithashtu, ky transaksion nuk është objekt as i ligjit nr. 7786, datë 27.1.1994, ‘Për tatimin mbi të ardhurat personale’, i cili në nenin 2 shprehet se ‘Kategoritë e të ardhurave të tatueshme janë: pagat, shpërblimet për shërbimet individuale, të ardhurat nga qiratë’ në nenin 3 shprehet se: ‘nga tatimi mbi të ardhurat personale përjashtohen kategoritë e mëposhtme të të ardhurave, të ardhurat e trashëgimisë, të ardhurat nga sigurimet, ... etj.’. Pra, të gjitha të ardhurat e realizuara nga kjo kontratë shitjeje janë të ligjshme e mbi to nuk duhet të zbritet tatim. Për kontratën e shitjes nr. ***, datë 21.6.2001, me vlerë 5.000.000 lekë dhe kontratën e shitjes nr. ***, datë 21.6.2001 me vlerë 4.500.000 lekë, në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ neni 11, shprehet se: ‘Tatimi derdhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të sendet e mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme’. [...] Në lidhje me pagesën e tatimit në burim, sigurisht që vjehrra ime ka pasur detyrimin për ta kryer dhe kjo pagesë rezulton të jetë bërë, përderisa pasuria e paluajtshme nuk regjistrohej, pa provuar pagimin e tatimit në burim pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. [...]”

Vlerësimi i trupit gjykues

16. Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve të tij në prapësime, si dhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon.
17. Lidhur me vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarinimit të subjektit për pasurisë në Vlorë, me sipërfaqe 82 m² trupi gjykues vlerëson se mospërputhja ndërmjet deklaratës së vitit 2003 dhe asaj vetting, mbi vlerën e pasurisë në fjalë, është shpjeguar bindshëm në konsideratë dhe analizë të fakteve se: (i) apartamenti në fjalë është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes me Nr. *** Rep, Nr. *** Kol, datë 08.03.2002, me një çmim prej 1,900,000 Lekë, dhe në të janë parashikuar/përfshirë në mënyrë eksplicite vlera e kostotve të blerjeve shtesë, të disa materialeve hidrosanitare, pllakave dhe pajisjeve të mobilimit të banesës, në shumën 4,100,000 Lekë, me specifikimin se kjo shumë e nuk është përfshirë në çmimin e shitjes së banesës¹; (ii) shpjegimet e subjektit lidhur me burimet e deklaruara janë bindëse pasi ato në vetvete nuk pasqyrojnë ndonjë burim të

shtuar apo elemente kontradiktrë, por detajojnë kontributet e secilit prej anëtarëve të familjejes ku kanë bërë pjesë”; (iii) në deklarimin e vitit 2003 është cituar vetëm çmimi i shkruar në kontratën e shitblerjes - për sa kohë nuk kishte në formatin e deklaratës së parë (viti 2003) një rubrikë specifike ku mund të përshkruheshin shpenzimet e kryera shtesë dhe/ose për mobilimin e pasurive që deklaroheshin, (iv) ndërkohë, në deklaratën *Vetting*, që kërkoheshin në mënyrë më të detajuar dhe të plotë shumat e shpenzuara, edhe deklarimi i subjektit ka qenë i plotë dhe i saktë lidhur me këtë pasuri.

18. Për më tepër, edhe nëse do të hamendësohej ndonjë veprim fiktiv formal në shitblerjen e këtij apartamenti – duke mbajtur në vëmendje faktet se: (i) kontrata në fjalë është lidhur dhe nënshkruar vetëm nga bashkëshorti i subjektit; (ii) janë paraqitur nëntë kontrata të ngjashme të së njëjtës periudhë dhe për sipërfaqe ndërtimi të përafërt në të njëjtin qytet, që pasqyrojnë mesatarisht një çmim edhe më të ulët se ai i paguar për pasurinë në fjalë; (iii) shumat totale prej 6,000,000 lekësh e investuar për këtë pasuri është paguar nëpërmjet transfertave bankare dhe me burime të ligjshme - trupi gjykues çmon se nuk gjenden elemente konkrete që mund të pasqyrojnë ndonjë përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit, si sa i takon ligjshmërisë së burimeve ashtu edhe për sa i përket kryerjes së veprimeve juridike e financiare, si dhe deklarimin e tyre për këtë pasuri.
19. Lidhur me pretendimin se mbi të ardhurat e përfituara nga vjehrra e subjektit, në shitjen e pasurisë së paluajtshme në vitin 1997, nuk duhet të zbritet tatim, trupi gjykues vlerëson se nga një analizë e legjislacionit tatimor në fuqi në momentin e transaksionit të lartpërmendur, rezulton se sipas Dekretit Nr. 1673, datë 20.12.1996, Ligji Nr. 8189, datë 30.1.1997, “Për miratimin me ndryshime të dekretit Nr. 1673, date 20.12.1996 "Per tatimin mbi të ardhurat personale", i ndryshuar, për çmimin e shitjes mbi 6,000,000 lekë, detyrimi tatimor përkatës ka qenë 3% e çmimit, shumë kjo e cila i është zbritur nga llogaritja e të ardhurave të vjehrrës së subjektit në analizën financiare.

2. Apartament banimi me sipërfaqe totale 121.6 m², në Tiranë

20. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2005, përfituar me kontratën e porosisë nr. ***, në datën 7.11.2005, të lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe porositësit L. B., kundrejt çmimit total 60,800 euro¹². Ky objekt rezulton ende të jetë i pa regjistruar në ASHK-në Tiranë¹³.
21. Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për pagesën e kryer për apartamentin e lartpërmendur kanë shërbyer si burim të ardhurat si vijojnë:
 - a) shuma 1,000,000 lekë nga shitja e pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit të banesës së privatizuar;
 - b) shuma 2,700,000 lekë dhuratë nga prindërit e bashkëshortit;
 - c) shuma 30,000 euro të marrë hua nga shtetasi J. H.¹⁴.
22. Në deklaratën *Vetting*, përveç burimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi edhe kursime nga të ardhurat dhe, gjithashtu, ka deklaruar në rubrikën përkatëse në DIPP-në e vitit 2005, detyrimin e mbetur pa shlyer ndaj palës shitëse,

¹² Nga të cilat 60,000 euro është likuiduar sipas mandatarkëtimit datë 7.11.2005, nëpërmjet Bankës Amerikane të Shqipërisë dhe 800 euro (sipas kontratës) mbeten detyrim për t’u likuiduar në momentin e dorëzimit të çelësave të apartamentit.

¹³ ASHK Tiranë Veri, me shkruesin nr. *** prot., datë 20.1.2020; ASHK Tiranë Jug me shkruesin nr. *** prot., datë 27.1.2020; ASHK Tiranë Rurale 1 me shkruesin nr. *** prot., datë 21.1.2020 dhe ASHK Tiranë Rurale 2 me shkruesin nr. *** prot., datë 28.1.2020, konfirmojnë se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve nuk figurojnë të regjistruara pasuri në pronësi.

¹⁴ Hua e marrë nga shtetasi J. H. me kontratën e huas nr. ***, datë 28.10.2005.

subjektit ndërtues “****” sh.p.k., në masën 7,800 euro¹⁵, si dhe detyrimin e mbetur pa shlyer ndaj huadhënësit J. H..

23. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., në masën 7,800 euro, me burim të deklaruar nga kursimet e vitit. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rregullisht ndër vite shlyerjen e huas ndaj huadhënësit J. H..
24. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
- i. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 21.12.2005, në të cilën subjekti i rivlerësimit i ka shitur palës blerëse, prindërve të saj N. dhe V. Q., pjesën takuese prej 1/3 të pasurisë së llojit “apartament” me nr. pasurie ***, z. k. ***, në shumën prej 1,000,000 lekësh, shumë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
 - ii. Deklaratë noteriale nr. ***¹⁶ rep., datë 26.10.2007, të lëshuar nga shtetasit O. dhe M. B., në të cilën kanë deklaruar se në nëntor të vitit 2005 i kanë dhuruar djalin L. B. shumën prej 2,700,000 lekësh, duke i bashkëlidhur dokumentacionin që vërteton tërheqjen e shumave monetare nga llogaritë e tyre bankare si vijojnë:
 - a. printim nga sistemi i BKT-së i datës 7.11.2005, nga ku ka rezultuar se shtetasit M. B.¹⁷ ose O. B., kanë pasur depozitë shumën prej 723,448 lekësh;
 - b. printim i datës 7.11.2005, nga sistemi i BKT-së, ku rezulton se shtetasit M. B. ose O. B. kanë pasur depozitë bankare në shumën prej 510,662 lekësh;
 - c. vërtetim datë 30.10.2007, nga “Raiffeisen Bank”, dega nr. ***, Vlorë, ku ka konfirmuar se në datën 7.11.2005 shtetasit O. B. dhe M. B. kanë tërhequr shumën prej 1,200,000 lekësh.
 - iii. Kontratë huaje¹⁸ nr. ***, datë 28.10.2005, me palë huadhënëse shtetasin J. H.¹⁹ dhe palë huamarrëse shtetasin L. B., me të cilën huadhënësi i ka dhënë hua shumën prej 30,000 euro, për një periudhë 5-vjeçare dhe pa interes.
 - iv. Kontratë porosie nr. ***, datë 7.11.2005, e lidhur ndërmjet shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe porositësit L. B., kundrejt çmimit total 60,800 euro, nga të cilat vlera 60,000 euro është likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës dhe 800 euro do të likuidohet në momentin e dorëzimit të çelësave të apartamentit.
 - v. Bashkëngjitur kontratës së porosisë është vënë në dispozicion edhe mandatarkëtimi i Bankës Amerikane të Shqipërisë, me përshkrimin “prenotim apartamenti, k. ***, sip. 121.6 m², p. ‘V. K.’, Rr. ‘M. F.’, i datës 7.11.2005”, sipas të cilit shtetasi L. B. ka derdhur *cash* në llogarinë e shtetasit H. J.²⁰ shumën 60,000 euro.
 - vi. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 6.4.2011, lëshuar nga shtetasi J. H., në të cilën ka deklaruar se huaja në shumën 30,000 euro që kishte dhënë hua në vitin 2005 është shlyer përfundimisht nga shtetasi L. B. në vitin 2011.

¹⁵ Në të cilën është përfshirë detyrimi i mbetur prej 7,000 euro për blerjen e vendparkimeve (pasuri të trajtuara në pikën 3 të këtij relacioni) dhe 800 euro detyrimi i mbetur nga çmimi i apartamentit.

¹⁶ Nuk ka një kontratë dhurimi midis palëve në momentin e dhënies së shumës prej 2,700,000 lekësh.

¹⁷ Bashkëshortja e babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nga martesja e dytë e tij.

¹⁸ Nuk rezulton të jetë e përshkruar në kontratë mënyra e dhënies së huas dhe mënyra e kthimit të saj.

¹⁹ DPT – Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.12.2018, ka informuar se z. J. H., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. është regjistruar në datën 3.3.2003 si person juridik biznes i vogël dhe në datën 25.2.2012 ka kaluar në status pasiv.

²⁰ Shtetasi H. J. rezulton përfaqësues i shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.

2.1. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

2.1.1 Të ardhura nga shitja e pjesës takuese të apartamentit të përfituar nga privatizimi, në shumën 1,000,000 lekë

25. Nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar qartësisht si të ardhur shumën prej 1,000,000 lekësh të përfituar nga shitja e pjesës takuese 1/3 të banesës, por e ka deklaruar atë të përdorur si burim krijimi për blerjen e apartamentit në Tiranë, në po të njëjtin vit.
26. Kjo pasuri është përfituar fillimisht në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.11.1992, “Mbi privatizimin e banesave shtetërore”, me anë të kontratës për privatizimin e banesës së datës 3.8.1993 lidhur ndërmjet N. K. Banesa dhe qiramarrësit N. Q., kundrejt vlerës totale 10,580 lekë.
27. Subjekti i rivlerësimit i ka shitur me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, në datën 21.12.2005, prindërve të saj N. dhe V. Q., pjesën takuese prej 1/3 të apartamentit të privatizuar me nr. pasurie ***, z. k. ***, në shumën prej 1,000,000 lekësh.
28. Konstatohet se kontrata e shitblerjes së pjesës takuese të subjektit të rivlerësimit mbi apartamentin e privatizuar në Vlorë, është kryer 44 ditë më vonë nga nënshkrimi i kontratës së porosisë me palën shitëse shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit në Tiranë dhe kryerjen e pagesës fillestare në vlerën 60,000 euro, paguar më 7.11.2005 me transfertë bankare.
29. Subjekti i rivlerësimit është pyetur lidhur me mospërputhjen e periudhës kohore midis veprimeve juridike dhe në pyetësin nr. 2, ka sqaruar se: *“Në fund të muajit tetor 2005 kam shitur pjesën time takuese si bashkëpronare e kësaj banese prindërve të mi, kundrejt çmimit 1,000,000 lekë. Nëna ime ka pasur pamundësi shëndetësore për të lëvizur nga gjymtyrët për të lidhur kontratën e shitjes para noterit në momentin kur kjo shitje faktikisht u krye, por për shkak të marrëdhënieve të posaçme e shumë të mira prindërbijë, bazuar në mirëbesimin dhe ndjenjën e fortë të dashurisë, dhembshurisë, mirënjohjes e respektit, prindërit më dhanë cash paratë jashtë zyrës noteriale në muajin tetor dhe pasi gjendja e nënës sime është përmirësuar, në muajin dhjetor të po këtij viti kemi formalizuar me kontratë noteriale shitblerjen e pjesës sime takuese datë 21.12.2005. Meqenëse këtë shumë e disponoja, ajo na shërbeu pastaj për shlyerjen e çmimit të një apartamenti banimi që ne blemë në datën 7.11.2005 në Tiranë”.*
30. Lidhur me mundësinë e prindërve për të blerë pjesën e saj takuese në apartamentin e privatizuar, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur nëpërmjet përgjigjeve të pyetësit nr. 5, dokumentacionin mbi të ardhurat e tyre si vijon:
 - a. vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga DRSSH-ja Vlorë për të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit, N. Q., nga data 15.9.1997;
 - b. vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga DRSSH-ja Vlorë për të ardhurat²¹ e realizuara nga nëna e subjektit, V. Q., nga data 15.3.1999.
31. Komisioni ka përllogaritur të ardhurat *neto* të realizuara nga prindërit e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1998 – tetor 2005, momenti kur pretendohet të jetë kryer pagesa prej tyre e shumës 1,000,000 lekë – të cilat rezultuan në masën 3,091,620 lekë.

²¹ Referuar vërtetimit të mësipërm mbi bazën e vlerësueshme, të dhënat ishin për pagat *bruto*, mbi të cilat u llogaritën nga Komisioni kontributet dhe tatimet bazuar në: VKM-në Nr. 42, datë 23.1.1995; VKM-në Nr. 346, datë 7.6.2002 dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” (ndryshuar me ligjet: nr. 8711, datë 15.12.2000; nr. 8841, datë 11.12.2001; nr. 8979, datë 12.12.2002 dhe nr. 9326, datë 6.12.2004) për përcaktimin e pagave *neto*.

Po ashtu, janë përlogaritur shpenzimet jetike të prindërve të subjektit të rivlerësimit, për të njëjtën periudhë, të cilat rezultuan në masën 1,389,507 lekë²².

32. Në mënyrë të përmbledhur, në tabelën nr. 2 që vijon janë pasqyruar të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit të rivlerësimit, deri në tetor të vitit 2005, që kanë mundësuar më pas blerjen e pjesës takuese të apartamentit të privatizuar në Vlorë.

Tabela nr. 2 – Përlogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve të prindërve të subjektit

Përshkrimi	Shuma
Të ardhura (1998-tetor 2005)	3 091 620
Shpenzime jetese (1998-tetor 2005)	(1 389 507)
Blerë pjesa takuese e apartamentit	(1 000 000)
Rezultati	702 113

2.1.2 Shuma 2,700,000 lekë, e dhuruar nga prindërit e bashkëshortit

33. Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit për blerjen e apartamentit në Tiranë me sip. 121.6 m², ndër të tjera, edhe dhurimin e shumës prej 2,700,000 lekësh nga prindërit e bashkëshortit.
34. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, në rubrikën e të ardhurave, se kjo shumë është siguruar nga prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga:
- tërheqja e shumës 1,200,000 lekë nga depozita në “Raiffeisen Bank”;
 - tërheqjet në shumat 723,448 lekë dhe 510,662 lekë nga depozitat në BKT; dhe
 - pjesa tjetër nga kursimet e tyre në gjendje *cash*.
35. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare është konfirmuar tërheqja përkatësisht e shumave 723,448 lekë dhe 510,662 lekë në datën 7.11.2005 nga znj. M. B. në llogaritë e saj në BKT²³.
36. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të prindërve të bashkëshortit, që kanë mundësuar kursimin e shumës prej 2,700,000 lekësh, të dhuruar më pas prej tyre, subjekti i rivlerësimit është pyetur në pyetësonin nr. 3, në përgjigje të të cilit ka shpjeguar se nga shuma prej 6,305,573 lekësh²⁴ të përfituara nga vjehrra, znj. M. B., nga shitja e pasurive të saj të paluajtshme, të përfituara nga trashëgimia dhe dhurimi, pjesa prej 5,307,404 lekësh i ishte dhënë subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në vitin 2002 për blerjen e apartamentit në Vlorë²⁵. Ndërsa diferenca e mbetur prej 998,169 lekësh u është dhënë këtyre të fundit në vitin 2005, për blerjen e apartamentit në Tiranë.
37. Subjekti i rivlerësimit ka shtuar se znj. M. B. ka qenë gjithashtu bashkëpronare e pasurisë së llojit truall²⁶ me sip. 868 m² (me pjesë takuese 1/5) në ***, Lezhë, pasuri e cila është përfituar me vendimin nr. ***, datë 16.12.1994, të KKKP-së, Lezhë, por që rezultoi e regjistruar vetëm në emër të shtetasit Rr. K. (vëllai i M. B.).

²² Shpenzimet jetike janë përlogaritur për 2 persona, përkatësisht për periudhën 1998-1999 në masën 5,000 lekë/muaj për frymë dhe më pas nga viti 2000, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, dërguar ILDKPKI-së.

²³ Lëvizjet bankare ardhur me shkresën nr. ***, datë 24.12.2019.

²⁴ Të ardhurat *neto* nga shitja e pasurive të paluajtshme të znj. M. B., pas pagimit të detyrimeve tatimore përkatëse.

²⁵ Pasuria e trajtuar në pikën 1.

²⁶ Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion në pyetësonin nr. 3, kjo pasuri rezultoi e regjistruar vetëm në emër të z. Rr. K..

38. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se pavarësisht se padia²⁷ ishte ngritur nga z. Rr. K., në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve të ish-pronarit T. K. dhe jo si pronar i vetëm i kësaj pasurie, kjo pasuri u regjistrua vetëm në emër të këtij të fundit. Të gjithë bashkëpronarët ranë dakord që kontrata e shitblerjes së pasurisë të realizohej duke u nënshkruar vetëm prej tij dhe se çmimi i shitjes do të ndahej përpjesëtimisht në 5 pjesë te trashëgimtarët e ish-pronarit T. K., nga ku do të përfitonte edhe znj. M. B..
39. Me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 11.3.2004, z. Rr. K. i ka shitur pasurinë e mësipërme shtetasit B. J. në çmimin total prej 3,700,000 lekësh. Referuar shpjegimeve të subjektit në pyetësonin nr. 3, sipas pjesës takuese mbi këtë pasuri, vjehrrës M. B.²⁸ i takonte pjesa prej 740,000 lekësh²⁹.
40. Bashkëshortja dhe fëmijët e të ndjerit Rr. K. (N.)³⁰ kanë lëshuar deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.10.2019, në të cilën kanë konfirmuar se kjo pasuri u është kthyer në natyrë të gjithë trashëgimtarëve të ish-pronarit T. K., në bazë të vendimit nr. ***, datë 16.12.1994, të KKKP-së Lezhë dhe se çmimi i shitjes është ndarë në 5 pjesë të barabarta fëmijëve të të ndjerit, midis të cilëve edhe znj. M. B., e cila ka marrë 1/5 e shumës së çmimit, shumë që i është dhënë *cash*.
41. Përveç dy burimeve të sipërpërmendura, subjekti i rivlerësimit ka shtuar se prindërit e bashkëshortit kanë pasur të ardhura nga pensionet në shtetin shqiptar, si dhe vjehri i saj, z. O. B., ka përfituar edhe pension nga shteti grek.
42. Nga dokumentacioni i sjellë nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësonit nr. 2, ka rezultuar se prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit janë trajtuar me pension pleqërie dhe se për periudhën 1998 – tetor 2005, kanë përfituar shumën 1,282,704 lekë³¹. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka bashkëngjitur dokumentacionin që vërteton trajtimin me pension të z. O. B. nga shteti grek në masën 13,981 euro (ose ekuivalenti prej 1,806,918 lekësh³²) për periudhën 1999 – tetor 2005.
43. Komisioni ka përllogaritur edhe shpenzimet jetike për 2 persona për periudhën 1998 – tetor 2005, të cilat kanë rezultuar në masën 1,389,507 lekë. Në tabelën më poshtë janë përllogaritur burimet financiare dhe shpenzimet deri në tetor të vitit 2005, të përdorura për dhurimin e shumës prej 2,700,000 lekësh nga prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit³³.

²⁷ Bashkëlidhur pyetësonit, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion vendimin e gjykatës dhe kërkesëpadinë, për këtë pasuri.

²⁸ Me çeljen e trashëgimisë nr. 2, datë 14.10.1993, znj. M. K. (B.) është trashëgimtare e z. T. K., së bashku me z. Rr. K. etj.

²⁹ Për këtë të ardhur, Komisioni ka përllogaritur dhe zbritur në analizë detyrimin tatimor prej 1% mbi çmimin e shitjes, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat".

³⁰ Nuk rezulton të jetë paraqitur certifikatë familjare dhe certifikatë vdekje apo çelja e dëshmisë së trashëgimisë së z. Rr. K..

³¹ Referuar shkresave nr. *** prot., datë 19.2.2020 dhe nr. *** prot., datë 7.10.2019, nga ISSH-ja, vërtetohet se z. O. B. është trajtuar për periudhën 1991 – 2013 me pension pleqërie në vlerën 2,377,204 lekë dhe znj. M. B. në periudhën 1993 – 2019, në vlerën 3,032,169 lekë.

³² Konvertuar pensioni i përfituar çdo vit me kursin mesatar të fundit të vitit përkatës.

³³ Edhe nëse nuk do të konsiderohej shuma prej 740,000 lekë si e ardhur e ligjshme, bilanci i kësaj periudhe do të rezultonte në masën – 1,718 lekë.

Tabela nr. 3 – Analiza e të ardhurave të prindërve të subjektit deri në tetor 2005

Përshkrimi	Shuma
Të ardhura nga shitja e pasurive M. B. 2004	732 600
Pension nga Greqia O. B. 1999 - Tetor 2005	1 806 916
Pension pleqërie O. dhe M. B. në Shqipëri 1998 - Tetor 2005	1 282 704
Shuma e mbetur nga shitja e pasurive të mëparshme nga viti 2001	998 169
Dhuratë për blerjen e apartamentit në Tiranë	(2 700 000)
Shpenzime jetese 1998 - Tetor 2005	(1 389 507)
Rezultati	730 882

2.1.3 Lidhur me shumën 30,000 euro, të marrë hua nga shtetasi J. H.

44. Në DIPP-në e vitit 2005 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet për blerjen e apartamentit në fjalë edhe huan e marrë nga shtetasi J. H..
45. Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit në pyetësonin nr. 2, të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasi J. H., që kanë mundësuar dhënien e huas në shumën 30,000 euro. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin si vijon:
- vendim i asamblesë së ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k., mbajtur në datën 11.1.2005, në të cilin ortakët M. dhe J. H. kanë vendosur miratimin e dhënies së huas z. J. H. nga mjetet monetare të shoqërisë, shumën 35,000 euro gjatë vitit 2005;
 - kontratë shitblerjeje nr. *** rep., datë 13.3.1998, ku shtetasi J. H. ka shitur apartamentin e tij, kundrejt çmimit 1,950,000 lekë;
 - lëvizjet bankare të shoqërisë “****” sh.p.k., përgjatë vitit 2005 në BKT;
 - lidhur me vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë “****”³⁴ sh.p.k., mbajtur në datën 11.1.2005, Komisioni iu drejtua QKB-së për të vënë në dispozicion të gjitha vendimet e asamblesë së ortakëve të shoqërisë për vitet 2005 dhe 2006, nga ku nuk rezultoi që vendimi në fjalë të jetë depozituar në QKB.
46. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ, QKB-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 7.8.2020, ka vënë në dispozicion të Komisionit: ekstraktin historik të shoqërisë; vendimin nr. ***, datë 4.10.1994, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e personit juridik; vendimin nr. ***, datë 11.1.1999, të asamblesë së ortakëve për shtimin e objektit të veprimtarisë; vendimin nr. ***, datë 8.10.1999, të asamblesë së ortakëve për shtimin e kohëzgjatjes së shoqërisë; vendimin nr. ***, datë 28.1.2000, të asamblesë së ortakëve për shtimin e administratores M. H.; vendimin nr. ***, datë 6.12.2000, të asamblesë së ortakëve për shitjen e kuotave të ortakut F. A. dhe blerjen e tyre nga z. J. H., i cili mbetet ortak i vetëm me 100% të kuotave; vendimin nr. ***, datë 10.1.2003, të ortakut të vetëm ku z. J. H. i shet 50% të kuotave shtetases M. H. dhe vendimin nr. ***, datë 20.3.2006, të asamblesë së ortakëve për shitjen e kuotave të mbetura prej 50% të z. J. H. ortakes M. H., e cila mbetet ortake e vetme me 100% të kuotave të shoqërisë.
47. Referuar shkresës nr. *** prot., datë 15.1.2020, të DRT-së Vlorë, të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar se shoqëria “****” sh.p.k. ka pasur një xhiro totale

³⁴ Kuadri ligjor në fuqi i kohës, ligji nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura”, ligji nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për Shoqëritë Tregtare” dhe ligji nr. 7667, datë 28.1.1993, “Për regjistrin tregtar”.

nga ushtrimi i aktivitetit tregtar për periudhën 1997 – 2004, në vlerën 19,797,986 lekë, por pa përcaktuar fitimin *neto* të realizuar prej saj.

48. Komisioni, gjithashtu, iu drejtua DRT-së Vlorë, për të vënë në dispozicion pasqyrat financiare dhe deklaratat e tatim-fitimit të thjeshtuar të viteve 2004 dhe 2005 dhe analizën e llogarisë së aksionarit për të njëjtën periudhë. Në përgjigjen e saj, me shkresën nr. *** prot., datë 14.8.2020, kjo drejtori është shprehur se për vitin 2004 nuk ka të dhëna të deklarimit të të ardhurave të këtij aktiviteti në sistemin tatimor, si dhe nga kontrolli i dosjes fizike ka rezultuar se nuk ka depozituar pasqyra financiare, por vetëm disa deklarata të të ardhurave³⁵. Gjithashtu, ka rezultuar se për këtë aktivitet janë kryer, në vitin 2004, pagesat e tatim-fitimit të thjeshtuar dhe taksave vendore në masën 202,500 lekë.
49. Po ashtu, për vitin 2005, shoqëria në fjalë nuk ka depozituar pasqyra financiare, por ka deklaruar të ardhura në masën 6,300,000 lekë dhe ka kryer pagesë të tatim-fitimit të thjeshtuar dhe taksave vendore në masën 57,200 lekë, por nuk ka të dhëna mbi fitimin e realizuar. Nisur nga fakti se ndaj kësaj shoqërie nuk i është ushtruar kontroll tatimor, kjo drejtori nuk mund të shprehet për ndonjë analizë të llogarisë së aksionarit për periudhën e kërkuar.
50. Bashkëngjitur dokumentacionit të ardhur nga DRT-ja Vlorë, si më sipër, gjendet një vendim i asamblesë me titull “Për destinimin e fitimit të vitit 2004”, i marrë në mbledhjen e datës 25.3.2005, nga ku konstatohet veprimi i pretenduar.
51. Nga lëvizjet bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. evidentohet se gjatë vitit 2005, kjo shoqëri ka kryer transaksione në llogaritë e saj bankare në total shumat përkatëse: kreditime në vlerën 207,303 euro dhe debitime në vlerën 205,997 euro në llogarinë në euro. Gjithashtu, shoqëria ka pasur kreditime në masën 496,418 USD dhe debitime në masën 479,955 USD, në llogarinë në dollarë.
52. Nga analizimi i debitimeve në llogaritë bankare, ka rezultuar se shtetasi J. H. ka kryer tërheqje *cash* nga llogaritë e shoqërisë, në periudhën janar 2005 – tetor 2005, shumën prej 59,577 euro dhe 7,000 USD. Për rrjedhojë, duket se personi tjetër i lidhur, J. H., ka pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar dhënien e huas në vlerën monetare prej 30,000 euro, për sa kohë, burimi i huadhënësit J. H., i përmendur në vendimin e asamblesë së shoqërisë “****” sh.p.k., rrjedh nga huaja e marrë nga mjetet monetare të shoqërisë, të cilat përfshijnë mjetet në arkë dhe në bankë të një shoqërie.
53. Subjekti i rivlerësimit, në DIPP-të e periudhës 2006 – 2011, ka deklaruar rregullisht shlyerjen e huas ndaj shtetasit J. H., si vijon:
 - a. shumën 10,000 euro në vitin 2006;
 - b. shumën 4,200 euro në vitin 2008;
 - c. shumën 7,000 euro në vitin 2009;
 - d. shumën 4,400 euro në vitin 2010;
 - e. shumën 4,400 euro në vitin 2011.
54. Mënyra e shlyerjes së deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-të përkatëse ndër vite, përputhet me deklaratimet e përcaktuara edhe në deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.4.2011,

³⁵ Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion bashkëngjitur shkresës së DRT-së Vlorë, konstatohet se të ardhurat për muajt që disponohen, kanë qenë në masën 2,193,258 lekë, por mungon deklarata e muajit mars 2004.

të lëshuar nga huadhënësi, shtetasi J. H.. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësonin nr. 2 se huaja është shlyer *cash* prej saj dhe bashkëshortit³⁶.

55. Në konkluzion të hetimit administrativ, lidhur me këtë pasuri, Komisioni i ka komunikuar subjektit të rivlerësimit, rezultatet e mëposhtme:
- Duket se ka mospërputhje midis kohës së realizimit të të ardhurave nga shitja e pjesës takuese, në një moment të mëpasëm prej 44 ditësh, krahasuar me momentin e blerjes së pasurisë në analizë.
 - Duket se prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë pasur mundësi për blerjen e pjesës takuese të apartamentit në bashkëpronësi, në shumën 1,000,000 lekë, me burime të ligjshme financiare.
 - Duket se personat e tjerë të lidhur, shtetasit O. B. dhe M. B., kanë pasur burime të ligjshme financiare për të justifikuar dhurimin e shumës prej 2,700,000 lekësh në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, për blerjen e apartamentit në fjalë, ndonëse nuk rezulton e provuar pagesa e tatimit për të gjitha shitjet e pasurive.
 - Duket se personi tjetër i lidhur, J. H., ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huas në vlerën 30,000 euro, me burim të ligjshëm nga mjetet monetare të shoqërisë.
 - Duket se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për blerjen e apartamentit në Tiranë, në vitin 2005, me burime të ligjshme financiare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

56. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *“Nëna ime ka pasur pamundësi shëndetësore për të lëvizur nga gjymtyrët për të lidhur kontratën e shitjes para noterit në momentin kur kjo shitje faktikisht u krye. Në lidhje me këtë fakt, po paraqes si provë vërtetimin datë 19.1.2021, të lëshuar nga Spitali Rajonal Vlorë, me të cilin provohet diagnoza klinike dhe periudha e rekomanduar e paaftësisë prej tri javësh nga data 25.10.2005 deri më 13.11.2005. Në marrëdhënie të posaçme siç janë ato prindër-bijë, bazuar në mirëbesimin reciprok mes njëri-tjetrit, prindërit më dhanë cash 1.000.000 lekë në fund të muajit tetor 2005, të cilat i dispononin nga të ardhurat e tyre ndër vite. Këtë shumë ma kanë dhënë pa kryer asnjë lloj formaliteti, as me atë me shkresë të thjeshtë, pasi kishim rënë dakord se sapo të bëhej mirë nga shëndeti mamaja, ne do të kryenim këtë veprim juridik para noterit. Sa më sipër, në lidhje me mospërputhjen në kohë të dhënies ‘de facto’ të vlerës së pjesës takuese të shitur nga ana ime me momentin e formalizimit të kësaj shitjeje, nëna ime ka deklaruar lidhur me pamundësinë e saj shëndetësore, që ka shkaktuar këtë mospërputhje në kohë, në deklaratën noteriale datë 20.1.2021. ‘[...] Në lidhje me pagesën e tatimit në burim, sigurisht që vjehrra ime ka pasur detyrimin për ta kryer dhe kjo pagesë rezultoi të jetë bërë, përderisa pasuria e paluajtshme nuk regjistrohej, pa provuar pagimin e tatimit në burim pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. [...]”*
57. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 19.1.2021, nga Spitali Rajonal Vlorë, në të cilin konfirmohet se për periudhën 25.10.2005 – 13.11.2005, nëna e subjektit ka qenë e shtruar në këtë spital me diagnozën *“Luksacion scalpulo-humeral tendinit”* dhe është rekomanduar raport paaftësie për 21 ditë; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.1.2021, e lëshuar nga nëna

³⁶ Lidhur me shlyerjet e huas në vlerën prej 30,000 euro, nga subjekti i rivlerësimit, referojuni analizës financiare ndër vite.

e subjektit, e cila ka deklaruar se së bashku me bashkëshortin kanë blerë në tetor të vitit 2005 pjesën takuese të apartamentit të vajzës së tyre.

Vlerësimi i trupit gjykues

58. Trupi gjykues vlerëson se duke mbajtur në vëmendje: (i) marrëdhënien e posaçme nënë-bijë, në bazë të së cilës mund të kryhen në mirëbesim veprime financiare; (ii) gjendjen shëndetësore të nënës së subjektit, në periudhën 25.10.2005 – 13.11.2005, i provuar me një dokument që merr vlerë provuese pasi pasqyron fakte të ndodhura në atë kohë, të cilat mbështesin shpjegimet e subjektit; si dhe (iii) disponibilitetin faktik të shumës së paguar shumë më herët se momenti i formalizimit (të vonuar) të shitblerjes së pjesës takuese të subjektit – i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit, pasi gjendja financiare e znj. V. Q., 44 ditë përpara formalizimit të shitblerjes në fjalë, e ka mundësuar kalimin e shumës prej 1,000,000 lekësh në favor të subjektit. Në vlerësim të provave të paraqitura nga subjekti dhe deklarimeve në DIPP-të periodike si të ardhura dhe në atë vetting, trupi gjykues i vlerëson bindëse shpjegimet e subjektit.
59. Lidhur me pagesën e tatimeve mbi shumat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme, përpos shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupa gjykuese çmon se nisur nga përmbajtja e dispozitave ligjore dhe nënligjore në periudhat përkatëse, konstatohet se legjislacioni në fuqi dhe konkretisht, Dekreti nr. 1673, datë 20.12.1996, parashikonte se: *“Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të hipotekës nuk regjistrojnë kalimin e pronësisë pa u paraqitur dokumenti që vërteton pagimin e tatimit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni”*. Nisur nga kjo dispozitë, për sa kohë në rastin konkret është provuar regjistrimi i pasurive të shitura në emër të palëve blerëse, kryerja e pagesave të detyrimeve tatimore duhet të konsiderohet e realizuar plotësisht dhe paraprkasht këtij veprimi deklarativ. Për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

3. Dy vendparkime në pallatin ku ndodhet apartamenti i banimit në Tiranë

60. Këto pasuri janë deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2005 dhe më pas në deklaratën *Vetting*, të përfituara me kontratën e porosisë nr. ***, datë 12.12.2005, të lidhur ndërmjet palës sipërmarrëse “****” sh.p.k. në vitin 2005, me vlerë 10,000 euro. Ato rezultojnë të jenë ende të paregjistruara në ASHK-në Tiranë dhe ndodhen në të njëjtin pallat me apartamentin e trajtuar në pasurinë nr. 2.
61. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e vlerës prej 3,000 euro me burim kursimet e vitit 2005, si dhe ka deklaruar detyrim të mbetur ndaj shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k., në masën 7,800 euro³⁷. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e detyrimit të mbetur prej 7,800 euro³⁸ ndaj shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit dhe vendparkimeve, duke përshkruar si burim të krijimit të kësaj shume të ardhurat nga kursimet, si dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se vlera prej 10,000 euro është likuiduar pjesë-pjesë nga kursimet.
62. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 4, për të vendosur në dispozicion dokumentacionin që provonte shlyerjen e shumës 7,800 euro ndaj shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. Në përgjigje të tij, subjekti i rivlerësimit ka informuar se:

³⁷ Vlera prej 7,800 euro nga detyrimi i mbetur shoqërisë “****” sh.p.k., përbëhet nga shuma 800 euro, mbetur nga apartamenti dhe 7,000 euro nga dy vendparkimet.

³⁸ Në DIPP-në e vitit 2007 subjekti ka deklaruar se me kursimet e vitit në vlerën 977,160 lekë ka shlyer një pjesë të huas në shumën 7,800 euro, ndërkohë që në rubrikën përkatëse të detyrimeve ka specifikuar shlyerje të detyrimit për çmimin e blerjes së apartamentit dhe vendparkimit në shumën 7,800 euro dhe nuk ka deklaruar shlyerje të huas prej 30,000 euro.

*“Detyrimin e mbetur prej 7,800 euro ia kemi likuiduar cash shoqërisë ‘***’ sh.p.k., duke ia shlyer nga kursimet që dispononim në fund të vitit 2007”.* Bashkë me përgjigjet e pyetësorit, subjekti ka vendosur në dispozicion të Komisionit, një mandatpagesë të datës 26.11.2007, që vërteton kryerjen e pagesës së detyrimit të mbetur ndaj shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit dhe të vendparkimeve në fjalë.

3.1. Për këtë pasuri Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

- i. Kontratë porosie nr. ***, datë 12.12.2005³⁹, lidhur ndërmjet shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k. dhe palës porositëse z. L. B., për ndërtimin e dy vendparkimeve të hapura me nr. *** dhe ***, në katin e parë të bodrumeve të pallatit që po ndërtohej në rrugën “M. F.”, Tiranë, kundrejt çmimit total prej 10,000 euro. Palët kanë deklaruar se shuma prej 3,000 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale, ndërsa pagesa prej 7,000 euro do të bëhej deri më 15.9.2006.
- ii. Mandatpagesë nr. ***, datë 26.11.2007, sipas të cilit bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer pagesën e shumës 7,800 euro në arkën e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., me përshkrimin “kësti i fundit për apartament + vendparkim në rrugën ‘F.’”. Mandatpagesa në fjalë rezultoi të jetë nënshkruar nga shtetasit L. B. dhe H. J..

3.2. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

63. Përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka shlyer shumën 3,000 euro në vitin 2005 me nënshkrimin e kontratës së porosisë dhe, gjithashtu, ka deklaruar shlyerjen e diferencës së mbetur prej 7,000 euro në DIPP-në e vitit 2007, me burim nga kursimet e vitit 2007.
64. Lidhur me pagesën e parë prej 3,000 euro, të kryer në dhjetor të vitit 2005, nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se gjatë këtij viti subjekti i rivlerësimit ka realizuar të ardhura nga paga në masën 994,968 lekë⁴⁰. Po kështu, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka realizuar të ardhura nga paga dhe honoraret në masën 821,552 lekë⁴¹. Në këtë analizë janë konsideruar edhe fondet e mbartura/mbetura⁴² në dispozicion, pas pagimit të çmimit të apartamentit prej 60,000 euro nga burimet e deklaruara më herët (siç është trajtuar në analizë të pasurisë nr. 2). Pasi është kryer përlllogaritja e shpenzimeve dhe investimeve të kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit, përgjatë vitit 2005, lidhur me aftësitë financiare ka rezultuar një pamundësi prej 76.857 lekësh, siç është pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën më poshtë.

³⁹ Në kontratën e porosisë lexohet me shkrim (dymijë e tre).

⁴⁰ Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 27.1.2017, të lëshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe në vërtetimin nr. *** prot., datë 17.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁴¹ Bazuar në vërtetimin për bazën e vlerësueshme të lëshuar nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe në vërtetimin nr. *** prot., datë 19.2.2020, lëshuar nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë.

⁴² Nga burimet e deklaruara për apartamentin në vlerën prej 7,376,200 lekësh (1,000,000 lekë nga shitja e pjesës takuese; 2,700,000 lekë dhurim nga prindërit e bashkëshortit dhe 30,000 euro hua) është zbritur ekuivalenti i çmimit të paguar i 60,000 euro, 7,352,400 lekë dhe ka rezultuar një tepicë prej 23,800 lekë.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare e vitit 2005

Përshkrimi	Shuma
Të ardhura të vitit 2005	1 816 520
Të mbetura nga burimet e apartamentit	23 800
Shpenzime jetese të vitit 2005	(438 228)
Blerë automjetet VL**0C dhe VL**7C	(650 231)
Çelur depozitë në S*** Bank shtator 2005	(430 000)
Paguar kësti i parë për garazhin	(367 620)
Ndryshim në likuiditete (fund 2005-fillim 2005)	(31 098)
Rezultati	(76 857)

65. Lidhur me pagesën e dytë prej 7,800 euro, të kryer në datën 26.11.2007, nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se gjatë vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka realizuar të ardhura në masën 1,131,473 lekë⁴³ dhe bashkëshorti në masën 516,500 lekë⁴⁴.
66. Në DIPP-në e vitit 2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, ndër të tjera, të ardhura në masën 500,000 lekë nga shitja e automjetit tip “Volkswagen Golf”, me targa ***. Ky automjet rezulton të jetë blerë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në shumën 100,000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 7.4.2005, dhe për të është paguar zhdoganimi në vlerën 204,587 lekë. Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore sa i përket të ardhurave të realizuara nga shitja e këtij automjeti, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, në përgjigje të të cilit ka sqaruar se: *“Të ardhurat e realizuara nga shitja e automjetit nuk janë të ardhura të tatueshme pasi nuk janë objekt i detyrimit të pagimit të tatimit mbi të ardhurat personale, bazuar kjo në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, neni 8 ‘Të ardhurat e tatueshme’”*.
67. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, rezulton se ka qenë detyrimi i subjektit të rivlerësimit të paguante tatimin mbi diferencën e të ardhurave të përfituara nga shitja e këtij automjeti, pas zbritjes së shumës së shpenzuar për blerjen dhe zotërimin e tij.
68. Në këto kushte, Komisioni ka njohur në analizën financiare, si të ardhura me burim të ligjshëm nga shitja e automjetit tip “Volkswagen⁴⁵ Golf”, me targa ***, vetëm shumën prej 304,857 lekësh⁴⁶ dhe nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, për të përballuar të gjitha investimet, pagesat dhe shpenzimet e kryera prej tyre gjatë vitit 2007, në masën -120,644 lekë.

⁴³ Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 27.1.2017, të lëshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë.

⁴⁴ Bazuar në vërtetimin për bazën e vlerësueshme të lëshuar nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe nga interesat e fituara nga depozita e tij në Bankën Popullore.

⁴⁵ AMF-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2018, ka informuar mbi policat e sigurimit të subjektit dhe bashkëshortit, nga ku rezulton se përputhet informacioni mbi automjetet e siguruar me ato të disponuara.

⁴⁶ Të barabartë me çmimin e blerjes dhe faturës së zhdoganimit të automjetit.

Tabela nr. 5 – Analiza financiare e vitit 2007

Përshkrimi	Shuma
Të ardhura nga pagat 2007	1 647 973
Të ardhura nga shitja automjetit VL***0C	304 857
Shpenzime të vitit 2007	(643 099)
Blerë automjeti VL***2C	(427 092)
Paguar kësti fundit për ap dhe garazh Tiranë	(977 160)
Ndryshim në likuiditete (fund 2007-fillim 2007)	(26 123)
Rezultati	(120 644)

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

69. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me dy mungesat financiare të konstatuara nga Komisioni për vitet 2005 dhe 2007, ka pretenduar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni nuk janë përfshirë të gjitha të ardhurat e bashkëshortit të saj dhe ka paraqitur një analizë të kryer nga një ekspert kontabël, sipas së cilës rezultati i këtyre viteve del pozitiv.
70. Subjekti ka paraqitur/depozituar në cilësinë e provës: vërtetimin nr. *** prot., datë 9.2.2021, të lëshuar nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, lidhur me të ardhura shtesë të përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga mbingarkesa e orëve të leksioneve, nga shpërblime, nga pjesëmarrje në konferenca dhe nga anëtarësia në këshillin e fakultetit, të cilat në vitin 2005 kanë qenë në masën 230,429 lekë.
71. Gjithashtu, lidhur me vitin 2007, subjekti ka pretenduar se për pagesën e kryer për likuidimin e këstit të fundit për blerjen e apartamentit dhe garazhit, në vlerën 7,800 euro, Komisioni duhet të marrë në konsideratë kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, si dhe ka paraqitur një analizë financiare të kryer nga një ekspert kontabël së bashku me: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 9.2.2021, nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga mbingarkesa në orare, shpërblime, pjesëmarrje në konferenca dhe nga anëtarësia në këshillin e fakultetit, të cilat në vitin 2007 kanë qenë në masën 27,000 lekë; dhe (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata e Apelit Vlorë, ku janë shtuar edhe shpërblimet e marra nga subjekti ndër vite, ku për vitin 2007 ka një diferencë prej 6,789 lekësh.

Vlerësimi i trupit gjykues

72. Nga analizimi i provave të sjella nga subjekti, në raport me rezultatet e hetimit lidhur me dy mungesat financiare për vitet 2005 dhe 2007, trupi gjykues vlerëson se dokumenti vërtetim, Nr. *** Prot, datë 09.02.2021, i lëshuar nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, konfirmon të ardhura shtesë të përfituara nga bashkëshorti i subjektit si shpërblime, nga pjesëmarrje në konferenca dhe nga anëtarësia në këshillin e fakultetit të cilat nuk ishin përfshirë pasi nuk kanë qenë pjesë e vërtetimeve të lëshuara më parë nga universiteti dhe janë paraqitur nga subjekti, gjatë procesit të rivlerësimit, konkretisht pas njohjes me rezultatet e hetimit. Nga shqyrtimi i llogarive bankare, konstatohet se këto të ardhura janë transferuar edhe nëpërmjet llogarive bankare dhe, për rrjedhojë, duhet të shtohen në analizën financiare, për efekt të të cilave rezultati financiar negativ për vitin 2005 ndryshon në një balancë pozitive prej 153,572 lekësh.
73. Gjithashtu, këto të ardhura nuk ishin përfshirë as në analizën e vitit 2007, pasi siç u përmend edhe më sipër, ato nuk kanë qenë pjesë e vërtetimeve të lëshuara më parë nga

universiteti në fjalë, si dhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, por janë paraqitur nga subjekti pas njohjes me rezultatet e hetimit. Por, duke konsideruar edhe faktin se nga shqyrtimi i llogarive bankare është konstatuar se këto të ardhura janë kanalizuar nëpërmjet bankës vlerësohet se ato duhet të shtohen/përfshihen në analizën financiare, për efekt të të cilave rezultati financiar negativ, i njoftuar me rezultatet e hetimit, lidhur me analizën financiare të vitit 2007 ndryshon nga – 120,644 lekë në – 68,514 lekë.

74. Për sa i përket pretendimit tjetër të shprehur nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me kursin e këmbimit, gjendet me vend të qartësohet se Komisioni, në këtë rast, ka marrë në konsideratë si referencë kohore pikërisht deklarin e bërë nga subjekti në DIPP-në përkatëse, në të cilën është shprehur: “Nga kursimet e vitit në vlerën 977,160 lekë është shlyer një pjesë e huas së marrë në shumën 7,800 euro. Pra, vlera e shtuar dhe, njëkohësisht e pakësuar në lekë, është 977,160 lekë”. Për rrjedhojë, pretendimi se duhet marrë një tjetër datë referuese nuk qëndron, pasi rezulton i pambështetur në prova konkrete.

4. Apartament banimi me sipërfaqe 45.77 m², në O., Vlorë

75. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010, përfituar sipas kontratës së shitblerjes me rezervë nr. ***, datë 17.12.2010, me çmim blerjeje 2,600,000 lekë dhe për të cilën ishte parapaguar shuma prej 2,000,000 lekësh. Si burim krijimi është deklaruar se ka shërbyer kredia e marrë nga “Raiffeisen Bank”⁴⁷. Gjithashtu është deklaruar në rubrikën përkatëse edhe detyrimi i mbetur pa shlyer në vlerën 600,000 lekë ndaj palës shitëse.
76. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit në O., Vlorë, të ardhurat nga pagat, kursimet, pjesërisht nga kredia, si dhe të ardhura nga shitja e librit universitar.
77. Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së apartamentit në fjalë, si dhe ka deklaruar shlyerjen e këstit të fundit në shumën 600,000 lekë, pa e specifikuar burimin e krijimit të kësaj shume.
78. Për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
- i. kontratë shitblerjeje me rezervë nr. ***, datë 17.12.2010, në të cilën pala shitëse R. dhe N. M.⁴⁸ kanë rënë dakord t’i shesin shtetasit L. B. pasurinë e llojit apartament me sip. banimi 45.77 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, në O., Vlorë, kundrejt çmimit total 2,600,000 lekë. Palët kanë deklaruar në këtë kontratë se kanë likuiduar shumën prej 2,000,000 lekësh *cash* dhe se shuma prej 600,000 lekësh do të likuidohej më vonë, për një periudhë të pacaktuar;
 - ii. mandat urdhërpagese nga “Alpha Bank” datë 27.12.2010, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka kredituar shumën 2,000,000 lekë në favor të palës shitëse N. M. me përshkrimin “likuidim për blerje apartamenti”;
 - iii. me shkresën nr. *** prot., datë 11.6.2020, “Alpha Bank” ka vënë në dispozicion lëvizjet e llogarisë së palës shitëse N. M., në të cilën është konfirmuar transfera e sipërcituar e datës 27.12.2010, në shumën 2,000,000 lekë⁴⁹ nga subjekti i rivlerësimit;

⁴⁷ Kjo kredi është disbursuar në datën 2.12.2010.

⁴⁸ Kjo pasuri është fituar me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.4.2010, nga ku rezulton se shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse i shet z. R. M. me cilësinë e blerësit “apartament banimi” me sip. 59.24 m², me çmim 2,600,000 lekë i paguar jashtë zyrës noteriale.

⁴⁹ Këto fonde rezultojnë të jenë vendosur nga pala shitëse në depozitë me afat në “Alpha Bank”, deri në datën 2.12.2011.

- iv. kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.9.2013, lidhur midis palës shitëse R. dhe N. M. dhe palës blerëse L. dhe Iliba Bezati, ku palët kanë deklaruar se është likuiduar i gjithë çmimi për blerjen e apartamentit⁵⁰;
- v. vërtetim nga dokumentet hipotekore të datës 2.10.2013, ku vërtetohet se pasuria me nr. ***, z. k. *** është e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit;
- vi. me shkresën nr. *** prot., datë 25.5.2018, ZQRPP-ja ka bashkëngjitur përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë, e cila ka konfirmuar se: *“Nga verifikimet e kryera në regjistrat hipotekorë figuron i regjistruar apartament banimi me nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, O., Vlorë në emër të palës shitëse R. M. dhe se ky është një gabim i subjektit menaxhues dhe për korrigjimin e tij duhet të paraqitet njëri nga bashkëpronarët⁵¹;*
- vii. ASHK Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2020, ka konfirmuar se në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, rezulton e regjistruar ndër të tjera, edhe pasuria me z. k. ***, datë 2.10.2013 dhe ka bashkëngjitur dosjen e pasurisë në fjalë nga arkiva;
- viii. kontratë kredie nr. ***, datë 30.11.2010, lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe “Raiffeisen Bank”, për marrjen e kredisë në vlerën 4,200,000 lekë me objekt “blerje shtëpie” sipas kontratës me nr. ***, të datës 18.11.2010;
- ix. kontratë premtim - shitje apartamenti me nr. ***, datë 18.11.2010, me palë shitëse të ardhshme F. H. dhe G. B.⁵² dhe palë blerëse të ardhshme L. B. për blerjen e apartamentit në lagjen “****”, Vlorë, kundrejt çmimit 72,000 euro;
- x. deklaratë noteriale nr. ***, ku pala shitëse e ardhshme F. H. dhe G. B., për arsye të ngutshme të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, kanë rënë dakord për “zgjdhjen e kontratës premtim - shitje apartamenti me nr. ***, të datës 18.11.2010”.

4.1. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

79. Siç u përmend edhe më lart, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2010, si burim krijimi për pagesën pjesore prej 2,000,000 lekësh, kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank” dhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e apartamentit në O., Vlorë, të ardhurat nga pagat, kursimet, pjesërisht nga kredia, si dhe të ardhura nga shitja e librit universitar. Në vijim pasqyrohen/analizohen zërat përkatës të këtyre të ardhurave.

4.1.1 Kredia në shumën 4,200,000 lekë, në “Raiffeisen Bank”

80. Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se kredia në “Raiffeisen Bank” është marrë me qëllim blerjen e apartamentit në lagjen “****”, Vlorë, kundrejt çmimit total prej 72,000 euro, referuar kontratës së premtim-shitjes me nr. ***, të datës 18.11.2010, të lidhur midis bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe palës shitëse të ardhshme, F. H. dhe G. B.. Në datën 19.11.2010, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. shumën 2,991,600 lekë. Në datën 9.12.2010 është disbursuar kredia në shumën 4,200,000 lekë nga “Raiffeisen Bank” në favor të subjektit të rivlerësimit dhe nga llogaria e kësaj të fundit është transferuar në llogarinë e shoqërisë

⁵⁰ Nuk rezulton të ketë bashkëlidhur shlyerjen e detyrimit prej 600.000 lekësh, çka nënkupton se kjo pagesë duhet të jetë bërë jashtë sistemit bankar.

⁵¹ ZRPP-ja Vlorë thekson se zona e O. ka qenë zonë e pa menaxhuar dhe i është nënshtruar regjistrimit fillestar sistematik dhe ka hyrë në sistem në vitin 2014. Nga kompania e menaxhimit pasuria e mësipërme është pasqyruar në pronësi të palës shitëse, konkretisht z. R. M. dhe numri i pasurisë nga *** është bërë ***. Për të kryer korrigjimin e këtij gabimi duhet që njëri prej bashkëpronarëve Bezati, të paraqitet për të aplikuar për pajisjen me certifikatë pronësie.

⁵² Të përfaqësuar në këtë kontratë me prokurë të posaçme nga z. I. I..

“***” sh.p.k.⁵³ shuma prej 4,200,000 lekësh me përshkrim “prenotim apartamenti”. Gjithashtu është konstatuar se në të njëjtën datë 9.12.2010 është nënshkruar një deklaratë noteriale nr. ***, ku pala shitëse e ardhshme - shtetasit F. H. dhe G. B. - për arsye të ngutshme të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, kanë rënë dakord me këtë të fundit për zgjidhjen e kontratës së premtim shitje apartamenti me nr. ***, të datës 18.11.2010⁵⁴ dhe kthimin e të gjithë shumës së paguar. Për rrjedhojë, në po të njëjtën datë 9.12.2010, nga ana e z. F. H.⁵⁵ është depozituar *cash* në llogarinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, në “Alpha Bank”, shuma prej 4,200,000 lekësh.

81. Me fondet e rikthyera në dispozicion, në shumën prej 4,200,000 lekësh, në datën 27.12.2010, është kryer transferimi nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në “Alpha Bank”, i shumës 2,000,000 lekë⁵⁶ në llogari të znj. N. M. për blerjen e apartamentit në O., Vlorë.
82. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit me pyetëtorin nr. 4, për të sqaruar dinamikën e pagesave dhe mospërputhjen e datës së pagesës së kryer prej 2,000,000 lekësh në datën 27.12.2010, ndërkohë që në përmbajtjen e kontratës shprehet se *shuma është likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës, pra 17.12.2010.*
83. Në përgjigje të pyetëtorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Ditën e lidhjes së kontratës së shitjes me rezervë, datë 17.12.2010, unë shkova në ‘Alpha Bank’ për të tërhequr shumën e këstit, në vlerën 2.000.000 lekë, ndaj edhe palët e kontratës janë shprehur se shuma e mësipërme është likuiduar po atë ditë cash, jashtë zyrës noteriale. Nga ana e bankës m’u refuzua dhënia e kësaj shume, sepse ajo më informoi që shuma është e madhe dhe se për një veprim të tillë operacional nevojitej një lajmërim paraprak. E bëra kërkesën dhe ika me premtimin se do të më njoftonin menjëherë sapo të bënin gati shumën, të cilën do ta tërhiqja cash në sportel. Banka më vonoi në këtë procedurë, më thirri pas disa ditësh, ku edhe u paraqita me kontratën në dorë, duke shfaqur shqetësimin tim për vonesën e këtij shërbimi. Punonjësi i bankës lexoi emrat e shitësve në kontratë dhe pasi konstatoi se shitësit ishin klientë të po kësaj banke, më kërkoi që të mos e tërhiqja shumën, por ta kaloja me transfertë nga llogaria ime në llogarinë e tyre. Me ardhjen në dijeni të këtij fakti dhe pasi komunikuam me shitësit, ramë dakord për transfertën, gjë që pasqyrohet edhe te mandati i urdhërpagesës/internal transfer te rubrika e përshkrimit.”*
84. Me fondet e mbetura prej 2,200,000 lekësh⁵⁷ subjekti i rivlerësimit ka çelur depozitë bankare në “Alpha Bank”, në datën 9.12.2010, me burim të deklaruar nga kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”.
85. Lidhur me kthimin e shumës prej 2,991,600 lekësh⁵⁸, subjekti i rivlerësimit është pyetur nëpërmjet pyetëtorit nr. 3, në përgjigje të të cilit ka sqaruar se kjo shumë është kthyer *cash* nga shtetasi F. H. te bashkëshorti. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetëtorit nr. 3, ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. ***, datë 18.11.2010, në

⁵³ Ndërkohë që shitësi në kontratën e prenotimit nuk është shoqëria “***” sh.p.k., por shtetasit F. H. dhe G. B., në cilësinë e palës shitëse të ardhshme.

⁵⁴ Rezulton se në deklaratën noteriale është përshkruar numri i lejes së ndërtimit i ndryshëm nga ai i përmendur në kontratën e premtim shitjes. Në përgjigje të pyetëtorit nr. 2, subjekti sqaron se kemi të bëjmë me një gabim material nga ana e noterës.

⁵⁵ Është bërë fillimisht depozitimi i shumës prej 4,200,000 lekësh nga subjekti, më pas rezulton të jetë anuluar si veprim dhe të jetë bërë depozitimi nga z. F. H..

⁵⁶ Fondet përdoren nga depozita në shumën 4,200,000 lekë dhe riçelet depozitë me shumën e mbetur prej 2,200,000 lekësh në “Alpha Bank”.

⁵⁷ Fondet e kthyera nga z. F. H..

⁵⁸ Shuma e paguar nga z. L. B. për këstin e parë të blerjes së apartamentit.

të cilën bashkëshorti i saj ka deklaruar se ka marrë hua nga znj. M. B., shumë prej 3,000,000 lekësh *cash* për pagesën e këstit të parë të apartamentit prej 2,991,600 lekësh. Ndërkohë ka rezultuar se me deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.12.2010, znj. M. B. ka deklaruar se z. L. B. i ka kthyer *cash* shumë e marrë hua 3,000,000 lekë.

86. Për të vërtetuar burimin e ligjshëm të huas së dhënë nga znj. M. B., subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit aktmarrëveshjen noteriale me nr. ***, të datës 28.9.2009, lidhur ndërmjet shtetasve M. B., L. dhe F. N., për shitjen e dy pasurive⁵⁹ të llojit truall, në Lezhë, në shumë totale prej 16,000,000 lekësh. Sipas aktmarrëveshjes në fjalë, shuma totale do të paguhej me këste dhe këto pagesa do të kryheshin *cash*. Vlera prej 6,000,000 lekësh, e cila përbënte këstin e parë do të merrej nga znj. M. B. në ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate/aktmarrëveshjeje, jashtë zyrës noteriale⁶⁰.
87. Lidhur me këto dy pasuri, Komisioni i është drejtuar ASHK-së Lezhë, për të vënë në dispozicion kontratat e shitblerjes së pasurive të sipërcituara dhe informacionin mbi çmimin mesatar dhe çmimin e referencës për shitblerjen e pasurive në fjalë, përgjatë viteve 2008 – 2011. ASHK Lezhë, me shkresën nr. *** prot., datë 24.8.2020, ka vënë në dispozicion kontratat e shitblerjeve, përkatësisht nr. ***, datë 12.10.2011 dhe nr. ***, datë 12.10.2011, kundrejt çmimeve 5,714,240 lekë dhe 11,020,320 lekë⁶¹.
88. Nga vërtetimet hipotekore rezulton se në datën 5.10.2011 janë kryer rivlerësimet e pasurive përkatësisht në vlerat 5,714,240 lekë dhe 11,020,320 lekë, që përkojnë me çmimet e shitjeve në kontratat e shitblerjeve. Bashkëngjitur dokumentacionit të dërguar nga ASHK Lezhë ndodhen fletët llogaritëse të tatimit për kalimet e të drejtave të pronësisë, nga ku konstatohet se vlera në shitje e pasurive në fjalë për metër katror është 25,510 lekë. Për rrjedhojë nuk janë konstatuar problematika.

4.1.2. Lidhur me të ardhurat nga shitja e librit universitar

89. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përveç kredisë bankare, si burim krijimi për blerjen e apartamentit në O., Vlorë, kanë shërbyer edhe të ardhurat nga pagat, kursimet, si dhe të ardhura nga shitja e librit universitar të bashkëshortit. Këto burime mund të ishin përdorur për pagesën e këstit të dytë prej 600,000 lekësh në vitin 2013. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga shitja e librit universitar “M. për F. e E.”, në të cilin bashkëshorti është bashkautor, në vlerën 365,000 lekë, të cilat më pas kanë kaluar në depozitë në “Raiffeisen Bank” në datën 11.11.2011.
90. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare ka rezultuar se në llogarinë e bashkëshortit L. B. ka kaluar me përshkrimin “likuidim për 234 libra”, nga z. A. D. vetëm shuma prej 350,000 lekësh dhe me gjithë gjendjen në llogari prej 15,000 lekësh është çelur më pas depozita në datën 18.1.2012, në shumë 365,000 lekë. Kjo shumë (365,000 lekë) është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi për shlyerjen e kredisë në “Raiffeisen Bank” në datën 15.5.2012 (në masën 251,100 lekë) dhe për blerjen e apartamentit në O., Vlorë, në vitin 2013, shuma prej 112,900 lekësh.
91. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se pjesa e mbetur prej 112,900 lekësh, nga depozita e krijuar kryesisht nga të ardhurat nga shitja e librit universitar prej 365,000 lekësh, është investuar në datën 15.5.2012 dhe ka vazhduar të riinvestohet deri në datën 17.4.2015, në të cilën shuma është tërhequr nga bashkëshorti i

⁵⁹ Znj. M. B. ka rezultuar bashkëpronare.

⁶⁰ Për këto pasuri janë nënshkruar më pas kontratat e shitjes në datën 12.10.2011, ku palët kanë deklaruar se janë likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.

⁶¹ Në total vlera 16,734,560 lekë.

subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të ishte përdorur si burim për shlyerjen e këstit të dytë për blerjen e apartamentit në O., Vlorë, në vitin 2013.

4.1.3. Të ardhura nga pagat dhe kursimet, pa vlerë të përcaktuar

92. Në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësin nr. 2, subjekti shprehet se për shlyerjen e çmimit total prej 2,600,000 lekësh të apartamentit në O., Vlorë, janë përdorur si burim edhe të ardhurat nga kursimet dhe pagat.
93. Nga dokumentacioni i administruar, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë realizuar gjatë vitit 2013, të ardhura totale nga punësimet përkatëse, qiraja dhe ushtrimi i aktivitetit privat të bashkëshortit, në masën 4,392,098 lekë. Në analizë janë konsideruar edhe tërheqjet e kryera nga llogaritë e pagave të subjektit dhe bashkëshortit deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, si dhe të ardhurat nga qiraja dhe aktiviteti i bashkëshortit⁶².
94. Nga analiza financiare, pasi janë përlllogaritur shpenzimet jetike për një periudhë 9-mujore, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për përballimin e pagesës së këstit të dytë për blerjen e apartamentit në fjalë në vlerën 600,000 lekë, si dhe shpenzimet e tjera, me burime të ligjshme financiare.

Tabela nr. 6 – Mundësitë për pagesën e këstit të dytë të apartamentit në O., Vlorë

Përshkrimi	Shuma
Tërheqjet 01.01-18.09.2013	1 347 400
Të ardhura nga qiradhënia	450 000
Të ardhura nga aktiviteti bar-kafe L. B.	545 318
Paguar kësti i fundit të apartamentit në Orikum	(600 000)
Shpenzime 01.01-18.09.2013	(1 313 293)
Rezultati	429 424

5. Apartament banimi me sipërfaqe 82 m², në Vlorë, në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit

95. Në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e paluajtshme me nr. ***, z. k. ***, me sip. 80 m², në bashkëpronësi me pjesën takuese 1/4, të fituar nga ligji “Për privatizimin”, me anë të kontratës së privatizimit të banesës datë 24.7.1994, të lidhur ndërmjet N. K. Banesa dhe qiramarrësit O. B.⁶³, me çmimin 21,326 lekë.
96. Me shkresën nr. *** prot., datë 7.8.2017 është konfirmuar nga ZVRPP-ja pasuria e llojit apartament me sip. 82 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***. Gjithashtu, nga vendimi për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 16.12.2013, rezulton se pas vdekjes së z. O. B.⁶⁴ është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për të ndjerin.
97. Certifikata për vërtetimin e pronësisë me nr. serie ***, është lëshuar në datën 22.2.2014, në emër të shtetasve M., V. dhe L. B..

⁶² Këto janë përlllogaritur në mënyrë përpjesëtimorë në raport me fitimin total *neto* të vitit 2013.

⁶³ Shkresa nr. *** prot., datë 25.5.2018, e ZQRPP-së Tiranë, ka bashkëlidhur dokumentacionin.

⁶⁴ Babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

98. Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rregullisht shtimin e pjesës takuese të bashkëshortit si bashkëpronar në apartamentin e banimit në Vlorë nga 1/4 në 3/8, trashëguar nga pjesa takuese e babait.
99. Nga analiza e dokumentacionit të lartpërmendur, përgjatë hetimit administrativ nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.
- 6. Pasuri e paluajtshme, truall me sipërfaqe 660 m², në Vlorë, në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit**
100. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit rezultoi të jetë bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme të tipit truall me sip. 660 m², të përfituar nga trashëgimia ligjore⁶⁵. ZVRPP-ja Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.1.2018, ka konfirmuar se në emër të shtetasit L. B. rezultoi e regjistruar në bashkëpronësi⁶⁶ pasuria e paluajtshme e llojit truall, me sip. 660 m², z. k. ***, me 1/10 pjesë, nr. pasurie ***.
101. Kjo pasuri është përfituar me vendimin nr. ***, datë 8.11.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në të cilin është vendosur që trashëgimtarët e të ndjerës L. B. (P.) janë bashkëshorti O. B. dhe fëmijët V. dhe L. B.. Këta të fundit janë trashëgimtarë ligjorë, gjithashtu, të shtetasve J. dhe K. P. (gjyshi dhe gjyshja).
102. Në DIPP-në e vitit 2005 konstatohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk e ka deklaruar pjesën takuese mbi pasurinë në bashkëpronësi, si trashëgimtar i radhës së parë i të ndjerëve L. B. (P.), J. dhe K. P.. Në DIPP-në e vitit 2011 është deklaruar për herë të parë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nënshkrimi i kontratës së sipërmarrjes datë 4.11.2011 me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., për ndërtimin e një objekti shumëkatësh në Vlorë në truallin mbi të cilin është bashkëpronar me 1/15 e pjesës takuese, sipas kontratës noteriale nr. *** rep., datë 4.11.2010. Për këtë ndërtim ishte marrë leja e ndërtimit që në vitin 2011.
103. Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.5.2012, babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka hequr dorë nga pjesa takuese e trashëgimisë, duke e kaluar në pjesë të barabarta ndërmjet fëmijëve të tij, L. dhe V. B..
104. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar që të jetë lidhur një aktmarrëveshje⁶⁷ me nr. ***, datë 5.6.2013, me shoqërinë ndërtuese “****”⁶⁸ sh.p.k., për caktimin në natyrë të pjesëve takuese të pronarit të truallit mbi objektin shumëkatësh në Vlorë, nga ku palët kanë rënë dakord që shtetasi L. B., në titullin e pronarit të truallit, do të marrë dy njësi shërbimi me sipërfaqe, përkatësisht, 53.4 m² dhe 54.6 m².
105. Ka rezultuar se nuk është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2013 aktmarrëveshja e nënshkruar për përfitimin e dy pasurive të paluajtshme njësi shërbimi, përkatësisht, me sip. 53.4 m² dhe 54.6 m² (në total 108 m²). Por palët kanë nënshkruar më pas një deklaratë noteriale nr. ***, datë 3.11.2018, ku kanë rënë dakord që njësi me sip. 54.6 m², e ndodhur në katin e parë, do të zëvendësohej me një njësi në katin përdeh me sip. 42.27 m² dhe sipërfaqja totale që z. L. B. do të përfitojë në bazë të kësaj deklarate është 95.67 m².
106. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar me shoqërinë ndërtuese “****” sh.p.k., kontratën e shkëmbimit nr. ***, datë 2.3.2019, në të cilën palët kanë rënë dakord

⁶⁵ L. B. (P.), vërtetuar kjo me certifikatën e pronësisë datë 30.7.2007, kartelë e pasurisë nr. ***, vol. ***, f. ***.

⁶⁶ Pas heqjes dorë nga babai i tij.

⁶⁷ Aktmarrëveshje nr. ***, datë 5.6.2013, midis L. B. dhe investitorit “****” sh.p.k., për ndërtimin e godinës së banimit shumëkatësh, leje ndërtimi, lëshuar më 9.1.2012.

⁶⁸ Deklaruar në deklaratën *Vetting*.

se në këmbim të pjesës takuese mbi truallin me sip. 660 m², shtetasi L. B. do të përfitojë pasurinë e llojit “Njësi” me sipërfaqe totale 95.67 m², të ndodhur në katin përdhes të objektit “godinë banimi dhe shërbimi 12 kat me observator, 2 kate dyqane dhe 1 kat nëntokë”, të ndërtuar në lagjen “****”, Vlorë.

107. ASHK Vlorë, përgjatë hetimit administrativ, me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2020, ka konfirmuar se në emër të shtetasit L. B. figuron e regjistruar pasuria “Njësi” me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 95.67 m².
108. Nga analiza e dokumentacionit të lartpërmendur, përgjatë hetimit administrativ nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.

7. Automjet tip “Volkswagen Golf 4”

109. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2007 dhe më pas në deklaratën *Vetting*, si e blerë në vitin 2007 në vlerën 1,870 euro dhe për të cilën është paguar detyrimi doganor në vlerën 201,000 lekë.
110. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si burim krijimi për blerjen dhe zhdoganimin e këtij automjeti kanë shërbyer kursimet.
111. Lidhur me këtë pasuri Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
 - i. kontratë shitblerjeje e datës 7.2.2007, në gjuhën gjermane, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar, lidhur midis palës shitëse A. Gj., me banim ne adresën *** G. dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit tip “Volkswagen” me nr. shasie ***, në shumën 1,870 euro (ose ekuivalenti 226,102 lekë);
 - ii. aktzhdoganimi të automjetit tip “Volkswagen Golf” në datën 10.2.2007 nga z. L. B., në shumën 200,990 lekë;
 - iii. DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2017, ka konfirmuar se shtetasi L. B. ka në pronësi automjetin me targa ***;
 - iv. me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2018, DPSHTRr-ja ka informuar se automjeti tip “Volkswagen” me targa *** është hequr nga qarkullimi përfundimisht në datën 22.11.2017.

7.1. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

112. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se burimi i krijimit për blerjen dhe zhdoganimin e këtij automjeti janë të ardhurat dhe kursimet. Është konstatuar se në DIPP-të e periudhës 2003 – 2006, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë gjendje *cash* apo kursime të disponuara në banesë. Në këto kushte, Komisioni ka kryer analizën duke filluar nga data 1.1.2007 e deri në datën 7.2.2007, për të përcaktuar mundësitë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, për të kursyer shumën prej 427,092 lekësh, të shpenzuar për blerjen dhe zhdoganimin e automjetit në analizë.
113. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur disponibilitet *cash* sipas tërheqjeve nga llogaritë e tyre bankare, në shumën totale prej 191,000 lekësh. Nga Komisioni janë zbritur gjithashtu edhe shpenzimet jetike për familjen e subjektit të rivlerësimit për muajin janar të vitit 2007, në masën 41,030 lekë⁶⁹.

⁶⁹ Shpenzimet jetike për vitin 2007 janë konsideruar si një mesatare e shpenzimeve të viteve 2006 dhe 2008.

114. Nga analiza financiare ka rezultuar se për blerjen e automjetit në fjalë dhe zhdoganimin e tij, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme në masën – 277,121 lekë.

Tabela nr. 7 – Analiza e burimeve të përdorura për blerjen

Përshkrimi	Shuma
Tërheqjet 01.01-07.02.2007	191 000
Shpenzime jetese janar 2007	(41 030)
Blerja dhe zhdoganimi i automjetit VL***C	(427 092)
Rezultati	(277 121)

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

115. Pasi është njohur me rezultatin e mësipërm financiar, për të cilin i ishte kaluar barra e provës, subjekti është shprehur se: *“Këtë automjet e ka blerë bashkëshorti dhe burimin për blerjen e kësaj pasurie e kam saktësuar dhe deklaruar në deklaratën Vetting, se për blerjen dhe zhdoganimin e këtij automjeti, kanë shërbyer kursimet ne vite. Në DIPP-në e vitit 2005, nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie, kjo jo për shkak të mungesës së mjeteve monetare të disponueshme nga ana ime, por për shkak të mungesës së informacionit për mënyrën se si duhej të plotësohej kjo deklaratë. Gjithashtu, edhe deklaratat e pasurive të viteve 2003, 2004 dhe 2005 janë deklaratat e viteve të para, të plotësuara në një mungesë informacioni mbi mënyrën e plotësimit dhe deklarimit të pasurisë, ndaj edhe mungesa e udhëzimeve të sakta për plotësimin e DPV-së është bërë shkak për moscitimin e tepricave të mjeteve monetare. Në kushtet e mungesës së një dokumentacioni analitik për të hartuar një evidencë të buxhetit të familjes, të shpenzimeve, të ardhurave, të detyrimeve, gjendjes së likuiditetit dhe lëvizjes së pasurisë neto, ka gjasa që të bëhen gabime në deklarime, veçanërisht në gjendjen cash në fund të vitit. Nëse gjendjen cash në fund të vitit ekspertët e konsiderojnë në vlerën zero për shkak se nuk është deklaruar, kjo nuk do të thotë se çdo familje në fund të vitit i ka harxhuar të gjitha mjetet monetare, por dihet që çdo familje nuk e fillon vitin e ri me gjendje zero cash. Gjithashtu, për shkak të traditës së krijuar në familjet shqiptare, pra edhe në familjen tonë, ku improvizohen arka kursimi gjatë vitit dhe ato hapen në fund të vitit, kjo do të thotë se edhe sa i përket gjendjes cash në familje, asnjëherë ky cash nuk është zero, por ka një vlerë pozitive, qoftë kjo edhe vlerë minimale, por asnjëherë zero. Sa më sipër, vlerësoj se kemi pasur burime financiare të ligjshme në masën 277,121 lekë.”*

Vlerësimi i trupit gjykues

116. Lidhur me sa më sipër, për sa kohë nga subjekti nuk janë deklaruar kursime të disponuara në banesë në fund të vitit pararendës, mundësia e disponimit të shumës prej 277,121 lekësh, mbetet vetëm në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se rezultati i njoftuar pas mbylljes së hetimit administrativ, për këtë pasuri nuk ndryshojë nga shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ndonëse pesha e mungesës financiare, parë në proporcionalitet me tërësinë e rastit, nuk mund të përbëjë shkak për aplikimin e ndonjë mase.

8. Automjet tip “Peugeot 308”

117. Ky automjet është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2008, me burim krijimi pjesërisht nga kursimet dhe pjesërisht me kredi nga “Alpha

Bank”, duke specifikuar se nga kursimet e vitit ka shlyer një pjesë të çmimit të blerjes së automjetit, në shumën 5,175 euro, si dhe ka deklaruar marrjen e kredisë në “Alpha Bank” në shumën 12,500 euro. Në DIPP-të e viteve 2008 – 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rregullisht në rubrikën përkatëse të detyrimeve, shlyerjen e kredisë në “Alpha Bank” dhe detyrimin e mbetur.

118. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Peugeot 308”, të blerë në vitin 2008 pjesërisht nga kursimet dhe pjesërisht me kredi. Në të dhënat konfidenciale ka përshkruar se shuma prej 12,500 euro është fituar nga kredia e marrë në “Alpha Bank”, e cila më pas është shlyer totalisht.
119. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 4, që të vinte në dispozicion dokumentacionin që provon mënyrën dhe kohën e pagesave të kryera për blerjen e automjetit, në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.
120. Në përgjigje të tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Referuar kontratës lidhur më datë 3.11.2008, me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. është paguar shuma 200 euro cash nga unë, menjëherë, ditën e lidhjes së kontratës së shitjes, datë 3.11.2008 në ambientet e shoqërisë ‘***’ sh.p.k. Shuma 5,013 euro është paguar për llogari të shoqërisë ‘***’ sh.p.k., nga unë në ‘Alpha Bank’, në datën 4.11.2008, me depozitim cash. Menjëherë sapo kam kryer parapagimin, nëpërmjet kredisë që ‘Alpha Bank’ më ka akorduar, vlera e mbetur e çmimit të automjetit prej 12,162 euro është financuar nga banka, duke u shlyer kështu plotësisht në datën 13.11.2008 detyrimi ndaj shoqërisë ‘***’ sh.p.k. për pagimin e çmimit të automjetit në vlerën 17,375 euro”.*
121. Lidhur me këtë pasuri Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
 - i. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.11.2008, lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit në cilësinë e palës blerëse dhe shoqërisë “****” sh.p.k.,⁷⁰ në cilësinë e palës shitëse për blerjen e automjetit tip “Peugeot 308”, me nr. shasie ***, kundrejt çmimit total 17,375 euro. Në këtë kontratë është përcaktuar mënyra e pagesës, e cila do të kryhej:
 - a) shuma 200 euro parapagim në llogarinë e shoqërisë shitëse “****” sh.p.k.;
 - b) shuma 5,013 euro do të kryhej parapagim në “Alpha Bank”;
 - c) diferenca prej 12,162 euro do të paguhej nga “Alpha Bank”.
 - ii. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2018, DPSHTRr-ja ka konfirmuar automjetin tip “Peugot”, me targa ***, të regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.
 - iii. Shkresë nr. *** prot. - ***, datë 7.5.2020, nga shoqëria “****” sh.p.k., ku kjo e fundit ka konfirmuar kryerjen e pagesave nga subjekti i rivlerësimit sipas përcaktimeve në kontratën e shitblerjes. Shoqëria ka bashkëngjitur gjithashtu lëvizjet e llogarisë së saj bankare në “Alpha Bank”, në të cilën konfirmohet derdhja e shumës prej 5,013 euro nga subjekti i rivlerësimit në datën 4.11.2008 dhe transferta e shumës prej 12,162 euro, në datën 13.11.2008 me përshkrimin “sa kaluar nga Iliba Bezati për ‘***’ sh.p.k., likuidim përfundimtar për blerjen e automjetit të ri tip ‘Peugeot’, sipas kontratës nr. ***, datë 3.11.2008”.
 - iv. Shkresë nr. *** prot., datë 14.5.2020, nga “Alpha Bank”, në të cilën konfirmohen dy pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit si më lart.

⁷⁰ Përfaqësuar në këtë kontratë nga administratori i përgjithshëm, z. A. T..

- v. Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016 nga “Alpha Bank”, në të cilin ka konfirmuar shlyerjen e kredisë në shumën 12,500 euro, nga subjekti i rivlerësimit.

8.1. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

122. Në DIPP-në e vitit 2008 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit pjesërisht nga kursimet dhe pjesërisht nga kredia në “Alpha Bank”.
123. Shuma prej 12,162 euro është siguruar nga kredia bankare, marrë nga subjekti i rivlerësimit në “Alpha Bank”, e cila është konfirmuar nga dokumentacioni i ardhur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, nga shoqëria shitëse dhe “Alpha Banka.
124. Rrjedhimisht, kursimet mund të ishin përdorur nga subjekti i rivlerësimit si burim për pagesën e diferencës prej 5,213 euro, të cilat janë paguar 200 euro *cash* në arkën e shoqërisë shitëse në datën e nënshkrimit të kontratës 3.11.2008 dhe 5,013 euro derdhur në llogarinë bankare të shoqërisë në datën 4.11.2008.
125. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se gjatë vitit 2008 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë realizuar të ardhura në shumën 2,037,695 lekë⁷¹.

Tabela nr. 8 – Analiza financiare e vitit 2008

Përshkrimi	Shuma
Blerja e automjetit P*** 308	(2 140 296)
Të ardhura të vitit 2008	2 037 695
Kredi në A*** Bank	1 539 781
Ndryshimi në likuiditetet	(22 407)
Shpenzime të vitit 2008	(1 233 884)
Rezultati i vitit 2008	180 890

126. Nga analiza e dokumentacionit të lartpërmendur, përgjatë hetimit administrativ nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri, për sa kohë është deklaruar në mënyrë të saktë dhe nga analiza financiare ka rezultuar se familja e subjektit të rivlerësimit ka pasur mundësi për blerjen e automjetit në fjalë me burime të ligjshme financiare.

9. Çelje depozite në shumën 2,500,000 lekë, në vitin 2014, në “Fibank”

127. Kjo depozitë është deklaruar në DIPP-në e vitit 2014, me burim krijimi nga:
- kursimet e vitit 2013 në shumën 2,440,000 lekë⁷²; dhe
 - kursimet e vitit 2014 në shumën 60,000 lekë.
128. Lidhur me terminologjinë e përdorur nga subjekti i rivlerësimit, kursime të vitit, Komisioni ftoi këtë të fundit të sqaronte nëpërmjet pyetësorit nr. 4, mbi mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash* të disponuar në banesë ndër vite. Në përgjigje të tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “*Me termin kursime të vitit kemi pasur parasysh shumën cash (mjete monetare të lira) në banesë me atë në llogaritë tona likuiduese në banka, deri më 31 dhjetor të çdo viti deklarues.*”

⁷¹ Të ardhura nga punësimi i subjektit të rivlerësimit në masën 1,136,298 lekë, të ardhura nga punësimi i bashkëshortit në masën 530,023 lekë, të ardhura nga shitja e automjetit tip “Opel” në masën 346,374 lekë dhe të ardhura nga interesat e depozitës bankare në masën 25,000 lekë.

⁷² Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar shumën 2,440,000 lekë kursime të vitit, *cash*, të pa depozituara në asnjë bankë.

129. Përgjatë hetimit administrativ është konstatuar se në DIPP-në e vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka shtuar në krah të kursimeve të vitit - “cash të pa depozituara në asnjë bankë”. Lidhur me këtë deklaram, Komisioni iu ridrejtua me anë të pyetësorit nr. 5, në përgjigje të të cilit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kursimet e vitit 2013 përbëhen nga gjendja e mjeteve monetare të lira *cash* në banesë dhe mjetet monetare të lira në llogaritë likuiduese në banka dhe nuk përfshihen këtu shumat e mjeteve monetare që janë të depozituara në llogari kursimi ose të depozitave dhe se me shprehjen “të pa depozituara në asnjë bankë” ka nënkuptuar që këto mjete janë të lira dhe jo në llogari depozite në bankë. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën prej 2,500,000 lekësh në llogarinë e tij në “First Investment Bank”, në datën 18.4.2014.
130. Komisioni verifikoi llogaritë rrjedhëse bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në datën 31.12.2013, të cilat rezultuan në masën 1,662,793 lekë dhe sipas përgjigjes së subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 4, gjendja *cash* në banesë në fund të vitit 2013, do të ishte 777,207 lekë.
131. Për të konfirmuar sa më sipërshpjeguar nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me mënyrën e deklaramit në DIPP-të përkatëse, Komisioni analizoi mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të tërhequr nga llogaritë rrjedhëse të tyre shumën prej 1,662,793 lekësh, për të mundësuar më pas depozitim e shumës prej 2,500,000 lekësh (përfshirë gjendjen e disponuar *cash* në banesë), të kryer në datën 18.4.2014. Rezultoi se gjatë periudhës 1.4.2014 –18.4.2014, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë kryer tërheqjet nga llogaritë e tyre rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, BKT dhe “Tirana Bank”, në shumën totale 1,800,000 lekë.
132. Nga analiza e dokumentacionit të lartpërmendur, përgjatë hetimit administrativ nuk janë konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri, pasi është deklaruar saktë dhe nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi në vitin 2013 për kryerjen e investimeve, shpenzimeve dhe kursimeve të deklaramura, me burime të ligjshme financiare, si dhe ka pasur gjithashtu mundësi, në vitin 2014, për krijimin me burime të ligjshme financiare, të depozitës në fjalë, në shumën 2,500,000 lekë, në “Fibank”.
- 10. Çelje depozite në shumën 1,600,000 lekë, në “Credins Bank”, në vitin 2015**
- 11. Çelje depozite principal në shumën 2,400,000 lekë, në “Credit Agricole Bank” (sot ABI Bank) viti 2015**
133. Këto depozita në shumat, përkatësisht, 1,600,000 lekë dhe 2,400,000 lekë janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2015, me burim krijimi nga kursimet e vitit 2014⁷³ në masën 3,495,000 lekë dhe 505,000 lekë nga kursimet familjare të krijuara në 3-mujorin e parë të vitit 2015.
134. Nga analiza financiare e vitit 2014, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve të vitit⁷⁴ 2014, në masën e deklaruar prej 3,495,000 lekësh, me burime të ligjshme financiare.
135. Përgjatë hetimit administrativ është konstatuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën prej 1,600,000 lekësh në llogarinë e tij në “Credins Bank” dhe shumën 2,400,000 lekë në llogarinë e përbashkët me subjektin e rivlerësimit në “Credit Agricole Bank” (sot ABI Bank), në datën 17.4.2015.

⁷³ Në DIPP-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar kursime të vitit 3,495,000 lekë.

⁷⁴ Referuar shpjegimit të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 4, për termin “kursime të vitit”.

136. Komisioni ka verifikuar, gjithashtu, llogaritë rrjedhëse bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në datën 31.12.2014, të cilat rezultuan në masën 2,215,965 lekë dhe sipas përgjigjes së subjektit të rivlerësimit në pyetësonin nr. 4, gjendja *cash* në banesë në fund të vitit 2013, do të ishte 1,279,035 lekë.
137. Për të konfirmuar sa më sipërshpjeguar nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me mënyrën e deklaramit në DIPP-të përkatëse, Komisioni analizoi sërish mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të tërhequr nga llogaritë rrjedhëse të tyre shumën 2,215,965 lekë, për të mundësuar më pas depozitimimin e shumës prej 4,000,000 lekësh⁷⁵ (përfshirë gjendjen e disponuar *cash* në banesë) dhe kursimet e vitit 2015, në datën 17.4.2015. Gjatë periudhës 1.4.2015 – 17.4.2015 rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë kryer tërheqjet nga llogaritë e tyre rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, BKT dhe “Tirana Bank” në shumën totale 2,955,000⁷⁶ lekë, çka duket se përputhet me deklaramin e bërë nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin nr. 4 dhe në DIPP-në e vitit 2014.
138. Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës nr. *** prot., datë 19.12.2018, dhe nga analizimi i llogarive bankare në Bankën Amerikane të Investimeve (ish-Credit Agricole Bank), ka rezultuar që depozita në këtë bankë është maturuar më 18.4.2016 dhe së bashku me interesat e fituara, është riinvestuar në një depozitë 2-vjeçare në shumën 2,451,139.72 lekë. Në maturim të kësaj depozite të re, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, është kryer në datën 28.5.2018 transferimi i shumës 2,542,000 lekë në llogarinë e noteres M. Gj., Person Fizik, me përshkrimin “për blerje apartamenti me sip. 135.03 m², O., Vlorë, pasuria vol. ***, f. *** (kontratë shitje me këste)”.
139. Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, nga Banka Amerikane e Investimeve është dërguar edhe një kopje e kontratës së shitjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 2.6.2018, me palë shitëse R. dhe N. M. dhe palë blerëse L. B.. Kjo kontratë është konfirmuar edhe nga ASHK-ja Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2020.
140. Po ashtu, depozita në shumën 1,600,000 lekë në “Credins Bank”, së bashku me interesat e fituara ndër vite është transferuar në të njëjtën datë 28.5.2018, në favor të noteres M. Gj. PF me përshkrimin “blerje apartamenti L. B., vol. ***, f. ***, me sip. 135.03 m²”.
141. Sipas kontratës së shitjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 2.6.2018, çmimi total i apartamentit është 6,500,000 lekë, nga të cilat 2,542,000 lekë janë paguar nëpërmjet “ABI Bank” më 28.5.2018 dhe 1,645,000 lekë nga “Credins Bank”⁷⁷ në datën 28.5.2018 dhe diferenca do të paguhej brenda një afati 3-vjeçar nga data e nënshkrimit të kontratës.
142. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2018, me burim krijimi depozita nga “ABI Bank” dhe “Credins Bank”. Nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se pala shitëse R. dhe N. M. e ka blerë apartamentin me sip. 135.03 m², në O., Vlorë, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 16.9.2010, nga shoqëria shitëse “****” sh.p.k., kundrejt çmimit 6,800,000 lekë.
143. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar gjithashtu se ZVRPP-ja Vlorë ka përllogaritur tatimin për kalimin e të drejtës së pronësisë, në bazë të vlerës në shitje të pasurisë sipas Udhëzimit nr. ***, datë 26.2.2008, i ndryshuar, nga ku ka rezultuar se

⁷⁵ Totali i depozitave të çelura në shumat 1,600,000 lekë dhe 2,400,000 lekë.

⁷⁶ E cila përfshin edhe gjendjen e llogarive rrjedhëse në vitin 2014 dhe kursimet e vitit 2015.

⁷⁷ Kjo shumë rrjedh nga depozita në shumën 1,600,000 lekë në “Credins Bank”.

çmimi mesatar i shitblerjeve në tregun e lirë për metër katror ka qenë 60,000 lekë⁷⁸ dhe vlera në shitje e pasurisë 8,101,800 lekë.

144. Nisur nga sa më lart, Komisioni e ftoi subjektin e rivlerësimit, me anë të pyetësorit nr. 4, për të sqaruar mbi arsyet e blerjes së apartamentit në fjalë, me çmim më të ulët se çmimi i tregut prej 8,101,800 lekësh dhe çmimi i blerjes më parë nga ana e palës shitëse prej 6,800,000 lekësh. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Me palën shitëse kemi marrëdhënie miqësore të hershme. Në shtator 2017, ata familjarisht u shpërngulën në Tiranë, për arsye punësimi. Babai i ve dhe i sëmurë i z. R., i cili është në Vlorë, kishte nevojë për shpenzime mjekësore dhe individë për t’u kujdesur për të 24 orë. Të detyruar nga nevoja e ngutshme për para, për të përballuar koston e lartë të jetesës në Tiranë dhe shpenzimet e pashmangshme për shkak të rrethanave familjare të veçanta, çifti M. vendosi të shiste apartamentin në O., të cilin kishin kohë pa e përdorur dhe mirëmbajtur. Kjo ngutshmëri ishte një faktor i rëndësishëm që ndikoi çmimin e apartamentit. Përveç kësaj rrethane, në uljen e çmimit ndikoi fakti që ashensori nuk u vendos kurrë nga shoqëria ndërtuese, si dhe prania e lagështirës në të gjithë godinën dhe apartamentin e papërdorur prej kohësh”*. Subjekti i rivlerësimit e shoqëroi përgjigjen edhe me foto të godinës dhe të apartamentit.
145. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit i ka bashkëngjitur pyetësorit nr. 4 edhe 9 kontrata shitblerjeje të apartamenteve në zonën përreth, me kushte dhe karakteristika të ngjashme me apartamentin në fjalë, përgjatë vitit 2018. Nga shqyrtimi i kontratave të paraqitura është konstatuar se çmimi mesatar i shitjes për metër katror ka rezultuar 44,058 lekë, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit e ka blerë kundrejt çmimit për metër katror prej 48,137 lekësh. Për rrjedhojë, trupi gjykues, përpos dyshimeve të ngritura përgjatë hetimit administrativ, nuk ka konstatuar elemente të mjaftueshme për të konkluduar mbi ekzistencën e ndonjë trajtimi preferencial.
146. Nga analiza e dokumentacionit të lartpërmendur, përgjatë hetimit administrativ nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të mjeteve monetare që kanë mundësuar çeljen e dy depozitave të analizuara, e për rrjedhojë trupi gjykues konkludon se ato janë krijuar me burime të ligjshme financiare dhe janë deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit.

12. Çelje depozite me gjendje 700,000 lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank”

147. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, fillimisht, në DIPP-në e vitit 2014, çeljen e një depozite nga bashkëshorti i saj në shumën 400,000 lekë, me burim nga mbyllja e depozitës së tij në “Raiffeisen Bank”, në shumën 325,000 lekë dhe 75,000 lekë nga të ardhurat e vitit 2014.
148. Nga verifikimi i lëvizjeve bankare është konstatuar se kjo depozitë është çelur në “Raiffeisen Bank” në vitin 2012, me burim nga të ardhurat e shitjes së librit të Matematikës, në shumën 317,800 lekë, të cilat janë transferuar nga z. A. D. me përshkrimin “likuidim detyrimi” datë 29.10.2012. Nga dokumentacioni i administruar, duket se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka kryer pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, pasi për ***, rezulton të jetë paguar në total në datën 24.1.2017, shuma prej 60,000 lekësh⁷⁹.

⁷⁸ Bazuar në udhëzim nr. 3, datë 28.12.2016, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”.

⁷⁹ E cila referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, është detyrimi tatimor për të ardhurat në masën 600,000 lekë, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar nga dhënia me qira e apartamentit në Tiranë.

149. Më pas, në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çeljen e depozitës në shumën 1,062,500 lekë në BKT, me burim nga të ardhurat e përfituara nga shpërndarja e dividendit të shoqërisë “****” sh.p.k.⁸⁰ Nga lëvizjet bankare konfirmohet kalimi i shumës 1,062,500 lekë (pjesa takuese e dividendëve të shpërndarë pasi është zbritur tatimi)⁸¹ nga llogaria e shoqërisë “****” sh.p.k., në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në BKT, në datën 8.9.2015, shumë e cila investohet më pas prej tij në depozitë me afat 1-vjeçar në datën 4.11.2015.
150. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çeljen e depozitës bankare nga bashkëshorti në shumën 1,000,000 lekë në BKT, me burim krijimi nga kursimet e vitit 2015⁸². Gjithashtu është konstatuar nga lëvizjet bankare se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën prej 1,000,000 lekësh në llogarinë e tij në BKT, në datën 4.10.2016, shumë të cilën e ka investuar në depozitë me afat 2-vjeçar.
151. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çeljen e depozitave bankare nga bashkëshorti, përkatësisht, në shumat 800,000 lekë në “Credins Bank” dhe 700,000 lekë tek “Intesa Sanpaolo Bank”, me burim krijimi nga kursimet e vitit 2015.
152. Komisioni verifikoi gjithashtu llogaritë rrjedhëse bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit në datën 31.12.2015, të cilat rezultuan në masën 2,539,959 lekë dhe sipas përgjigjes së subjektit të rivlerësimit në pyetësonin nr. 4, gjendja *cash* në banesë në fund të vitit 2013, do të ishte 55,041 lekë.
153. Për të konfirmuar sa ishte shpjeguar nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me mënyrën e deklarimit në DIPP-të përkatëse, Komisioni analizoi sërish mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të tërhequr nga llogaritë rrjedhëse të tyre shumën prej 2,539,959 lekësh, për të mundësuar më pas depozitim në vitin 2016 të shumës 2,500,000 lekë nga kursimet e vitit 2015 (nga ku 1,000,000 lekë depozituar në BKT, 800,000 lekë në “Credins Bank” dhe 700,000 lekë tek “Intesa Sanpaolo Bank”), në datën 4.10.2016. Rezultoi se nga fillimi i vitit 2016 e deri në datën 4.10.2016, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë kryer tërheqjet nga llogaritë e tyre rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” dhe BKT në shumën totale 3,800,000 lekë, çka duket se kishin mundësi për depozitim në shumës prej 2,500,000 lekësh në datën 4.10.2016.
154. Në konkluzion të hetimit administrativ, lidhur me këtë depozitë, Komisioni i ka komunikuar subjektit rezultatet e mëposhtme - duke i kaluar barrën e provës për mungesën financiare të konstatuar në vitin 2014, në shumën 325.000 lekë.
- i. Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin e depozitës bankare në shumën 1,062,500 lekë, në BKT, në vitin 2015, me burime të ligjshme financiare.
 - ii. Nga analiza financiare, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin me burime të ligjshme financiare të depozitës bankare në shumën 1,000,000 lekë, në BKT, në vitin 2016.
 - iii. Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin me burime të ligjshme financiare depozitën në shumat, përkatësisht, 800,000 lekë në “Credins Bank” dhe 700,000 lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vitin 2016.

⁸⁰ Shtetasi L. B. rezulton aksioner me 50% të aksioneve të shoqërisë “****” sh.p.k.

⁸¹ Ky dividend është shpërndarë nga shoqëria “****” sh.p.k., në shumën totale prej 2,500,000 lekësh, në vitin 2015 dhe ka paguar tatimin për dividendin në masën 375,000 lekë, siç konfirmohet edhe me shkresën nr. *** prot., datë 24.12.2018, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

⁸² Kursimet e vitit 2015 janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në masën 2,595,000 lekë.

- iv. Duket se të ardhurat në shumën 317,800 lekë, të realizuara në vitin 2012 nga shitja e librit universitar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit (përdorur për krijimin e depozitës në vitin 2012 në “Raiffeisen Bank”, të cilat së bashku me interesat, në shumën totale 325,000 lekë kanë shërbyer më pas për çeljen e depozitës në vitin 2014, në BKT, në shumën 400,000 lekë) nuk mund të konsiderohen të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë për to nuk rezultojnë të jetë paguar detyrimi tatimor. Për rrjedhojë, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme për çeljen e depozitës bankare në vitin 2014, në masën -325,000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

155. Pasi është njohur me rezultatet e lartpërmendura, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegimet dhe argumentet e saj duke u shprehur se: *“Në lidhje me të ardhurat në shumën 317,800 lekë, të realizuara në vitin 2012 nga shitja e librit universitar nga bashkëshorti, i jam drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë me kërkesë për informacion, ku të përcaktohet lloji i të ardhurave që ka deklaruar bashkëshorti në vitin 2012 dhe a ka detyrime tatimore të pashlyera për periudhën nga viti 2011 deri në datën 31.12.2020. Me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2021, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë vërtetohet se për periudhën e vitit 2012, tatimpaguesi L. B. ka deklaruar 317,800 lekë të ardhura bruto nga shitja e librit universitar dhe se për periudhën nga viti 2011 deri në datën 31.12.2020, ai i ka paguar të gjitha detyrimet tatimore të deklaruar. Sa më sipër, të ardhurat në shumën 317,800 lekë nga shitja e librave në vitin 2012, së bashku me interesat, gjithsej në shumën totale 325,000 lekë duhet të konsiderohen të ardhura me burim të ligjshëm”.*
156. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetimin nr. *** prot., datë 4.2.2021, të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, me të cilin konfirmohet se bashkëshorti i subjektit, për vitin 2012, ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia në shumën 600,000 lekë dhe të ardhura nga e drejta ekskluzive e autorit në shumën 317,800 lekë dhe se deri në datën 31.12.2020 ka paguar të gjitha detyrimet tatimore për të ardhurat e deklaruar.

Vlerësimi i trupit gjykues

157. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka paguar detyrimet tatimore vetëm për të ardhurat në shumën 600,000 lekë, konkretisht, janë paguar detyrime për DIVA 2012, në shumën 60,000 lekë, të cilat korrespondojnë me të ardhurat e përfituara nga qiradhënia për atë vit, çka çon në deduksion se detyrimi tatimor shtesë, lidhur me të ardhurat nga shitja e librit universitar është paguar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Për rrjedhojë, trupi gjykues, nisur nga fakti se personi i lidhur kishte detyrimin ligjor për pagesën e tatimit, dhe duke u bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit - sipas të cilit të ardhurat e realizuara nga subjektet e rivlerësimit dhe familjarët e tyre, për të cilat nuk janë likuiduar detyrimet tatimore në momentin e realizimit të tyre, nuk mund të konsiderohen të ligjshme në funksion të faktit se detyrimet tatimore përkatëse mund të paguhen përgjatë procesit të rivlerësimit, - çmton pretendimin e subjektit për të konsideruar si të ligjshme të ardhurat, për të cilat detyrimi tatimor është paguar në vitin 2020, nuk qëndron dhe mungesa financiare prej 325.000 lekësh në vitin 2014 mbetet e pandryshuar.
158. Megjithatë, në këtë pikë trupi gjykues gjen me vend që të evidentojë faktin se si pamundësia e burimit të ligjshëm e lartpërmendur, ashtu edhe ato mangësi financiare që janë konstatuar lidhur me pasuritë nr. 3 dhe 7, përpos faktit që në këndvështrimin sasior

janë në nivele minimale, nuk përbëjnë burime të panjohura financiare - për sa kohë e kanë origjinën nga burime të deklaruara dhe të verifikuara si të tilla (të ardhura nga shitja e automjeteve dhe e librit universitar) - por nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare, vetëm për mospërmbushjen e kriterit ligjor të pagimit të detyrimeve tatimore në periudhën e krijimit të të ardhurave, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

13. Gjendje *cash* në shumën 1,350,000 lekë

159. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet e vitit 2016 në shumën 1,750,000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në lekë nga kursimet në shumën 1,350,000 lekë. Referuar përgjigjes së subjektit, nëpërmjet pyetësorit nr. 4, mbi mënyrën e deklarimit të gjendjes *cash* të disponuar në banesë ndër vite, me termin kursime të vitit ka pasur parasysh shumën *cash* në banesë dhe atë në llogaritë e tyre likuiduese në banka, deri më 31 dhjetor të çdo viti deklarues. Nga analizimi i llogarive bankare të subjektit dhe të bashkëshortit, konstatohet se ky i fundit nga fillimi i vitit 2017 deri në datën 24.1.2017 ka kryer nga llogaria e tij në BKT, pagesa për detyrimet tatimore dhe tërheqje të tjera, në shumën totale 398,571 lekë, çka duket se përkon me pakësimin prej 400,000 lekësh të gjendjeve të deklaruara nga subjekti (1,750,000 lekë më 31.12.2016 dhe 1,350,000 lekë më 30.1.2017).
160. Duke marrë në konsideratë deklarimin si më sipër të subjektit të rivlerësimit, pasi janë zbritur gjendjet e disponuara në llogaritë rrjedhëse të subjektit dhe bashkëshortit, gjendja *cash* në banesë në fund të vitit 2016, rezulton të ketë qenë në shumën 943,159 lekë⁸³, ku nga analiza financiare e vitit 2016 (të ardhura - shpenzime) ka rezultuar se subjekti mund t'i dispononte ato me burime të ligjshme financiare.
161. Nga analiza e dokumentacionit të lartpërmendur, përgjatë hetimit administrativ nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e krijimit të mjeteve monetare që kanë mundësuar kursimin e kësaj gjendjeje *cash*, e cila është deklaruar saktë në deklaratën *Vetting*.

14. Lidhur me një konstatim të ILDKPKI-së

162. Në raportin me nr. *** prot., datë 3.7.2018, ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë, në të cilin është cituar ekzistenca e konfliktit të interesit si vijon: *“Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, L. B., ka realizuar të ardhura si pedagog në Universitetin e Vlorës, nga punësimi si Drejtor i Shitjeve të subjekti ‘***’, si i punësuar të subjekti ‘***’ sh.p.k., dhe nga Personi Fizik L. B.. Bashkëshorti i subjektit, duke qenë pedagog me kohë të plotë, konsiderohet ‘zyrtar’ dhe, si i tillë, për këtë kategori shtetasish aplikohen rregullimet ligjore të vendosura në ligjin nr. 9367/2005, për marrëdhëniet e punësimit. Punësimi me kohë të plotë, në një pozicion tjetër pranë subjektit publik apo privat është kufizim i vendosur nga ligji nr. 9367/2005. Dypunësimi i bashkëshortit, bazuar në ligjin nr. 9367/2005, është një marrëdhënie punësimi (në dukje) me konflikt interesi, çka krijon dyshime mbi të ardhurat e përfituara”*.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

163. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me sa më sipër, ka argumentuar se: *“‘zyrtar’ sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në*

⁸³ Pasi gjendjet në llogaritë bankare rrjedhëse të subjektit dhe të bashkëshortit, në fund të vitit 2016, kanë qenë në shumën 806,841 lekë.

ushtrimin e funksioneve publike' është personi për te cilin provohet ekzistenca e një prej këtyre dy kushteve:

- ose të ketë një rol të caktuar në vendimmarrje për nxjerrjen e një akti;*
- ose të ndodhet në një funksion publik të caktuar.*

Për nxjerrjen e një akti, sipas këtij ligji, duhet të provohet ekzistenca e një prej këtyre rasteve:

- i. hartimi i projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimi organit apo zyrtarit kompetent për vendimmarrje;*
- ii. dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontribut tjetër të dokumentuara për këtë projektakt, nga zyrtarë të tjerë, brenda apo jashtë institucionit;*
- iii. përfshirja apo dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontribut tjetër të dokumentuara nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;*
- iv. përfshirja apo dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontribut tjetër të dokumentuara, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin.*
- v. përfshirja e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative, pa praninë e të cilëve nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre.*

Për të arritur në përfundimin në lidhje me ekzistencën e një rasti konflikt interesi të një personi me funksion publik, duhet të provohet se:

- i. Cilat janë detyrat dhe kompetencat konkrete e të detajuara të zyrtarit në fjalë?*
- ii. A ka ai kompetencë thelbësore e përcaktuese në vendimmarrjen për nxjerrjen e akteve normative dhe/ose individuale konkrete?*
- iii. Cila është sfera (hapësira, fusha) e ndikimit të këtij akti?*
- iv. Sa i fortë është ndikimi i këtij akti në këtë sferë?*
- v. Cilat janë interesat private të zyrtarit në fjalë?*
- vi. Çfarë mundësish ka që akti të ndikojë interesat private të këtij zyrtari në favor të tij?*
- vii. Çfarë mundësish ka që interesat private të zyrtarit të ndikojnë negativisht rolin e tij në vendimmarrjen për këtë akt?*
- viii. A ka një lidhje të fortë shkak-pasojë ndërmjet interesave dhe aktit, e tillë që vendimmarrja publike të mund të jetë, për këtë shkak dhe vetëm për të, një vendimmarrje e padrejtë?*

Në përputhje e në zbatim të këtij ligji, Universiteti i Vlorës ka nxjerrë rregulloren e tij, e cila aksesohet lehtësisht edhe nga faqja zyrtare elektronike e këtij universiteti.

- 1. Në përputhje me këtë dispozitë, personeli akademik i punësuar me kohë të plotë ndalohej të punësohet po si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë. Pra, ndalimi për punësimin e tij me kohë të plotë qëndron vetëm kur plotësohen të dyja kushtet; a-punësohet si personel akademik dhe 2-në një institucion tjetër të arsimit të lartë. Ndërkohë, në rastin konkret, bashkëshorti im nuk ka qenë i punësuar në shoqërinë '****' sh.p.k. ose si person fizik me cilësinë e personelit akademik, por ka ushtruar veprimtari tregtare si person fizik dhe më pas ka ushtruar të drejtat e tij aktive në një shoqëri tregtare, që nuk është aspak institucion*

tjetër i arsimit të lartë. Ai ka ushtruar veprimtari tregtare dhe jo veprimtari akademike.

2. *Për më tepër, punësimi i tij po ashtu ka të bëjë me veprimtari në fushën e tregtisë dhe jo të arsimit. Për këtë shkak nuk ka asnjë ndalim për punësimin e tij, si me kohë të pjesshme ose të plotë, si nga natyra e veprimtarisë së ushtruar prej tij, ashtu edhe për natyrën e subjektit juridik ku ai e ka ofruar shërbimin, që është subjekt tregtar dhe jo institucion arsimor.*
3. *Ligji specifik ka zbatim prioritar mbi parashikimet e ligjeve të tjerë siç është ai me karakter të përgjithshëm, pasi është ky ligj ai që bën ndalimin e punësimit lidhur me kohën e punësimit dhe natyrën e veprimtarisë për personelin akademik, gjë që në ligjin e përgjithshëm të konfliktit të interesit nuk gjen parashikim. Parimi 'lex specialis derogate generalis' gjen mbështetje në të gjitha vendimet e gjykatës kushtetuese duke i dhënë prioritet zbatimit të ligjit të posaçëm mbi ligjet e përgjithshme.*
4. *Nga ana tjetër, bashkëshorti im ka mbajtur vetëm detyrën e pedagogut, ka marrë pjesë si anëtar në këshilla e borde shkencore në Universitet. Ai nuk ka pasur asnjë detyrë të karakterit administrativ në universitet, pra nuk ka pasur funksion publik. Si i tillë, ai nuk ka pasur asnjë kompetencë për lidhjen e kontratave administrative ose të marrëdhënieve juridike-civile me të tretët ose në marrjen e vendimeve me natyrën e akteve administrative, nga të cilat mund të kishte në dukje konflikt interesi me veprimtarinë tregtare, me qëllim krijimin e përfitimeve materiale për veten e tij në dëm të interesave të universitetit.*
5. *Bashkëshorti im nuk mund të konsiderohet zyrtar sipas nenit 3), pika 1) e rregullores së universitetit të cituar më sipër, pasi cilësia e zyrtarit i përket vetëm personit që mban detyra në universitete vetëm kur në sajë të detyrës së tij ai:
 - a) merr pjesë në një vendimmarrje për akte dhe kontrata administrative;
 - b) merr pjesë në një vendimmarrje për kontrata që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile;*
6. *Gjithashtu, edhe natyra e veprimtarisë së tij tregtare nuk ka asnjë ndikim ose konflikt me natyrën e punës së tij si pedagog të mbajtur në universitet.*

Përfundimisht, bashkëshorti im nuk është zyrtar në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike', pasi nuk plotësohet as kushti që të ketë ndërmarrë akte administrative dhe as kushti që të ketë pasur funksion publik dhe, për rrjedhojë, nuk ka as në dukje konflikt interesi. Interesat private të realizuara nga aktiviteti tregtar i tij nuk duken as në pamje e as në formë që të kenë ndikuar, që të ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësisë të tij, pikërisht për faktin se ai nuk përmbush kushtin e të qenit zyrtar."

164. *Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës vërtetimin nr. *** prot., datë 26.9.2019, të lëshuar nga universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, në të cilin konfirmohet se bashkëshorti i subjektit zbaton kontratën e punës së lidhur me universitetin, si dhe nuk figuron në asnjë organ vendimmarrës të tij.*

Vlerësimi i trupit gjykues

165. Nisur nga përmbajtja e dispozitave ligjore dhe konkretisht e pikës 7, të nenit 3, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, përcaktohet qartësisht termi “zyrtar”, me të cilin identifikohet çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike, sipas germave “a”, “b” dhe “c” të pikës 1, të nenit 4, të këtij ligji. Kështu, qenia “zyrtar”⁸⁴ vlerësohet se ky përcaktim lidhet në radhë të parë me ata të cilët janë të detyruar për shkak të funksionit të zbatojnë detyrimet ligjore që burojnë nga ky ligj. Me qëllim qartësimin e këtij nocioni dhe pozicioni në funksion të ushtrimit të veprimtarisë konkrete, ligjvënësi në nenin 4, ka përcaktuar kushtet që duhet të përmbushen nga zyrtari që janë: (i) të ketë një funksion publik; dhe/ose (ii) të ketë rol thelbësor e përcaktues në vendimmarrjen për një akt të caktuar, duke përcaktuar gjithashtu edhe kufizime të lidhura ngushtësisht me funksionin dhe interesat specifike, ka bërë ndarje të qartë të zyrtarëve, ata të grupi A⁸⁵ të parashikuar nga nenet 27, 28, 29 dhe 33, si dhe zyrtarë të grupit B⁸⁶, referuar neneve 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9367/2005.
166. Lidhur me interpretimin e termit “zyrtar” në funksion të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë”⁸⁷, akteve nënligjore si dhe Statutit të Universitetit të Vlorës⁸⁸, rezulton se ky term/emërtim nuk përshkruhet dhe as nuk cilësohet si term përcaktues i ndonjë funksioni, por qartësohet në to vetëm pozita juridike dhe statusi akademik/profesor⁸⁹, kategori në të cilën bën pjesë edhe bashkëshorti i subjektit, të cilat rregullohen me akte të tjera nënligjore, si statuti i universitetit përkatës dhe kontrata e punës.
167. Nga sa më sipëranalizuar, konstatohet se bashkëshorti i subjektit nuk është subjekt deklarimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9367/2005, ai nuk bën pjesë në asnjë nga kategoritë e zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike, veprimtaria e të cilëve është e lidhur ngushtësisht me vendimmarrjen për nënshkrimin e akteve dhe kontratave administrative apo me funksione të tjera vendimmarrëse që krijojnë një marrëdhënie juridiko-civile. Referuar ligjit për arsimin e lartë, akteve nënligjore si dhe Statutit të Universitetit të Vlorës dhe Rregulloren Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit të Universitetit të Vlorës, nuk rezulton që pozicioni akademik/pedagog të ketë funksion vendimmarrës në këtë universitet.
168. Lidhur me terminologjinë “kohë e plotë”, Komisioni, bazuar në ligjin nr. 9367/2015, vëren se ky përkufizim i atribuohet zyrtarëve të përmendur në nenin 27 të ligjit, që përcakton qartësisht se ata nuk mund të jenë të punësuar me kohë të plotë në një detyrë tjetër, për shkak të funksionit. Ndërkaq, nëse për analogji do të analizonim ligjin e posaçëm, konkretisht nenin 64 të ligjit për arsimin e lartë, në paragrafin 2, parashikohet si kriter i vetëm se: *“Akademikët nuk mund të punësohen, gjithashtu me kohë të plotë*

⁸⁴ Ky term sipas ligjit, kupton subjektet të cilët, në radhë të parë janë të detyruar të zbatojnë ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” (ligji PK1) jepen në nenin 4 të këtij ligji, ata janë zyrtarë, persona të lidhur me to dhe institucione publike.

⁸⁵ Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministri dhe zëvendësmministri, deputetët; kryetari i bashkisë, i komunës dhe i këshillit të qarkut: Presidenti i Republikës, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, gjyqtari i Gjykatës së Lartë, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së.

⁸⁶ Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues; nëpunës civilë të mesëm: zyrtarë të Policisë së Shtetit, zyrtarë të Forcave të Armatosura; zyrtarë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; zyrtarë të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

⁸⁷ Ligji nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë” ka shfuqizuar ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, analizuar vetëm në funksion të analizës lidhur me përcaktimet (emërtimet) ligjore të personelit akademik dhe detyrave dhe ushtrimit të funksioneve të tyre.

⁸⁸ Rregulloren “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e funksioneve publike në universitetin “Ismael Qemali” Vlorë dhe Statutit të publikuar në faqen zyrtare të universitetit www.univlori.edu.al

⁸⁹ Me vërtetimin e datës 25.1.2017, të Universitetit të Vlorës, cilësohet se bashkëshorti i subjektit është pedagog efektiv në degën e Matematikës.

nga një institucion tjetër i arsimit të lartë. Ai mund të angazhohet vetëm me kohë të pjesshme nga një institucion tjetër i arsimit të lartë me miratimin e rektoratit dhe marrëveshjen midis dy institucioneve”. Nga sa më sipër, vërehet se nuk ekziston ndonjë kufizim ligjor për dypunësimin, përveç atij të parashikuar nga ligji, për sa kohë që ligji i posaçëm nuk e pengon për të kryer funksionet normale akademike.

169. Nga sa më sipër është analizuar, bashkëshorti i subjektit nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, për sa kohë ushtrimi i detyrës së tij në fushën akademike me kohë të plotë është në përputhje me kriteret dhe rregullat e përcaktuara të institucionit arsimor përkatës, si dhe ushtrimi i veprimtarisë dytësore nuk bie ndesh me përcaktimet apo kërkesat e veçanta në ligjin specifik.
170. Gjithashtu, Komisioni analizoi rastin në fjalë nën një tjetër këndvështrim ligjor, atë të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit (zyrtar - subjekt deklarues) lidhur me “ndalimin e veprimtarisë private”, bazuar në ligjin nr. 9367/2005, nga ku në pikën 4, të nenit 35 përcaktohet se: *“Personi i lidhur me një zyrtar nuk mund të ushtrojë veprimtari si person fizik tregtar ose ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, nëse veprimtaria përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar, me akte individuale apo normative të nxjerra nga ai, ose kur zyrtari ka rol thelbësor dhe përcaktues në nxjerrjen e këtyre akteve, të cilat krijojnë pasojë juridike, përfitime ose kosto mbi këtë person fizik apo mbi shoqëri tregtare e persona të tjerë fizikë, që bashkëpunojnë ose konkurrojnë me personin e lidhur. Kjo pikë nuk zbatohet kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme: a) mjeti i vetëm, me të cilin ky zyrtar mund të krijojë efektet e mësipërme është një ligj ose një vendim i këshillit të bashkisë, komunës ose qarkut ose një vendim gjyqësor; b) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin prej 10 milionë lekësh”*.
171. Nga sa më rezulton se ushtrimi i veprimtarisë tregtare në fjalë nuk përfshihet në asnjë nga rastet e sipërcituara, si rast papajtueshmërie, për më tepër që të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit dytësor nuk kapërcejnë pragun e vendosur prej 10.000.000 lekësh. Vlerësohet se ekzistenca e mundëshme e konfliktit të interesit në dukje, nuk mund të lindë nga punësimi me kohë të plotë nga bashkëshorti i subjektit, dhe njëkohësisht impenjimi alternativ i tij, pasi kjo rrethanë nuk është objekt i ndonjë kufizimi të parashikuar nga ligji nr. 9367/2005, për sa kohë: (i) nga ana substanciale, fusha akademike dhe veprimtaria dytësore në fushën e tregtisë, nuk bien ndesh as me njëra-tjetrën e as me ligjin specifik; (ii) nuk provohet ekzistenca e ndonjë roli thelbësor apo vendimmarrës i bashkëshortit të subjektit në lidhjen e kontratave publike, dhe (iii) as sfera apo fusha e ushtrimit të veprimtarisë së bashkëshortit të subjektit nuk ka ndërthurje direkte apo indirekte me aktivitetin e subjektit, për rrjedhojë, çmohet se z. B. nuk ka qenë dhe nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në dukje apo në vazhdimësi.
172. Në përfundim, duke mos gjetur të bazuar konkluzionin e ILDKPKI-së, në raportin nr. *** prot., datë 3.7.2018, trupi gjykues çmon se të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit, për të cilat është provuar nga dokumentacioni i administruar se për to janë paguar detyrimet tatimore - nën dritën e përcaktimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, ato duhet të konsiderohen si të ardhura financiare me burime të ligjshme, duke mos ndikuar ligjshmërinë e të ardhurave të familjes së subjektit të rivlerësimit.

REZULTATET SIPAS ANALIZËS FINANCIARE

173. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1 që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
174. Në analizën e njoftuar subjektit, pas mbylljes së hetimit administrativ, ishin konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, nga ku, në fazën e hetimit administrativ kishte rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën – 1,106,588 lekë. Ndërsa pasi janë marrë në konsideratë pretendimet e subjektit dhe janë analizuar dokumentet e paraqitura, pas njohjes së rezultateve të hetimit, trupi gjykues ka vlerësuar disa të ardhura që duhet të përfshiheshin në analizën financiare, të cilat më herët nuk ishin të njohura nga Komisioni⁹⁰.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

175. Përveç sa është trajtuar më lart, mbi mungesat e burimeve të ligjshme të konstatuara në vitet 2005 dhe 2007, subjekti është shprehur mbi mungesat e rezultuara nga analiza financiare në vitet 2006, 2009, 2010 dhe 2015, duke ribërë edhe një analizë financiare nga një ekspert kontabël, në përfundim të së cilës pretendohet një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën – 268,868 lekë për të gjithë periudhën 2003 – 2016.
176. Më konkretisht, për vitin 2006 është pretenduar se në analizë nuk janë përfshirë të gjitha të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit, si dhe nga analiza e kryer nga subjekti bilanci negativ për këtë vit duhet të ishte – 23,779 lekë. Për vitin 2009 është pretenduar se në analizë nuk janë përfshirë të gjitha të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit. Po ashtu, për vitin 2009, është pretenduar se shuma e shpenzuar për shlyerjen e kredisë në “Alpha Bank” për atë vit ka qenë 2,620 euro dhe jo 2,963 euro, siç është konsideruar nga Komisioni. Bilanci i vitit 2009 është pretenduar – 183,077 lekë, në vend të – 448,553 lekë që ka rezultuar nga analiza e Komisionit. Për vitin 2010 është pretenduar se në analizë nuk janë përfshirë të gjitha të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit nga mbingarkesat orare, shpërblimet, pjesëmarrjet në konferenca etj., si dhe është pretenduar përfshirja e të ardhurave nga interesat e depozitës në “OTP Bank”, për vitin 2010, në shumën 18,758 lekë. Nga analiza e kryer nga subjekti, rezultati i vitit duhet të ishte + 27,042 lekë, në vend të – 237,844 lekë të rezultuar nga analiza e Komisionit. Për vitin 2015 është pretenduar se në analizë nuk janë përfshirë të gjitha të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit nga mbingarkesat orare, shpërblimet, pjesëmarrjet në konferenca etj., dhe nga analiza e kryer nga subjekti, viti duhet të ishte me një balancë negative prej – 24,752 lekësh, në vend të – 99,954 lekësh.
177. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës: (i) vërtetimin nr. *** prot., datë 9.2.2021, nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, për të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga mbingarkesa orare, shpërblime, pjesëmarrje në konferenca dhe nga anëtarësia në këshillin e fakultetit, të cilat në vitin 2006 kanë qenë në vlerën 91,800 lekë, në vitin 2009 kanë qenë në vlerën 138,925 lekë, në vitin 2010 kanë qenë në vlerën 207,800 lekë dhe në vitin 2015 kanë qenë në vlerën 61,200 lekë; (ii) vërtetimin

⁹⁰ Të ardhura të përfituara përtej pagës bazë nga punësimet, si honorare apo shpërblime.

nr. *** prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata e Apelit Vlorë, ku janë shtuar dhe shpërblimet e marra nga subjekti ndër vite, ku për vitin 2006 ka një diferencë prej 5,652 lekësh, për vitin 2009 ka një diferencë prej 31,623 lekësh dhe për vitin 2015 një diferencë prej 14,000 lekësh; (iii) lëvizjet e depozitës bankare në “OTP Bank”.

Vlerësimi i trupit gjykues

178. Lidhur me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, të përfituara nga shpërblimet, mbingarkesat e orëve të mësimdhënies, pjesëmarrjet në konferenca apo anëtarësimi në këshillin e universitetit, nga analizimi i provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues konstaton se këto të ardhura nuk ishin përfshirë në analizën financiare të Komisionit, për sa kohë nuk kanë qenë pjesë e vërtetimeve të lëshuara më parë nga universiteti dhe nga gjykata e apelit, të paraqitura nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit. Por, nga analizimi i të dhënave të llogarive bankare përkatëse, pas njohjes me këto pretendime, është konstatuar se këto të ardhura janë përfituar konkretisht nga familja e subjektit, madje nëpërmjet transfertave bankare dhe, për rrjedhojë, ato duhet të shtohen/përfshihen në analizën financiare. Nga ky vlerësim bëjnë përjashtim shumat 100,000 lekë në vitin 2009 dhe 170,000 lekë në vitin 2010, të cilat janë përfituar si rimbursime/dieta për pjesëmarrje në konferenca, duke mos i kualifikuar si të ardhura, por këto shuma janë të përfshira në llogaritjet e shpenzimeve të udhëtimit të bashkëshortit, të cilat janë konsideruar të paguara/rimbursuara nga universiteti dhe nisur edhe nga jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nuk mund të përbëjnë në vetvete burim të ardhurash/kursimesh, për sa kohë konceptohen dhe përfitohen me një destinacion të caktuar, si rimbursim i shpenzimeve të kryera.
179. Lidhur me shumën e shpenzuar nga subjekti për likuidimin e kredisë së marrë në “Alpha Bank”, në vitin 2009, subjekti ka pretenduar pagesën e shumës totale prej 2,620 euro, pasi kjo shumë rezulton e depozituar prej tyre për pagesat e kësteve nga dokumentacioni i administruar. Por, lëvizjet bankare të përcjella nga “Alpha Bank” mbajnë veç të dhënat duke filluar nga marsi i vitit 2009, për shkak të ndryshimit të sistemit informatik të bankës, për rrjedhojë shuma e depozituar prej 2,620 euro i korrespondon pagesës së kësteve për 10 muaj. Ndërkohë, nga Komisioni është përlllogaritur edhe diferenca e pagesave për muajt janar dhe shkurt të vitit 2009 dhe, për rrjedhojë, ky pretendim nuk qëndron.
180. Lidhur me të ardhurat nga interesat e depozitës në “OTP Bank”, prej 18,758 lekësh për vitin 2010, nuk ishin përlllogaritur dhe, për rrjedhojë, janë shtuar/përfshirë në analizën financiare të Komisionit.
181. Për rrjedhojë të sa më sipëranalizuar, pas shtimit/përfshirjes së të ardhurave nga shpërblimet dhe mbingarkesat orare, të ardhurat nga interesat e depozitës, nga analiza financiare e rishikuar, në bazë të pretendimeve të pranuar të subjektit, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në shumën – 607,922 lekë.

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	0	0	9,436,930	8,184	252,225	2,162,703	122,029	5,480,159	-1,239,437	-1,318,663	1,921,814	3,631,934	4,129,204	1,805,894
Apartament banimi 2+1 80m2 Vlore - blere (38/5+1-1)														
Apartament banimi 1+1 50m2 Vlore - privatizim (1/3 pjese)														
Apartament banimi 2+1 80m2 Vlore - privatizim (bsh-1/4 pjese)														
Autoveture VL**8B														
Apartament banimi 2+1 121.6 m2, Rr. M. F., Tirane - blere			7,450,432											
Vend parkimi i hapur ne Rr. M. F., Tirane			1,225,400											
Automjet Tip Golf VL**90C viti prodhimit 1995			100,000											
Automjet Tip Opel Corsa VL**97C viti prodhimit 1996			200,000											
Automjet Tip Golf VL**92C				226,102										
Automjet Tip Peugeot 308 VL**1C					2,140,296									
Apartament banimi 39.24m2 ne O., Vlore								2,600,000						
Ndeshim likuiditeti	0	0	461,098	8,184	26,123	22,407	122,029	2,880,159	-1,239,437	-1,318,663	1,921,814	3,631,934	4,129,204	1,805,894
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	0	0	461,098	469,282	495,405	517,812	639,841	3,520,000	2,280,563	961,900	2,883,714	6,515,648	10,644,852	12,450,746
DETYRIME	0	0	4,632,012	-1,258,816	-977,160	1,001,474	-1,246,785	3,873,563	-2,625,752	-2,773,430	-981,251	0	0	67,630
Marre hua 30,000 Euro ne 28.10.2005 me afat 5 vjet, pa interes			3,676,200	-1,258,816		-517,367	-960,190	-610,764	-608,520					
Detyrim i mbetur per blerjen e apartamentit dhe vend-parkimit			955,812		-977,160									
Kredi prane Alpha Bank 12,500 Euro, dt. 13.11.2008						1,518,840	-286,595	-315,673	-333,672	-376,990	-381,251			
Kredi ne RZB ne shumen 4,200,000 Leke (dibarsuar 02.12.10)								4,200,000	-183,559	-4,016,441				
Detyrim mbetur ndaj shitesve per apartamentin ne O.								600,000			-600,000			
Dhene hua M*** Shpk (L**N) 1,500,000 Leke, int 8%									-1,500,000	1,620,000				
Karte krediti subjekti ne RZB ne Euro														67,630
PASURI NETO	0	0	4,804,918	1,267,000	1,229,385	1,161,229	1,368,814	1,606,596	1,386,315	1,454,767	2,903,064	3,631,934	4,129,204	1,738,264
TE ARDHURA dokumentuar	584,172	892,738	5,746,949	1,732,244	2,004,960	2,037,695	1,849,146	2,769,135	3,356,812	3,011,047	4,185,469	5,354,785	6,257,778	4,049,500
Te ardhura SR vertetuar	383,462	549,471	4,694,968	1,156,775	1,443,119	1,482,672	1,162,088	1,145,400	1,782,707	1,778,945	1,729,741	1,823,183	1,888,972	1,246,668
Te ardhura BSH vertetuar	200,710	343,267	1,051,981	575,469	561,841	555,023	687,058	1,623,735	1,574,105	1,232,102	2,455,728	3,531,602	4,368,806	2,802,832
SHPENZIME	305,058	393,200	788,459	472,283	844,089	684,490	858,337	1,292,151	1,583,135	1,528,631	1,182,415	1,714,786	2,153,326	1,967,787
Shpenzime jetese	305,058	375,456	438,228	438,228	492,354	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Pagese zhdoganimi per automjetet VL**90C dhe VL**97C			350,231											
Pagese zhdoganimi per automjetin VL**2C					200,990									
Interesa/komisione te kredite ne Alpha Bank 12,500 Euro						30,796	119,828	116,748	99,020	111,541	24,876			
Interesa/komisione te kredite ne RZB 4,200,000 Leke								110,398	331,500	131,138				
Shpenzim per regjistrim aktiviteti M*** T*** Shpk (08.2012)										100,000				
Interesa/komisione te kredite RZB 2,000,000 leke ne 02.2016														108,306
Shpenzime shendetesore L. B. 2014													126,099	
Shpenzime arredimi / per punime hidrosantare						20,000		200,000	100,000	100,000				
Interesa dhe komisione per karten e kreditit ne RZB te subjektit														7,518
Shpenzime shkolliimi per vajzat									200,000	200,000	200,000	200,000	100,000	100,000
Shpenzime udhetimes		17,744		34,055	150,745	87,214	192,029	318,526	306,134	321,855	393,443	508,695	1,156,222	811,595
Analiza dokumentuar	279,114	499,538	153,572	-7,039	-68,514	191,976	-378,005	-129,612	387,362	27,649	99,990	8,065	-24,752	343,450
Gjende cash								1,072,816	950,720	55,529	777,207	1,279,035	55,041	943,159
DIFERENCA E PA MBULUAR			-607,922											

182. Në përfundim, duke e vlerësuar kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi, në tërësinë e tij dhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur në vlerën totale 607,922 lekë duke mbajtur në vëmendje sa është shprehur në paragrafin e fundit (nr. 158) të pasurisë nr. 12, si dhe faktin që kjo mangësi financiare është e shpërndarë në vite] - sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet⁹¹ e subjektit nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Iliba Bezati, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe/ose të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se znj. Iliba Bezati ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuar.

B. KONTROLLI I FIGURËS

183. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komision një raport me nr. prot. ***, datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, duke u specifikuar nga ky institucion se në atë fazë mungonte përgjigjja e njërit prej organeve ligjzbatuese.

184. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2019, DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit një raport të dytë në konkluzion të të cilit ishte ndryshuar konstatimi nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga ky subjekt rivlerësimi. Ky ndryshim bazohej në disponimin e të dhënave, nga të cilat ngriheshin dyshime për veprimtari të kundërligjshme në vitet 2011 – 2012, në cilësinë e anëtares së një trupe gjyqesore, që

⁹¹ Duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet jurisprudenciale në vendimet nr. 11 (JR), datë 22.11.2018 dhe nr. 11; 13; 22 (JR), 2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

sipas informacioneve të klasifikuara kishte lehtësuar masën ndëshkuese ndaj një të pandehuri.

185. Me shkresën nr. *** prot., datë 31.12.2019, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i dytë, i sipërcituar, është deklasifikuar pjesërisht datë 27.12.2019, me vendimin nr. ***, të KDZH-së.
186. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, kanë rezultuar informacione dhe fakte që lidheshin me këtë kriter, me të cilat janë njohur anëtarët e trupit gjykues. Nisur nga të dhënat e këtyre informacioneve të klasifikuara janë administruar disa dosje profesionale dhe janë kryer vlerësime të mëtejshme të tyre në ndërthurje me dyshimet e ngritura, jo vetëm në funksion të sa më lart, por të trajtuara edhe në kapitullin e vlerësimit të aftësive profesionale. Nga dosjet në fjalë nuk u konstatua ndonjë shkelje apo arsyetim i pabazuar që të mund të konfirmonte në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë ekzistencën e ndonjë favorizimi të kryer nga subjekti i rivlerësimit në favor të personit të pandehur të cituar.
187. Nga analizimi i dy dosjeve⁹² profesionale, të administruara përgjatë hetimit administrativ të pavarur të kryer nga Komisioni - të cilat janë përshkruar dhe trajtuar në mënyrë më të zgjeruar në pjesën përkatëse të kapitullit të rivlerësimit të aftësive profesionale – nuk kanë rezultuar fakte apo rrethana të mjaftueshme që të mund të mbështesin dhe konfirmojnë konkluzionet e arritura nga DSIK-ja lidhur me këtë kriter.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

188. Në përgjigjet e përcjella në Komision lidhur me kriterin e figurës, subjekti i rivlerësimit, veç të tjerash, ka sqaruar se: *“[...] informacioni i përcjellë në raportin e dytë të DSIK-së, i cili nuk plotëson asnjë nga kriteret ligjore të përcaktuara në nenin DH, pikat 1 dhe 3 të Kushtetutës, Aneksi, rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk përmban asnjë nga elementet e parashikuara nga neni 38, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, nuk është mbështetur në asnjë verifikim, nuk bazohet në asnjë provë, prandaj ai duhet të konsiderohet i paplotë dhe i pavlerë për kontrollin e figurës sime.*

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë se kontrolli i figurës nis me deklaratën e detajuar të figurës që mbulon periudhën 1.1.2012 deri në ditën e deklaramit. Të dyja rastet e përmendura nuk përfshihen në këtë periudhë, u përkasin viteve 2010 dhe 2011. Ky informacion i padrejtë dhe i pabazuar në ligj, pa u mbështetur në asnjë fakt, provë, të dhënë të besueshme, pa kryer asnjë verifikim dhe duke mos zbatuar detyrimin që rrjedh nga neni 39, i ligjit nr. 84/2016, paragrafi 1) i tij për të bërë verifikimin nëse informacioni është i saktë dhe nëse vërtet ka kontakt të papërshtatshëm apo ka kryer veprime korruptive, nuk citon se periudha e verifikimit nuk duhet të shtrihet pafundësisht.

Megjithëse unë mbetem e hapur për verifikimin e figurës time që nga momenti kur unë kam filluar detyrën e gjyqtarës, vlerësoj se mbështetur në referencat e mësipërme ligjore, rastet përpara datës 1.1.2012 nuk duhet të ishin përfshirë në informacionin e dërguar në Komision nga Grupi i Punës.

Sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016: ‘Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklaramive të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin

⁹² Njëra dosje e administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat – me vijimësi në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe tjetra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe e Apelit Vlorë.

e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”.

Neni 38, ‘Standardet e kontrollit të figurës’, pika 3, “Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6, të këtij neni dhe rrethanat lehtësuese sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementët e parashikuar në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë.

Rrethanat ku duhet të bazohet vlerësimi sa i përket kontrollit të figurës, përcaktohen nga paragrafi 4, i nenit 38, të grupuara në 5 kategori si vijojnë:

- a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.*

Në këtë rast, informacioni i përcjellë në raportin e dytë të DSIK-së nuk përmban asnjë nga elementet e parashikuara nga neni 38, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016. Grupi i Punës, në rastin e raportit të dytë nuk ka përmbushur detyrat sipas nenit 37 të ligjit nr. 84/2016. Duket qartë që ky raport nuk përmban asnjë të dhënë të besueshme, objektive, provë apo fakt, por bazohet vetëm në shprehjet se: ‘... ka dyshime se lehtësimi i pozitës/masës ndëshkuese ndaj një të pandehuri është rezultat i marrëdhënieve korruptive, ku pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar çështjen ka qenë edhe gjyqtarja ...’, ‘informacionet që disponohen edhe pse evidentojnë vetëm një rast të tillë ..., ‘...marrëdhënia korruptive e vendosur mes saj dhe palës tjetër, që mund të jetë personi në gjykim ose persona të lidhur me të, dyshohet të jetë një marrëdhënie apo kontakt i papërshtatshëm...’, pa thënë asgjë konkrete, pa referuar në ndonjë rast konkret, pa burim prove të besueshëm, për më tepër pa verifikuar nëse ky burim mund të ketë tendencë keqdashjeje ndaj personit tim për shkak të detyrës së ushtruar nga ana ime gjithë këto vite pune, pa përmendur kush është personi apo personat që dyshohet se kanë njohje me mua, a jam takuar unë ndonjëherë me këta persona, kur është realizuar kontakti i papërshtatshëm; pa dhënë asnjë provë dhe pa përmendur se çfarë veprimi kam kryer unë, çfarë favoresh kam shkëmbyer me ta apo çfarë kam përfituar prej tyre, cilat janë lidhjet e mia me këta persona dhe çfarë përfaqësojnë këta persona, a janë apo jo persona të përfshirë në krimin e organizuar, çfarë takimesh kam pasur me ta, a kanë ndonjë fakt të njohur, të dokumentuar apo të publikuar për këto takime dhe si kam ndikuar apo përfituar dhe a kam dhënë vendime favorizuese, etj. Në vlerësimin tim, ky raport nuk thotë asgjë e nuk ka asnjë të dhënë të besueshme përderisa nuk jep asnjë të dhënë konkrete, por vetëm hamendësime, supozime që hedhin dyshime pa vend e pa të drejtë mbi figurën time, duke mos argumentuar në konkluzionin apo vlerësimin e përgjithshëm absurd se si unë si subjekt mund të vihem nën presion nga struktura kriminale.

[...] Përfundimisht, pasi u njoha me rrethanat e pretenduara në këtë informacion, shpreh qartazi e prerë qëndrimin tim se ai informacion është tërësisht i pavërtetë, i pabazuar, jo vetëm në ligj dhe në prova, por as edhe në ndonjë indicie. Gjatë gjithë veprimtarisë sime prej gati 23 vjetësh si gjyqtare, jam treguar e kujdesshme me sjelljen e qasjen time për të qenë e ndershme, e përgjegjshme dhe me integritet, e pandikuar nga askush e nga asgjë që mund të më ofrohej kundrejt favoreve për të kryer veprime që vijnë ndesh me përmbushjen e rregullt të detyrës e që dëmtojnë interesat e shtetit e shtetasve të Republikës së Shqipërisë”.

Vlerësimi i trupit gjykues

189. Trupi gjykues, nisur nga analizimi i përmbajtjes së dokumentacionit të administruar nga Komisioni, çmon se përgjatë hetimit administrativ nuk ka rezultuar e provuar në veprimtarinë e subjektit sa është shprehur si dyshim nga organet ligjzbatuese, mbi favorizimin e ndonjë pale gjyqësore, përkundrejt përfitimeve personale. Gjithashtu, nuk kanë rezultuar *indicie* apo prova mbi ekzistencën e ndonjë kontakti të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit me individë me precedentë penalë të cilësuar si të përfshirë në gamën e krimit të organizuar, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10191, datë 3.12.2009.
190. Në përputhje me parimin e objektivitetit, trupi gjykues çmon se raporti i DSIK-së, për subjektin e rivlerësimit, duhet të ishte i mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit për ndikueshmëri në veprime korruptive, lidhje këto që mund të provonin çdo dyshim të arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës që mund ta passillnin cënimin e pastërtisë së figurës. Në rrethanat e kësaj çështjeje objekt vlerësimi, trupi gjykues mbrin në konkluzionin se nuk arrihet të provohen dyshimet e ngritura, si dhe nuk ka rrethana që të ngarkohet me përgjegjësi subjekti dhe, për rrjedhojë, të aplikohet ndonjë masë penalizuese ndaj saj, brenda përcaktimeve ligjore të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë nga hetimi i tij, nuk u evidentua ndonjë indicie apo fakt tjetër që mund të mbështeste këto dyshime dhe, si rrjedhojë e këtij vlerësimi, arrin në përfundimin për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, se: Nuk vërtetohen dyshimet mbi përfshirje në veprimtari korruptive në pozicionin e anëtares së trupit gjykues për çështjet e referuara, shpjegimet e saj ishin bindëse, si dhe ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës sipas parashikimeve ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
191. Në përfundim dhe për rrjedhojë të sa është konstatuar, përshkruar dhe arsyetuar më lart, trupi gjykues mbërrin në konkluzionin se përgjatë hetimit administrativ, të kryer në mënyrë të pavarur nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte që mund të çënojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, apo elementë të tjerë, të mjaftueshëm që në vetvete të mund të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

192. Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLGj-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i

aftësive profesionale është mbështetur në: raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGj-ja, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 21.6.2019, në raportin e përpiluar nga ky institucion, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, lidhur me: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale; dhe (d) aftësitë personale dhe angazhimin profesional. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizën e: (i) formularit të vetëdeklarimit dhe të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së, të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektorit të protokoll- arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënive me publikun; (iv) informacionit të marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016; (v) kritereve të vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

C/1. Analiza e aftësive profesionale të kryer nga KLGj-ja

193. Raporti i përcjellë në Komision nga KLGj-ja për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, iu referua kritereve të vlerësimit:
- i. aftësitë profesionale;
 - ii. aftësitë organizative;
 - iii. etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
 - iv. aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
194. Në përfundim të analizimit të akteve dhe të dhënave përkatëse nga KLGj-ja, veç të tjerash, në mënyrë të përmbledhur, ka konstatuar sa vijon: subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, në datën 26.1.2017 ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, aktet: (i) formularin e vetëdeklarimit, gjithsej 6 fletë; (ii) 12 dokumentet shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit, gjithsej 96 fletë; (iii) lista e inventarit të akteve është pjesë e dosjes së rivlerësimit. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet si vijon:
- i. Saktësia e formularit të vetëdeklarimit. Formulari i vetëdeklarimit është i plotësuar nga subjekti i rivlerësimit në të gjitha rubrikat respektive, nuk ka kundërthënie, nuk ka mangësi dhe është i nënshkruar rregullisht. Ajo ka deklaruar si periudhë të rivlerësimit, 4 vitet kalendarike 2013, 2014, 2015 dhe 2016.
 - ii. *Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit* – duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti i rivlerësimit, në periudhën qershor 2005 deri aktualisht, ushtron detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, dhe aktualisht është komanduar në detyrën e kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë.
 - i. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.
 - ii. *Njohuritë ligjore* – subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastet konkrete. Në çështjet penale i kushton

rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale, duke argumentuar sipas rastit për sa i përket pesë dosjeve të vëzhguara, nga aktet e paraqitura nuk rezulton që palët ndërgjyqëse të kenë paraqitur rekurs kundër vendimeve të dhëna prej saj. Kur është rasti, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për zbatimin e ligjit, përdor referenca në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në normat kushtetuese, si dhe në Konventën Evropiane të Ekstradimit, Konventën e Vjenës për të drejtën e traktateve dhe në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve.

- iii. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare, përgjithësisht, është e standardizuar dhe respekton kërkesat e legjislacionit procedural civil e penal. Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve.
- iv. *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim gjithsej 1104 çështje (për vitin 2013 dhe për vitin 2016) dhe ka përfunduar si relatore 1290 çështje dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 14 çështje. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, për gjyqtaren Iliba Bezati rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short deri në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme. Subjekti i rivlerësimit, personalisht, nuk është bërë shkak për dështimin e seancave gjyqësore. Në planifikimin e seancës së parë gjyqësore në 3 çështje gjyqësore është konstatuar gjithnjë vonesë, por te këto çështje të cilat janë civile, seanca e parë caktohej nga kryetari i gjykatës (shihni dosjet 1, 2 dhe 3), si dhe evidentohet se këto çështje nga subjekti i rivlerësimit janë gjykuar e përfunduar në një seancë gjyqësore. Nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të njoftimeve të palëve, ndonëse subjekti i rivlerësimit duhet të dokumentojë më mirë kryerjen e veprimeve procedurale.
- v. *Lidhur me aftësinë për të administruar dosjet* – është konstatuar se aktet themelore, përgjithësisht, janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Te këto pesë dosje janë konstatuar edhe disa mangësi që janë të njëjta, që tregon se bëhet fjalë edhe për metodologji pune. Janë konstatuar dy seanca gjyqësore të filluara me vonesë, por kjo e dhënë është vlerësuar tek *aftësitë organizative të gjyqtarit*, pasi nuk rezulton të jetë e lidhur me shkelje të disiplinës në punë. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati. Për gjyqtaren Iliba Bezati, në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Iliba Bezati, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

195. Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGj-së dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e rezultuara nga denoncimet e publikut, si dhe duke analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

Lidhur me verifikimet mbi konfliktin e mundshëm të interesave dhe dy ankime

196. Përgjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit është pyetur nëse gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare ka shqyrtuar çështje gjyqësore si gjyqtare e vetme apo anëtare e trupës gjyqësore, ku si palë ndërgjyqëse kanë qenë: persona fizikë, persona juridikë, shoqëri, palë shitëse, palë blerëse, përdorues, qiramarrës, qiradhënës, huamarrës, huadhënës apo sipërmarrës, të lidhur nga çfarëdolloj marrëdhënie interesi, përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të aktivitetit si gjyqtare. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacionin provues, si dhe ka sqaruar se përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare nuk ka shqyrtuar çështje gjyqësore si gjyqtare e vetme apo anëtare e trupës gjyqësore, ku si palë ndërgjyqëse të kenë qenë persona fizikë, persona juridikë, shoqëri, palë shitëse, palë blerëse, përdorues, qiramarrës, qiradhënës, huamarrës, huadhënës apo sipërmarrës, të lidhur nga çfarëdolloj marrëdhënie interesi.
197. Lidhur me ekzistencën e mundshme të ndonjë konflikti të interesit, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 30.1.2020, ku kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2020 ka informuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë anëtare apo relatore në shqyrtimin e çështjeve, ku si palë ndërgjyqëse mund të figurojnë subjektet juridike apo fizike të lidhura në një marrëdhënie interesi, si pale shitëse/blerëse qiramarrës me subjektin e rivlerësimit⁹³.
198. Nga sa më sipër, nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar, gjykuar apo vendosur në kushtet e konfliktit të interesit me palët në proces, përgjatë ushtrimit të detyrës së saj.
199. Gjithashtu Komisioni, lidhur me analizimin e dy ankesave, të viteve 2014 dhe 2015, të lartpërmendura në raportin e organit ndihmës, në pikat 1 dhe 2 të kapitullit “Të dhëna arkivore” - iu drejtua KLGj-së me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2020, duke i kërkuar ecurinë e mëtejshme të ankesave, si dhe duke i kërkuar vënien në dispozicion të tyre. KLGj-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 8.9.2020, vuri në dispozicion kopjen me nr.***, datë 24.6.2014, të njehsuar me informacionin periodik të kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë, ndërsa sa i përket ankesës së vitit 2015 kanë informuar se me procesverbalin nr. *** prot., datë 28.7.2020 ankesa është dorëzuar në zyrën e ILD-së dhe se nuk disponohet.
200. Lidhur me ankesën nr. *** prot., datë 24.6.2014, të vitit 2014, është një informacion nga kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, mbi cenimin e vendimit nr. ***, datë 19.9.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë nga Gjykata e Lartë, e cila ka prishur vendimin nr. ***, datë 18.12.2013, ku relator në këtë vendim gjykate ka qenë gjyqtari V. H. dhe anëtarë I. B. dhe Gj. G., ku është konstatuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.***, datë 24.05.2013, ka vendosur “Pranimin e kërkesës së Prokurorit, duke lënë si masë sigurimi “arrest me burg” ndaj shtetasit M. Rr., i dyshuar për kryerjen e veprës “pastrim i produkteve të veprës penale”. Më pas, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.***, datë 19.9.2013, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit dhe caktimin e masës së sigurimit ‘Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore’”. Kundër këtij vendimi është paraqitur rekurs

⁹³Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 4, në përgjigje të të cilit ka informuar se gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare, në të gjitha gjykatat ku unë kam ushtruar këtë detyrë, duke përfshirë edhe komandimet e mundshme, nuk kam gjykuar asnjë çështje gjyqësore, qoftë civile apo penale, ku të jetë palë ndonjë prej individëve të përmendur më lart, as si relatore dhe as si anëtare e trupës gjyqësore konkretisht për: shoqëria “A” sh.p.k. me administrator shtetasin H. J.; shoqëria tregtare “E” me administrator shtetasin J. H., shoqëria “H” sh.p.k. me administrator shtetasin F. H., shoqëria tregtare “M***” me administrator shtetasin M. M.; shtetasit G. B.; I. I.; R. M.; N. M. Bashkëngjitur, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion edhe vërtetimet përkatëse nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykatat e Apelit Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë, ku ka qenë komanduar për disa çështje.

në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 18.12.2013, ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë me arsyetimin se: “... vendimi nr. ***, datë 19.6.2013, i Gjykatës së Apelit Vlorë është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit procedural dhe si i tillë duhet të prishet, ndërsa vendimi nr. ***, datë 24.5.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi. Pasi ndryshe nga Gjykata e Rrethit, Gjykata e Apelit Vlorë ka arritur në konkluzionin se ‘arrest në burg’ nuk mund të thuhet se është në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit, ajo nuk është në raport me të drejtë me rëndësinë e faktit dhe rrethanat e tjera të evidentuara në dosjen penale, vlerësimi nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, i rrezikshmërisë së theksuar të personit nën hetim dhe veprës penale që dyshohet se ka kryer, nuk vlerësohet i drejtë... Gjykata nuk ka arsyetuar se përse masat e tjera më të buta se ajo ekstreme e ‘arrestit në burg’ janë të papërshtatshme në rastin konkret, kur vetë veprimet e kundërligjshme të të dyshuarit e kanë filluesen që në vitin 2005 dhe kur vetë organi i akuzës ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në ngarkim të tij në rastin kur hetimet ndaj tij janë filluar dhe pushuar disa herë çmohet se lënia e tij e lirë nuk rrezikon marrjen e provave të reja... ushtrimi me efektivitet i ndjekjes penale nga organi i akuzës garantohet edhe në masën e sigurimit që ajo do të zgjedhë e që është ‘Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore’”. Kolegji Penal i Gjykatës së Apelit Vlorë, pasi shqyrtoi shkaqet e rekursit, vendimet respektive të gjykatave dhe tërësinë e akteve të administruara në dosje, çmoi se rekursi i paraqitur nga Prokuroria e Apelit Vlorë, përmbante shkaqe nga ato që parashikohen nga neni 432/1/a i Kodit të Procedurës Penale. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është rrjedhë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural dhe, si i tillë, është i cenushtëm ligjërish, ndërsa vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë çmohet se është marrë në zbatim të drejtë të ligjit, si i tillë duhet të lihet në fuqi. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka vlerësuar të drejtë vendimin e kësaj gjykate, duke mbajtur parasysh edhe faktin se pas dhënies së këtij vendimi, personi nën hetim M. Rr. i është shmangur procedimit penal, duke u larguar në drejtim të paditur, në këtë mënyrë ka një argument më tepër për drejtësinë e caktimit të masës ekstreme “arrest në burg”, duke gjetur të plotësuar katërcipërisht kërkesat e neneve 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale.

201. Por, ndryshe nga sa më sipër, Gjykata e Apelit Vlorë, megjithëse ka arsyetuar se: “... Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka arsyetuar në vendimin e saj se përse masat e tjera më të buta se ajo e ‘arrestit në burg’ janë të papërshtatshme në vendimin e saj, nuk ka mbështetur në asnjë argument ligjor se përse masa e sigurimit ‘detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore’ është e përshtatshme dhe në përputhje me shkallën e nevojave të sigurimit. Aq më tepër, që në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje Gjykata e Apelit Vlorë është vënë në dijeni të vendimit nr. ***, datë 29.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka deklaruar ikjen e shtetasit M. Rr., në të tilla rrethana, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë çmohet nga ana e këtij Kolegji se është marrë në kundërshtim të hapur dhe me përcaktimet e nenit 228/3/b të Kodit të Procedurës Penale dhe me Vendimin Unifikues nr.7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit ‘Për interpretimin e drejtë të dispozitës së germës ‘b’, të nenit 228 të Kodit të Procedurës Penale kanë arritur në përfundimin unifikues se ‘rreziku i largimit’, krahas elementëve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet para dhe pas kryerjes së veprës penale (post delictum), personaliteti dhe pozita e tij, etj. Gjithsesi,

caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 128, pika 1, germa 'b' nuk mund të motivohet mbi baza të thjeshta hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitetin e ikjes së të gjykuarit”.

202. Në përfundim të sa më sipër, konstatohet se Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 18.12.2013, ka prishur vendimin me nr. ***, datë 19.9.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë me arsyetimin se ky vendim penal, i cili është prishur, është marrë në kundërshtim të hapur me vendimin unifikues të KBGJL-së. Gjithashtu, sillet në vëmendje në relacionin e hartuar se në rastin e verifikimit të këtij vendimi gjyqësor nr. ***, datë 19.9.2013, nuk ka pasur asnjë ankesë, por ka ardhur si rezultat i informacionit periodik të kryetarit dhe se nuk ndodhet përpara rasteve të parashikuara nga aktet ligjore, prandaj është sugjeruar nga inspektorët se nuk mund t’i përcillen si informacion ministrit të Drejtësisë, nëpërmjet relacionit, por kjo shkelje do të mbahet parasysh për efekt të vlerësimit etik dhe profesional.
203. Nisur nga sa më sipër është konkluduar bazuar në nenin 34/2 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së” duke sugjeruar se: (1) vendimi penal nr. ***, datë 19.9.2013, t’u evidentohet gjyqtarëve V. H., I. B. dhe Gj. G., për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të tyre; (2) trajtimi i kësaj problematike me qëllim qartësimin e kësaj procedure nëse: (i) në vendimet e cenuara të dërguara në bazë të informacionit periodik të kryetarëve janë konstatuar shkelje të ndryshme që parashikohen si shkelje disipline, në kushtet e mungesës së një ankese do të shërbejnë sërish KLD-në për inspektimin e rasteve për fillimin e procedurës; (ii) në vendimet e cenuara të dërguara në bazë të informacionit periodik të kryetarëve janë konstatuar shkelje të ndryshme që parashikohen si shkelje disipline, në kushtet e mungesës së një ankese, do të shërbejnë vetëm për t’u evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarit sipas rregullave të përcaktuara në vendimin nr. ***, datë 14.4.2010 (Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve).
204. Gjithashtu ka rezultuar se Inspektorati i KLD-së, në zbatim të detyrave të parashikuara nga neni 16 i ligjit nr. 8811, datë 17.5.2011, “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, kur nga verifikimi i një ankese apo nga inspektimi i veprimtarisë së gjyqtarit konstatohet shkelje disipline, relacionin bashkë me materialin përkatës ia përcjellin Ministrisë së Drejtësisë. Por, në rastin konkret, verifikimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 19.9.2013, i Gjykatës së Apelit Vlorë, nuk rezulton të jetë para asnjërit nga rastet e parashikuara nga aktet ligjore të mësipërme, prandaj nuk kanë sugjeruar përcjelljen e relacionit ministrit të Drejtësisë për këta gjyqtarë për mozbatimin e vendimit unifikues nr. 7, datë 14.10.2011, të KBGJL-së. Në përfundim kanë konkluduar se shkelja e konstatuar për gjyqtarët V. H., I. B. dhe Gj. G. në dhënien e vendimit penal nr. ***, datë 19.9.2013 do t’u mbahet parasysh për efekt të vlerësimit profesional.
205. Veç sa është trajtuar më sipër, Komisioni ka përcjellë një kërkesë në ILD, lidhur me ankesën nr. ***, datë 2.6.2015, ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, shkresë e cila nuk ishte vënë në dispozicion më parë nga KLD-ja, konkretisht, ankesës nr. ***, datë 2.6.2015, të shtetasve A. dhe A. Sh., të depozituar në KLGj, regjistruar pranë zyrës së ILD-së me nr. *** prot., datë 29.10.2020. Kjo e fundit me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2020 (e mbërritur me e-mail nga ILD-ja) vuri në dispozicion dokumentacionin, nga shqyrtimi i të cilit u konstatua si vijon:
- i. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me urdhrin nr. *** prot., datë 24.12.2015, ka kërkuar verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasit A. dhe A. Sh., ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve Iliba Bezati, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë, për mozbatim të vendimit unifikues nr. 5, datë 23.3.2004, si dhe vendimet e tjera të

cituarra prej tij në dhënien e vendimit nr. ***, datë 5.3.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

- ii. Nga relatimi i inspektorëve të KLD-së, datë 27.10.2015, të cilët kanë kryer verifikimin e ankesës së shtetasve, me objekt moszbatimin e vendimit unifikues, konstatohet përmbajtja e ankesës sa vijon: *“Shtetasit A. dhe A. Sh. janë me banim në Vlorë dhe ata disponojnë një pronë në fshatin *** të Bashkisë Himarë, në vitin 2008, shtetasit E. C., duke shfrytëzuar një kontratë të lidhur me K. e S. të Sh. ... shkatërruan murin rrethues dhe ndërhyjnë në pronën tonë, duke vendosur dy kabina druri., Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 15.5.2013, e dënoi atë me një vit heqje lirie... Gjykata e Apelit Vlorë vendosi rrëzimin e vendimit penal nr. ***, datë 15.5.2013. Trupi gjykues, në argumentimin e vet, merr për bazë një kontratë të jashtëligjshme, të pavlefshme të përcaktuar si të tillë në vendimin Unifikues nr. 85, datë 29.6.2002, nr. 2, datë 25.3.2004 dhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 13.2.2002 dhe nr. 3, datë 18.6.2010. Qëndrimi i gjykatës Iliba Bezati u duk që në çastet e para të seancës, ku komunikonte me shenja me avokatin e të pandehurit... Edhe Prokuroria e Apelit Vlorë, me sa kemi dijeni, ka bërë rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, në Gjykatën e Lartë”.*
- iii. Gjykimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë është bërë me trup gjykues të përberë nga kryesuese Iliba Bezati dhe anëtarët S. N. dhe M. B., të cilët me vendimin nr. ***, datë 5.3.2015, kanë vendosur: *“Prishja e vendimit nr. ***, datë 15.5.2012, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit E. C.”.* Kundër vendimit nr. ***, datë 5.3.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë, është paraqitur rekurs nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë në Gjykatën e Lartë.
- iv. Lidhur me ankesën se përse Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 85, datë 29.6.2002, nr. 2, datë 25.3.2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimet nr. 24, datë 13.2.2002, nr. 31, datë 18.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese, u morën deklarime nga gjyqtarja Iliba Bezati, e cila ka deklaruar: *“Sqaroj se u njoha sot me urdhrin e verifikimit nr. *** prot., datë 15.9.2015. Ajo ka dhënë shpjegimet si më poshtë: ‘Pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 5.3.2015, është gjykuar çështja penale që i përket të pandehurit E. C., akuzuar për veprën penale ‘ndërtim i paligjshëm’, parashikuar nga neni 199/2/a/2 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Vlorë, në përfundim të gjykimit, ka vendosur ‘Prishjen e vendimit nr. ***, datë 15.5.2013, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit E. C.’. Lidhur me pretendimet e ankuesit, dua të sqaroj se gjykimi është bërë konform provave dhe fakteve të paraqitura para gjykatës. Vendimet e Gjykatës së Lartë, që citon ankuesi lidhen me proceset civile, të cilat nuk janë detyruese në një proces penal. Lidhur me faktin nëse është zbatuar një vendim unifikues apo me ligjshmërinë e provave, në një vendim gjyqësor penal, në rastin konkret të vendimit nr. ***, datë 5.3.2015, ka të drejtë të shprehet Gjykata e Lartë. Gjykimi nga ana jonë është bërë konform ligjit material dhe procedural penal, si dhe në bazë të provave që ndodhen në dosje. Kjo dosje vazhdon të ndodhet për gjykim, pranë Gjykatës së Lartë”.*
- v. Nga sa më sipër dhe bazuar në rregulloren e IKLD-së “Vlerësimi paraprak i ankesës” në pikën 2, të nenit 27, është konkluduar: (a) lidhur me gjyqtaren Iliba Bezati, në Gjykatën e Apelit Vlorë, ankesa e shtetasve A. dhe A. Sh., regjistruar me aktin nr. ***, datë 2.6.2015, lidhur me vendimin nr. ***, datë 5.3.2015, ku pretendohet se nuk

janë respektuar vendimet unifikuese, duhet të mbahet në vijim, deri në përfundimin e gjykimit nga Gjykata e Lartë”⁹⁴.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

206. Pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ dhe konkretisht me dy ankesat e paraqitura nga publiku, të përshkruara më sipër, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar dhe argumentuar se:

I. Lidhur me ankesën nr. * prot., datë 24.6.2014**, e cila është një informacion mbi cenimin e vendimit nr. ***, datë 19.9.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë nga Gjykata e Lartë, e cila ka prishur vendimin nr. ***, datë 18.12.2013, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si vijon:

- a. Nga aktet e dosjes konstatohet se këtë kërkesë Prokuroria ia ka drejtuar Gjykatës pas prishjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë të vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 2.2.2011 në lidhje me kallëzimin penal të paraqitur nga nëna e shtetasit M. Rr. Rrethanat e çështjes, mbi bazën e të cilave kjo shtetase ka bërë kallëzim penal, datojnë që në vitin 2005. Pas prishjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal, nga Prokuroria është rithirrur sërish shtetasi M. Rr., i cili ka dhënë deklarime në datën 18.5.2012 dhe në datën 14.12.2012, sikundër ai ka qenë i gatshëm për organin e akuzës qysh me regjistrimin e këtij procedimi penal. Mbi bazën e këtyre të dhënave të grumbulluara deri në këtë fazë të hetimeve paraprake, Prokuroria ka kërkuar për shtetasin M. Rr. caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Çështja është shqyrtuar në shkallë të dytë mbi ankimin e personit nën hetim, M. Rr., që ka kërkuar ndryshimin e vendimit për caktimin e një mase sigurimi më të butë. Gjykata e Apelit Vlorë, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje, ka konkluduar se masa shtrënguese e përshtatshme për këtë shtetas ishte “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, duke pranuar se vetëm ekzistenca e dyshimeve të arsyeshme nuk mund të interpretohet si plotësim edhe i kriterëve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të parashikuara nga neni 229 i Kodit të Procedurës Penale. Në përfundim, Gjykata e Apelit ka krijuar bindjen e brendshme se ushtrimi i ndjekjes penale nga organi i akuzës, në rastin konkret, garantohej edhe me masën e sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”. Konstatohet se Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 18.12.2013, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 19.9.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë me arsyetimin se vendimi penal nr. ***, i datës 19.9.2013, i Gjykatës së Apelit Vlorë, është marrë në kundërshtim të hapur me vendimin unifikues të KBGJL-së. Me gjithë respektin për ish-Gjykatën e Lartë, ky verdikt i saj, përbën një rast të paprecedentë.
- b. Lidhur me atë çfarë Gjykata e Lartë citon si rrethanë në kundërshtim me vendimin unifikues në vendimin e saj se: “... *aq më tepër që në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit Vlorë është vënë në dijeni të vendimit nr. ***, datë 29.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka deklaruar ikjen e shtetasit M. Rr. Kam tërhequr kopjen e gjithë dosjes që i përket çështjes në fjalë dhe nga tërësia e akteve të dosjes, pas shqyrtimit në shkallë të parë datë 24.5.2013, të kërkesës për caktim mase sigurimi, nuk gjendet vendimi i deklarimit të ikjes i sipërcituar. Ai nuk*

⁹⁴ Bashkëlidhur praktika, urdhrat për inspektimin e çështjes, ankesat, procesverbali i mbajtur me subjektin e rivlerësimit, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë; vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; relatimi i datës 26.6.2015, mbi shqyrtimin paraprak të ankesës së shtetasve A. dhe A. Sh. drejtuar zëvendëskryetarit të Lartë të Drejtësisë; ankesa e shtetasve drejtuar KLD-së; vendimi nr. 85, datë 29.6.2001, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; vendimi nr. 2, datë 25.3.2004, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; vendimi unifikues nr. 5, datë 23.3.2004; vendimi nr. 31, datë 18.6.2010, i Gjykatës Kushtetuese.

gjendet as në aktet e shqyrtuara në shkallë të dytë, as nuk është përmendur në fjalën e prokurorit të apelit, as nuk është paraqitur prej tij përpara Gjykatës së Apelit, as nuk përmendet në rekursin e prokurorit të apelit dhe nuk gjendet as në aktet e Gjykatës së Lartë...”

- c. Nga aktet procedurale të Gjykatës së Lartë konstatohet se vendimi për deklarimin e ikjes përmendet vetëm në fjalën e prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme para Gjykatës së Lartë dhe nuk është aspak i administruar në dosje, madje, në dosje nuk ka asnjë akt tjetër shkresor për të vërtetuar ekzistencën e kësaj të dhëne. Shkaku i evidentuar nga Gjykata e Lartë nuk lidhet me zbatimin e ligjit, por dukshëm lidhet me vlerësimin e një rrethane që nuk i është nënshtruar fare hetimit gjyqësor e konkretisht të një vendimi mbi deklarimin e ikjes. Kjo rrethanë nuk është pretenduar as në rekurs prej prokurorit.
- d. Gjithashtu, bashkëngjitur këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) kopjen e dosjes gjyqësore pas dhënies së vendimit të gjykatës së shkallës së parë deri në përfundimin e çështjes në Gjykatën e Apelit, nga ku rezulton të mos jetë përmendur nga asnjë prej palëve në gjykim e as të jetë administruar vendimi i deklarimit të ikjes; (ii) rekursin e prokurorit, ku nuk përmendet rrethana e ikjes si shkak për ndryshimin e masës së sigurimit; (iii) dosjen e Gjykatës së Lartë, ku del i përmendur vetëm nga prokurori dhe jo i administruar në dosje vendimi i deklarimit të ikjes; (iv) deklarime të personit nën hetim gjatë hetimeve paraprake, që provon se personi nën hetim është paraqitur për të dhënë deklarime kur e ka thirrur organi i akuzës.

II. Lidhur me problematikën që i përket ankesës nr. *, datë 2.6.2015**, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar si vijon: *“Në çështjen penale të sipërpërmendur, Gjykata e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të fajësisë ndaj të pandehurit E. C. dhe pushimin e çështjes me argumentin se ky i pandehur nuk mund të deklarohet fajtor për një fakt që në kohën e kryerjes nuk parashikohej si vepër penale. Procedimi penal ndaj të pandehurit E. C. ka filluar mbi kallëzimin e ankuesve A. dhe A. Sh. për një ndërtim njëkatësh prej druri. Ankuesit ngrenë pretendimin në ankim mbi moszbatimin e një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë, që ka të bëjë me mënyrën e rregullimit ligjor dhe mbrojtjes së objekteve ish-pronë shtetërore mbi sipërfaqet e trojeve të kthyer në natyrë ish-pronarëve. Vendimi unifikues civil nr. 86/2001 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë e më tej edhe vendimi tjetër unifikues civil nr. 5/2004 kanë rregulluar përfundimisht pasojat juridike negative që rrjedhin nga zbatimi i këtij dekreti dhe ligji për sa u përket interesave të ligjshme që u preken ish-pronarëve. Duke u rikthyer në çështjen penale të shqyrtuar nga Gjykata e Apelit, theksohet se objekt shqyrtimi nuk kanë qenë çështje të tilla, pasi dy kallëzuesit nuk janë subjekte të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, por subjekte të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”. Në këtë mënyrë, Gjykata e Apelit ka konkluduar me bindje të plotë se veprimet e të pandehurit kanë cenuar interesat e ligjshme të dy bashkëpronarëve kallëzues në gëzimin dhe zotërimin e pasurisë, por që sipas ligjit penal të kohës, ndërtimi i paligjshëm nuk parashikohej vepër penale. Edhe pse kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është ushtruar rekurs, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e ankimit, pikërisht se nuk ka konstatuar shkaqe për cenimin e vendimit as për sa i përket zbatimit të ligjit, as në lidhje me provat dhe analizën e tyre.”*

Vlerësimi i trupit gjykues

207. Nga kontrolli në sistemin *online*, lidhur me sa më lart është përshkruar, është konstatuar se Prokuroria e Apelit Vlorë ka depozituar një rekurs duke kërkuar “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 5.3.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë.”

208. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 28.6.2016, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokuroria e Apelit Vlorë, kundër vendimit nr.***, datë 5.3.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë”.
209. Duke mbajtur në vëmendje sa më sipër është analizuar dhe konstatuar nga Komisioni, si dhe duke konsideruar edhe shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e paraqitur prej saj, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit, lidhur me sa më lart ka dhënë shpjegime shteruese dhe bindëse. Për më tepër që ka rezultuar se qëndrimet e subjektit në vendimet e dhëna nga Gjykata e Apelit, Vlorë, nuk janë prishur nga Gjykata e Lartë - duke mos konstatuar shkelje procedurale apo mosrespektim ose aplikim të gabuar të dispozitave ligjore – për sa kohë kjo e fundit ka vendosur mospranimin e rekurseve, duke lënë në fuqi kësajsoj vendimet e Gjykatës së Apelit Vlorë.
210. Në këto kushte, për sa është përshkruar më sipër, trupi gjykues çmon se nuk kanë rezultuar problematika lidhur me veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat mund të konsistojnë apo ngrinin dyshime të mbështetura mbi shkelje procedurale, mangësi profesionale apo cenim të etikës së gjyqtarit.

DENONCIME NGA PUBLIKU

211. Lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, në Komision janë paraqitur gjithsej 32 denoncime⁹⁵ nga publiku (nga ku 5 denoncime janë fakte të bëra publike nga media si dhe dy fakte/rrethana të tjera publike), të cilët janë shqyrtuar dhe trajtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të sa më lart dhe bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar dhe analizuar disa dosje gjyqësore në funksion të rivlerësimit të aspektit profesional të subjektit të rivlerësimit, përshirë këtu edhe ato dosje që lidheshin me informacione të klasifikuara.
212. Komisioni, në vijim të shqyrtimit të denoncimeve që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar se në përmbajtjen e pjesës më të madhe të tyre nuk janë evidentuar *indicie* apo elementë konkretë që mund të çonin në ndonjë shkelje procedurale apo cenim të të drejtave të palëve nga subjekti i rivlerësimit.
213. Lidhur me disa prej denoncimeve janë kryer hetime të thelluara, duke administruar dosje hetimore dhe/ose gjyqësore, vendime specifike, si dhe procesverbale të seancave gjyqësore që ndërthureshin me referencat e denoncimeve në fjalë, nga analizimi i të cilave ka rezultuar sa vijon:
- 1. Denoncimi nr. *** prot., datë 29.1.2019, i shtetasit A. B.**
214. Denoncuesi A. B., denoncon disa gjyqtarë⁹⁶ për shkelje e moszbatim të ligjit dhe vendime të padrejta. Shtetasi ka depozituar tri vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga ku evidentohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në trupën gjyqësore. Duke qenë se denoncimi nuk i referohet asnjë të dhëne konkrete që të lidhet me subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, Komisioni çmon se denoncimi nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, për sa kohë nuk ka një përfshirje të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, në këtë çështje.
- 2. Denoncimi nr. *** prot., datë 29.1.2019, i shtetasit A. K. M.**
215. Shtetasi A. K. M. denoncon gjyqtarët Iliba Bezati, A. S. dhe prokurorin H. L. për dhënie të vendimeve të padrejta. Denoncuesi ka ngritur padi me objekt shpërbllimin e dëmit nga

⁹⁵ Nga ku 2 denoncime kanë ardhur në datën 24.02.2021, ditën e seancës dëgjimore të subjektit të rivlerësimit, të cilat janë analizuar në procesverbalin e datës 25.02.2021.

⁹⁶Gjyqtarët B. B., A. M., Sh. D., F. L., Iliba Bezati, S. H., A. Z., R. Sh. dhe F. C..

të ardhurat e përfituara për frutet natyrore dhe të ardhurat e përfituara nga vjelja e tyre. Gjykata e Apelit Vlorë, me kryesuese subjektin e rivlerësimit në përfundim me vendimin nr. ***, datë 7.3.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke ulur masën e dëmshpërblimit nga të ardhurat e përfituara nga ullinjë dhe duke mos i njohur të drejtën e dëmshpërblimit për parkingun. Denoncimit i është bashkëlidhur edhe një ankesë tjetër lidhur me një tjetër subjekt rivlerësimi. Nuk rezulton të jetë bashkëlidhur dokumentacion në mënyrë që të mund të thellohet hetimi administrativ, por nga shqyrtimi i denoncimit konstatohet se ka të bëjë kryesisht me themelin e çështjes.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 27.12.2018, i shtetasve M. B. dhe A. Q.**

216. Shtetasit M. B. dhe A. Q. i denoncojnë gjyqtarët Iliba Bezati, A. M. dhe P. A. etj.,⁹⁷ për dhënie vendimi të padrejtë dhe në kundërshtim me ligjin. Denoncueset janë trashëgimtarët e të ndjerit T. B. J., të cilat kanë depozituar dokumentacionin pranë ATP Tiranë, duke kërkuar kthimin e pasurisë pyll e kullotë në emër të tyre. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendim për bashkimin e gjykimit të çështjes civile me nr. ***, datë 5.6.2017, me çështjen civile me nr. *** regj., datë 26.5.2017⁹⁸. Pasi u analizua vendimi dhe dokumentacioni bashkëlidhur, u konstatua se mungojnë elementët e qartë mbi shkelje të mundshme procedurale të subjektit, ose mbi rrethana apo vendimmarrje të paarsyetuara/me arsyetim të dobët, nga subjekti i rivlerësimit.

4. Denoncimi nr. * prot., datë 19.12.2017, i shtetasit A. D. R.**

217. Shtetasi A. R. denoncon gjyqtarët për shkelje të ligjit, dhënie vendimesh të padrejta, duke akuzuar se gjyqtarët nuk kanë marrë parasysh afatin e parashkrimit të padisë, duke i shkaktuar dëm ekonomik të pariparueshëm familjes së tij. Subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës në dhënien e vendimit nr. ***, datë 14.2.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku kanë vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 20.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, pranimin e padisë dhe detyrimin e të paditurve E. M. dhe A. R. të paguajnë paditësin A.T., dëmin pasuror në vlerën 178,632 lekë dhe dëmin jopasuror në vlerën 584,461 lekë. Shtetasi është ankuar edhe në KLD, pas shqyrtimit të ankesës së qytetarit ata kanë konkluduar me shkresën nr. *** prot., datë 3.5.2017, se ankesa nuk i përmbushte kriteret për pranueshmërinë e saj, pasi kryesisht ankesa ka të bëjë me themelin e çështjes objekt padie dhe se pretendimet e shtetasit mund të zgjidhen nëpërmjet ankimit në gjyqësor në gjykata më të larta. Nuk ka informacion nëse vendimi është ankimuar në Gjykatën e Lartë. Nuk janë konstatuar elementë të qartë mbi shkelje të mundshme procedurale apo rrethana ose veprime/vendimmarrje jo në përputhje me ligjin nga subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati. Kryesisht, denoncimi i shtetasit A. R. ka të bëjë me themelin e çështjes. Pretendimet e denoncuesit për vendim të padrejtë, ngrihen mbi themelin e vendimit, i cili nuk është objekt shqyrtimi nga Komisioni.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 12.2.2019**

218. Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 11.2.2019, të Komisionerit Publik, titulluar “Denoncim nga publiku” për gjyqtarët⁹⁹. Bashkëlidhur gjendet praktikë në formën e

⁹⁷Gjyqtarët P. A., Iliba Bezati, E. G., S. D., A. M. dhe A. V..

⁹⁸Gjithashtu ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në dhënien e vendimit të dhënë për bashkimin e gjykimit të çështjes me nr. ***, datë 5.9.2017, çështje kjo e kthyer për kompetencë Gjykatës së Apelit Vlorë, me çështjen nr. ***, datë 26.5.2017, të cilat rezultojnë se janë çështje civile, që në zbatim të neneve 61 dhe 159 të Kodit të Procedurës Civile i dërgohen për shqyrtim dhe të bashkohen me çështjen e mëparshme të regjistruar atë me nr. ***, datë 26.5.2017.

⁹⁹ Gjyqtarët Iliba Bezati, S. D., E. M., P. Z. dhe A. M..

procesverbalit duke listuar një sërë dokumentesh, të cilat nga përmbajtja nuk kanë informacion lidhur subjektin e rivlerësimit.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 16.1.2018**, denoncimi nr. *** prot., datë 15.5.2018, denoncimi nr. *** prot., datë 16.1.2018, denoncimi nr. *** prot., datë 15.5.2018, të shtetasit A. J.

219. Denoncuesi shprehet ndaj disa gjyqtarëve¹⁰⁰ të cilët, sipas tij, nuk kanë pranuar në gjykim si prova dokumentacionin arkivor të depozituar prej tij, i kanë mohuar të drejtën për thirrjen e ekspertit topograf dhe kanë zvarritur procesin për 2 vjet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkëlidhur dhe vendimit, subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës gjyquese në dhënien e vendimit nr. ***, datë 8.6.2009, të Gjykatës së Apelit Vlorë, duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. *** ka vendosur “Prishjen e vendimi nr. ***, datë 8.6.2009, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë duke argumentuar se: *“Gjykata e Apelit Vlorë ka arsyetuar gabim, pasi nuk ka thelluar shqyrtimin e dokumentacionit provë në dosjen gjyqësore, nuk kanë hetuar lidhur me numrin e pasurisë së sipërfaqes së pretenduar, si dhe nuk kanë marrë në konsideratë kërkesën e paditësit¹⁰¹ për thirrjen e ekspertit përkatës teknik për kryerjen e aktit të ekspertimit, kërkesë e drejtë dhe e bazuar në ligj. Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është rrjedhojë e një hetimi të paplotë dhe në kundërshtim me nenin 14 të Kodit të Procedurës Civile, duke e ridërguar këtë çështje për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit”.*

Pas rishqyrtimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe kryerjes së detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 5.4.2017, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 11.4.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, vendim ky i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë”.

7. Denoncimi nr. * prot., datë 24.5.2019, i shtetasit K. B.**, denoncimi nr. *** prot., është vazhdim i këtij denoncimi.

220. Shtetasi K. B. ka denoncuar gjyqtaren Iliba Bezati, për mungesë profesionalizmi, zgjatje të procesit, moszbatim të ligjit dhe shkelje të procedurave ligjore. Subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës në vendimin nr. ***, datë 17.12.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë me palë paditëse F. N. (pala e dëmtuar) dhe të paditur shoqërinë “****” sh.p.k. me përfaqësues K. B. dhe V. B., me objekt “detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësin për dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga aksidenti në punë”, ku shtetasi F. N. ka qenë pala e dëmtuar, ndërsa shtetasi K. B., përfaqësues i shoqërisë tregtare. Referuar vendimit të gjykatës, kjo shoqëri duhet të paguante dëmshpërblimin për dëmin pasuror të shkaktuar nga aksidenti në punë shtetasit F. N. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 18.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.
221. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e një tjetër vendimi të Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht, të vendimit nr. ***, datë 20.5.2015, me palë kërkuese shoqërinë “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i falimentit, ky i fundit, i caktuar nga gjykata pas fillimit të regjistrimit të procedurave me objekt “Detyrimin e

¹⁰⁰ Gjyqtarët A. Ç., M. R., S. J. dhe Iliba Bezati etj.

¹⁰¹ Denoncuesit.

debitorit “***” sh.p.k., të paraqesë në Gjykatë dhe administratorit listën e pasurive dhe të të ardhurave, etj.”. Në përfundim, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “Prishjen e vendimit me nr. (s’ka), datë 16.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me trupin gjykues që shqyrton çështjen në themel”.

222. Ky vendim është bërë edhe objekt kallëzimi nga shtetasi K. B. për trupën gjyqësore, duke depozituar kallëzim penal në ngarkim të shtetasve Iliba Bezati, V. H. dhe K. Gj. për veprën penale “shpërdorim detyre”, pasi në vendimin nr. ***, datë 20.5.2015, të sipërcituar të dhënë prej tyre, kanë shkruar: “*Administratori i falimentit të kësaj shoqërie nuk ka qenë i pranishëm në datën 14.5.20215, kur është zhvilluar seanca e parafundit, por ka qenë i pranishëm në seancën gjyqësore në datën 20.5.2015*”, ditën kur është shpallur vendimi dhe, si e tillë, sipas denoncuesit K. B., trupa gjykuese ka konsumuar veprën penale “shpërdorim të detyrës”. Kallëzimi është shqyrtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila në përfundim ka vendosur “Mosfillimin e kallëzimit penal nr. ***”, në ngarkim të shtetasve Iliba Bezati, V. H. dhe K. Gj.. Vendimi për mosfillim i është njoftuar edhe kallëzuesit K. B. me shkresën nr. *** prot. (O. Rr.), datë 13.1.2016, por nuk ka informacion nëse ky vendim është ankimuar nga denoncuesi.
223. Nga Prokuroria Kavajë është thirrur dhe është pyetur me cilësinë e personit që tregon rrethana të hetimit znj. Iliba Bezati, e cila ka qenë në cilësinë e relatores në vendimin nr. ***, datë 20.5.2015. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit dhe procedurës është konstatuar se seancat gjyqësore janë zhvilluar sipas rregullave procedurale dhe janë pasqyruar saktë në procesverbalin e seancës gjyqësore. Nuk ka rezultuar ekzistenca e elementeve të figurës penale “shpërdorim të detyrës”, nga shtetasit në ushtrimin e detyrës së tyre funksionale. Pasqyrimi në vendimin gjyqësor në pjesën hyrëse të vendimit se “*Gjykata pasi dëgjoi përfaqësuesin e shoqërisë ‘***’ sh.p.k., R. Xh. që kërkoi lënien në fuqi të vendimit,*” ka përbërë një gabim material, pasi nuk ka cenuar në asnjë moment vendimin e dhënë dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë për palët dhe se referuar nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile, “Ndreqja e gabimeve materiale”, mund të bëhet me kërkesë të veçantë nga palët. Nuk ka rezultuar të jetë bërë një kërkesë e tillë nga palët e interesuara.
224. Gjithashtu, denoncuesi ka ngritur një tjetër padi me objekt “Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv dhe kundërshtimi i veprimeve përmbartimore”, ku denoncuesi ka qenë në cilësinë e palës paditëse, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës gjykuese në Gjykatën e Apelit Vlorë. Në këto kushte, ky shtetas ka depozituar kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës Iliba Bezati, duke parashtruar si argument ligjor, kallëzimin e ngritur ndaj saj, me nr. ***, datë 30.9.2015, me objekt “shpërdorim detyre”, kërkesë drejtuar kryetarit të Gjykatës së Apelit Vlorë.
225. Nga ana tjetër, edhe subjekti i rivlerësimit, në ditën e zhvillimit të seancës gjyqësore, ka paraqitur kërkesën e saj për heqjen dorë nga gjykimi pranë kryetarit të Gjykatës së Lartë¹⁰², në datën 16.1.2019, me motivacionin e përbashkët se ndaj saj është depozituar kallëzimi penal. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 20.3.20219, evidentohet se dorëheqja nuk është pranuar nga kryetari i Gjykatës së Lartë, ashtu edhe kërkesa e denoncuesit për përjashtimin nga trupa gjykuese e subjektit të rivlerësimit, sipas procesverbalit të seancës gjyqësore, kërkesa është shqyrtuar nga kryetari i gjykatës dhe është rrëzuar.

¹⁰² Subjekti i rivlerësimit është komanduar si kryetare e Gjykatës së Apelit.

8. Denoncimi nr. * prot., datë 18.10.2018, i shtetases A. D.**

223. Shtetasja A. D. ka denoncuar gjyqtarët Ç. S., Iliba Bezati, A. Sh. dhe A. M. për mungesë profesionalizmi dhe vendimmarrje të padrejtë. Nuk ka bashkëlidhur dokumentacion, si dhe nuk referon shkelje ligjore konkrete apo element të veçantë që të krijojnë mundësimin e hetimit më të thelluar, për të vlerësuar/vërtetuar nëse ka pasur ndonjë shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit. Bazuar në pikën 2, nenit 53, të ligjin nr. 84/2016, ky informacion nuk përmban përshkrimin e të dhënave për të vlerësuar shkeljen ligjore sipas kriterëve të rivlerësimit, veçanërisht për veprimin ose rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore nga subjekti i rivlerësimit. Sa më lart, nuk shihen *indicie* që të thellohet hetimi.

9. Denoncimi nr. * prot., datë 19.10.2018, i subjektit “R. B.”**

224. “R. B.” denoncon gjyqtarët A. L., P. A., N. T. dhe Iliba Bezati¹⁰³ se kanë cenuar rëndë interesat financiare dhe ligjore të bankës, si pasojë e dhënies së vendimit nr. ***, datë 6.11.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin është vendosur hapja e procedurave të falimentit për shoqërinë “****” sh.p.k. Rezultoni se kredidhënësi më i madh i debitorit ka qenë “R. B.”. Ai ka pasur detyrimin në shumat 162,196,373,33 lekë dhe 9.601.588,45 euro, detyrim i verifikuar dhe i pranuar si nga administratori i falimentit ashtu edhe nga gjykata. Subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës gjykuese në dhënien e vendimit nr. ***, datë 24.4.2018, duke vendosur: “Ndryshuar vendimin datë 24.4.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; Pranimin e planit të riorganizimit të paraqitur nga debitori dhe kalimin për mendim e votim, sipas parashikimeve të neneve 195 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentin”. Denoncimi nuk shoqërohet me prova dhe pretendimet e denoncuesit lidhen me themelin e gjykimit të çështjes, të cilat nuk janë objekt shqyrtimi nga Komisioni, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Denoncimi nr. * prot., datë 6.11.2018, i shoqërisë “****”**

225. Shoqëria “****” denoncon gjyqtarët D. H. dhe Iliba Bezati për shkelje procedurale. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se kjo shoqëri ka qenë palë e paditur në gjykim me shtetasit Ç. dhe H. D., me objekt padie “shpërblim dëmi”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur pranimin e padisë dhe dëmshpërblimin e paditësve. Pas ankimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, çështja është shqyrtuar me kryesuesen e trupës gjykuese subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati. Denoncuesi “****” pretendon se Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka marrë parasysh kërkesën për shtyrje të seancës gjyqësore, pasi juristja ka qenë me raport mjekësor dhe, si rrjedhojë, palës paditëse i janë dëmtuar interesat pasurore.

11. Denoncimi nr. * prot., datë 12.12.2017, i shtetasit L. Q. V.**

226. Shtetasi L. V. denoncon gjyqtarët S. N., M. B. (B.), Iliba Q. (Bezati), të cilët, sipas tij, kanë shkelur ligjin dhe kanë dëmtuar interesin e tij personal dhe pasuror, pasi nuk kanë pranuar dokumentacionin e arkivës, si dhe kanë zvarritur çështjen për një periudhë 2-vjeçare. Denoncuesi L. V. ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt “Rivendosje në afat për depozitim të kërkesës pranë ATP-së dhe vërtetimin e faktit juridik të pronësisë dhe saktësimin e sipërfaqeve dhe kufijve të pronës së ndodhur në L.”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, datë 28.10.2015, ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë, rivendosjen në afat të kërkesës dhe vërtetimin e faktit juridik të sipërfaqes dhe kufijve të pronave të Q. V., sipas konkluzioneve dhe plan

¹⁰³ Gjyqtarët A. L., P. A., N. T. dhe Iliba Bezati.

- vendosjes së hartuar në aktin e ekspertimit”. Konstatohet se me vendimin nr. ***, datë 12.7.2017, ku anëtare e trupës gjyqësore ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, në përfundim kanë vendosur “Prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe kthimin për rigjykim me një tjetër trup gjyqësore”. Nuk konstatohet ndonjë shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit, apo zvarritje e procesit sipas pretendimeve të denoncuesit. Kryesisht denoncimi ka të bëjë me themelin e çështjes, i cili nuk është objekt i shqyrtimit nga Komisioni.

12. Denoncimi nr. * prot., datë 2.2.2018, i shtetasit M. D.**

227. Nga shqyrtimi i denoncimit të shtetasit dhe dokumentacionit të bashkëlidhur konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në vendimin nr. ***, datë 24.2.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë, pasi trupa gjyqësore/vendimmarrëse ka qenë e përbërë nga gjyqtarët A. L., N. T. dhe P. A.¹⁰⁴.

13. Denoncimi nr. * prot., datë 18.12.2019, i shtetases V. I.**

228. Denoncuesja V. V. (I.) pretendon se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati dhe V. H., kanë “shitur” pronën e saj me dokumente të anuluar/falsifikuara e të korigjuara të S.. Kjo shtetase ka kërkuar përjashtimin e tyre nga procesi gjyqësor, dhe se një tjetër proces gjyqësor do të zhvillohet përsëri nga gjyqtarja Iliba Bezati dhe, në këto kushte, kërkon ndihmë për zgjidhjen e çështjes nga KLD-ja dhe kryetari i KLSH-së. Denoncuesja ka vënë në dispozicion bashkëlidhur edhe shkresën me nr. ***, datë 13.12.2019, drejtuar KLD-së dhe KLSH-së, ku kërkon të verifikohen korigjimet në formularin nr. *** në origjinal, lista e bashkëthemeluesve problematikë në Vlorë për pronësinë e hotelit në zonën “****” Vlorë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion, konstatohet se në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është ngritur padia me përfaqësues E. V. me objekt “deklarimin e falsifikuar të dokumentit Akt i marrjes në pronësi me nr. ***, lëshuar nga Bashkia Vlorë, në favor të shtetasit S. H., në rubrikën e shkrimit dhe nënshkrimit të përfaqësuesit. Kundërshtimin e pavlefshmërisë absolute të AMTP-së me nr. ***.” Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr.***, datë 7.12.2015, ka rrëzuar padinë e ngritur nga paditësi. Ky vendim është prishur nga Gjykata Administrative e Apelit dhe është kthyer për rigjykim, në të njëjtën gjykatë me tjetër trup gjyqësor datë 18.12.2019. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vendimit rezulton se ky vendim nuk është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.
229. Lidhur me pretendimin se subjekti i rivlerësimit do të gjykojë përsëri këtë çështje, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (për periudhën kur subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë), duke i kërkuar informacion të mëtejshëm lidhur me sa pretendohet. Gjykata e Apelit Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 24.12.2019, ka bërë me dije se në ngarkim të shtetasve E. V. dhe V. I. (V.) është gjykuar çështja pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, ku në përbërje të trupit gjyqësor ka qenë subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, me vendimin nr.***, datë 16.12.2015 duke vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr.***, datë 27.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke e gjykuar çështjen në fakt*”, me argumentimin se prapësimet e bëra nga të paditurit “V.” për pavlefshmërinë e AMTP-së në emër të paditësit “S.” kanë qenë të pabazuara dhe të paargumentuara dhe se të gjitha provat e sjella në gjykim nuk mund të merren parasysh.

¹⁰⁴ Trupa gjyqësore e përbërë nga gjyqtarët A. L., N. T. dhe P.A..

Ky vendim rezulton se është ankimuar në Gjykatën e Lartë dhe është ende në pritje për t'u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë me nr. çështje ***.

230. Lidhur me pretendimin se gjyqtarja ka gjykuar edhe më parë çështje me shtetasit E. V. dhe V. V., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2019, ka informuar Komisionin se nga verifikimi në sistem për vitet 1998 - 2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë vendime ku palë kanë qenë shtetasit E. V. apo V. I., por janë gjykuar nga një trupë tjetër gjykuese¹⁰⁵. Sa më sipër, rezulton se denoncimi dhe pretendimi i ngritur nga denoncuesja për shqyrtimin e çështjes nga e njëjta gjyqtare, nuk qëndron, bazuar në dokumentacionin dhe informacionin e vënë në dispozicion nga organet kompetente.

14. Denoncimi nr. * prot., datë 26.11.2018, i shtetasit K. L.**

231. Denoncuesi K. L. nuk parashtron në denoncimin e tij ndonjë shkelje ligjore të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, por në ankimin e tij informon se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës gjykuese në dhënien e vendimit nr. ***, datë 6.12.2017, ka marrë vendime të padrejta duke mbyllur procese gjyqësore, duke iu referuar procesit për heqjen e sekuestros (preventive) dhe lirimin e pallatit shumëkatësh të ndërtuar në qendër të Vlorës. Ky denoncim nuk është shoqëruar me dokumentacion bashkëlidhur apo me përshkrimin nga ana e tij të ndonjë shkeljeje konkrete apo procedurale në mënyrë që të mund të thellohet hetimi mbi subjektin e rivlerësimit.

15. Denoncimi nr. * prot., datë 15.5.2018, i shtetasit L. M.**

232. Shtetasi akuzon disa gjyqtarë dhe prokurorë. Nuk rezulton nga dokumentacioni bashkëlidhur të ketë elementë që të lidhen me subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati. Ka depozituar vendimin e datës 9.10.2015, "Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, datë 3.8.2015, për shtetasin R. T.", si dhe disa korrespondenca me institucionet shtetërore. Nuk shihen *indicie* për thellimin e denoncimit, pasi nuk ka referim të shkeljeve ligjore që lidhen me subjektin e rivlerësimit.

16. Denoncimi nr. * prot., datë 18.5.2018, i shtetasit A. F. F.**

233. Shtetasi A. F. F. akuzon gjyqtarët¹⁰⁶ për vendime të padrejta të dhëna nga gjyqtarët E. M., A. M., A. S., H. S., A. Th., M. A., H. Ç., Iliba Bezati, V. H. dhe P. A.. Në mënyrë kronologjike, denoncuesi ka përshkruar ngjarjen lidhur me pronën e tij të përfituar nga trashëgimia ligjore dhe ka depozituar në AKKP Tiranë për kthimin në natyrë të sipërfaqes tokë kullotë në vendin e quajtur "****" në ***, Vlorë. Akti administrativ është bërë objekt padie dhe është kundërshtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e vendimit nr. ***, datë 12.12.2013, në Gjykatën e Apelit Vlorë, nga ku ka vendosur "Prishjen e vendimit nr. 1319, datë 30.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin se nuk është formuar mirë legjitimiteti pasiv në gjykim, si dhe gjykata nuk ka bërë një orientim të drejtë për rregullimin e ndërgjyqësisë në përputhje me kërkimin. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, nuk ka rezultuar ndonjë shkelje procedurale apo mungesë arsytimi ose arsytim i dobët nga subjekti i rivlerësimit.

17. Denoncimi nr. * prot., datë 12.7.2018, av. D. H.**

234. Rezulton se ky denoncim nuk ka informacion konkret lidhur me subjektin e rivlerësimit, por liston një sërë subjektësh rivlerësi e ndërmjet tyre edhe subjektin e rivlerësimit,

¹⁰⁵Referojuni shkresës me nr. *** prot., datë 26.12.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁰⁶Gjyqtarët E. M., A. M., A. S., H. S., A. Th., M. A., Iliba Bezati, H. C., V. H., P. A..

znj. Iliba Bezati, për të cilën shprehet se është e korruptuar dhe vazhdon të mbetet në detyrë, por nuk parashtron asnjë fakt apo provë për të mbështetur denoncimin e tij apo për të thelluar hetimin. Nga analiza e denoncimit të paraqitur në raport me elementët e pikave 1 dhe 2, të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se nuk ka të dhëna për shkelje ligjore apo fakte e prova për të mbështetur denoncimin e shtetasit në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.

18. Denoncimi nr. * prot., datë 16.5.2019, i shtetasit B. Sh.**

235. Shtetasi B. Sh., denoncon gjyqtaren Iliba Bezati për zvarritje të procesit, shkelje procedurale nga gjyqtarja si relatores e çështjes. Konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 29.5.2017, ka vendosur “Rrëzimin e padisë së shtetasit”. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 26.3.2019, ku ka qenë anëtare e trupës gjykuese Iliba Bezati vendosi: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 29.5.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”. Vendimi është ankimuar nga ky shtetas në Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, në denoncimin e tij, shtetasi shprehet se në ankimin e depozituar në Gjykatën e Lartë ka përshkruar të gjitha pretendimet lidhur me këtë gjykim, si dhe shkeljet procedurale, por nuk shprehet se cilat janë ato. Sa më lart, duke qenë se denoncuesi nuk i referohet një shkeljeje procedurale konkrete apo mungesë në arsyetim nga subjekti i rivlerësimit dhe për sa kohë, kjo çështje është ankimuar në Gjykatën e Lartë, pretendimet e denoncuesit do të vlerësohen dhe vendosen nga shkallët më të larta gjyqësore, për sa kohë që denoncuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe nuk konstatohen shkelje procedurale, mosrespektim të të drejtave të palëve në proces apo arsyetim të munguar ose të dobët.

19. Denoncimi nr. * prot., datë 10.6.2019, i shtetasit Th. Ç.**

236. Denoncuesi ngre dyshime mbi disa gjyqtarë¹⁰⁷ për mosrespektim dhe zbatim të gabuar të ligjit dhe sipas tij vendimi është marrë në keq nterpretim të ligjit dhe pa respektuar procedurën. Bashkëlidhur gjendet shkresa me nr. *** prot., datë 10.6.2019, me lëndë “dërgim dokumentacioni nga KPA”, si dhe denoncimi me nr. ***, datë 3.6.2019, që i përket shtetasit Th. Ç. Kryesisht, denoncimi ka të bëjë me themelin e çështjes dhe në këto kushte nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit, për sa kohë Komisioni nuk ka kompetencë për t’u shprehur e rivlerësuar themelin e çështjeve të shqyrtuara nga subjektet.

20. Denoncimi nr. * prot., datë 27.6.2018, i shtetasit P. M.**

237. Shtetasi P. M. akuzon se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë¹⁰⁸, të cilët me vendimin nr. ***, datë 7.6.2012, kanë lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 25.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Sipas denoncuesit vendimi është i paligjshëm dhe i marrë në kundërshtim me ligjin. Vendimi është ankimuar në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. ***, datë 12.6.2016, nuk ka pranuar rekursin e denoncuesit, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë. Ankesa e denoncuesit drejtohet kryesisht drejt një tjetër subjekti rivlerësimi.

21. Denoncimi me nr. * prot., datë 18.5.2018, i shtetasit L. S. B.**

238. Denoncuesi paraqet ankesën e tij lidhur me një tjetër subjekt rivlerësimi, gjyqtaren E. L., por edhe shumë gjyqtarë dhe prokurorë, në denoncimin e tij i ka përfshirë nën termin të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë. Denoncuesi ka bërë një përshkrim të kronologjisë së historisë së tij. Kryesisht, denoncimi ka të bëjë me pakënaqësitë lidhur

¹⁰⁷ Gjyqtarët Iliba Bezati, P. A. , L. C. dhe D. H..

¹⁰⁸ Gjyqtarët Gj. G., V. H. dhe Iliba Bezati.

më vendimmarrjen, si dhe është shqyrtuar edhe më parë nga Komisioni¹⁰⁹. Subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare në dhënien e vendimit nr. ***, datë 26.9.2007, më palë paditëse denoncuesin dhe të paditur B. e T., e cila në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 9.1.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Nuk ka elemente që të lidhen me subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.

22. Denoncimi nr. * prot., datë 23.9.2020, i shtetasit M. G.**

239. Shtetasi M. G. akuzon subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë dhe gjykim në kushtet e konfliktit të interesit, të cilat kanë cenuar sigurinë juridike të procesit të rregullt ligjor, duke i shkaktuar denoncuesit dëm të madh ekonomik. Ai akuzon subjektin e rivlerësimit se ka gjykuar çështjen objekt shqyrtimi në kushtet e konfliktit të interesit, pasi motra e kumatës së saj (e cila është aktualisht komisionere dhe kryetare e Komisionit të Vettingut) është ministre e Infrastrukturës së Energjisë dhe, si e tillë, ka nën varësi edhe shoqërinë aksionere “****” sh.a. P., e për rrjedhojë, ai pretendon se gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është bërë në kushtet e konfliktit të interesit. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim me ligjin, vendosi kthimin për rigjykim të çështjes gjyqësore ku ka qenë në cilësinë e palës paditëse, me argumentimin se në gjykim nuk ishte thirrur Avokatura e Shtetit. Denoncuesi ka vënë në dispozicion kopje të vendimit nr. ***, datë 21.12.2017, dy kopje të marra nga sistemi për çështjen nr. ***, me objekt “Padi për zgjidhje martesë”¹¹⁰, disa certifikata familjare dhe personale të shtetasve I. B., M. Q., B. B. dhe dy kërkesa drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë për zbardhjen e vendimeve të marra në datat 15.7.2020 dhe 22.7.2020. Denoncuesi pretendon se vendimet e sipërpërmenduar nuk janë zbardhur brenda afateve ligjore të parashikuara nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile¹¹¹.
240. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë relatore në dhënien e vendimit nr. ***, datë 21.12.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 20.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me trup tjetër gjykues”. Për këtë vendim, njëri nga anëtarët e trupës gjyqësore, konkretisht, S. N., ka dalë me Mendim Pakice, me argumentin se: “*Sipas parashikimeve ligjore të ligjit nr.10018, datë 13.11.2008“Për Avokaturën e Shtetit”...institucioni i avokaturës është institucion qendror i administratës publike i ngarkuar ekskluzivisht me dhënien e asistencës juridike për institucionet publike dhe entet publike dhe se zëvendësimi i drejtpërdrejtë i vetë palës së paditur nga “****” sh.a. P., pavarësisht se është një shoqëri aksionere me kapital të shtetit shqiptar, nuk klasifikohet si institucion apo organ i administratës shtetërore në mënyrë të tillë që të përlligjet përfaqësimi i saj në proces’. Në këtë kontekst juridik, me mendimin e pakicës, ai ka çmuar se është i gabuar interpretimi mbi domosdoshmërinë e thirrjes së Avokaturës së Shtetit në gjykim, duke krijuar pabarazi të palëve në proces, duke vlerësuar se çështja duhet të shqyrtohej në themel nga Gjykata e Apelit dhe jo të prishej për shkak të mosthirrjes së Avokaturës së Shtetit”.*
241. Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar vërehet se:
- i. Lidhur me gjykimin e çështjes në kushtet e konfliktit të interesit, Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se: “*Gjyqtari është*

¹⁰⁹ Referojuni vendimit nr. ***, datë 28.5.2019, f. 47-48.

¹¹⁰ Nuk kuptohet lidhja me këtë dokument.

¹¹¹ Neni 308 i Kodit të Procedurës Civile: “*Në çështje të ndërlukuara, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari, jo më vonë se dhjetë ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në pesë ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai ia beson këtë njërit prej anëtarëve të trupit gjykues”.*

i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit". Në kushtet kur nuk rezulton se subjekti i rivlerësimit apo bashkëshorti të jenë të afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë¹¹² apo në një marrëdhënie birësimi apo bashkëjetese me denoncuesin apo me persona të tjerë të pretenduar në denoncim apo/dhe të lidhur në ndonjë kredi apo hua, me njërin nga palët apo me njërin nga përfaqësuesit, vlerësohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka gjykuar çështjen në kushtet e konfliktit të interesit, sipas pretendimeve të denoncuesit, si dhe nuk rezulton nga analizimi i vendimit që denoncuesi të ketë depozituar kërkesë për përjashtimin nga gjykimi të subjektit të rivlerësimit duke parashtruar në gjykim një pretendim të tillë.

- ii. Lidhur me faktin se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë, pa praninë e Avokaturës së Shtetit, konstatohet se Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur përsëritjen pjesërisht të hetimit gjyqësor, duke thirrur me kërkesën e palës së paditur shoqërinë "****" sh.a., P., Avokaturën e Shtetit, si palë e domosdoshme në kushtet kur kjo shoqëri është/ka qenë me kapital shtetëror 100%, si dhe për sa kohë objekti i padisë ka qenë: *"Konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit ndaj paditësit e kryer nga ana e punëdhënësit '***' sh.a. P.. Ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura, duke detyruar punëdhënësin '***' sh.a. P., të rikthejë paditësin në vendin e mëparshëm të punës në pozicionin e përgjegjës të turnit pranë palës së paditur ose në një pozicion të barasvlershëm me të. Detyrimin e punëdhënësit '***' sh.a. P. ta dëmshpërblejë paditësin duke e kompensuar për dëmet pasurore të shkaktuara në formën e fitimit të munguar për mosmarrjen e pagës si përgjegjës turni pranë palës së paditur, nga momenti i pushimit nga puna në datën 25.7.2014 deri në rikthimin e tij në këtë punë. Detyrimin e punëdhënësit '***' sh. a. P. të dëmshpërblejë paditësin për dëmin jopasuror të pësuar. Detyrimin e punëdhënësit 'Albpetrol' sh.a. Patos të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit*".
242. Në përfundim, nisur nga kuadri ligjor, që lidhet me sa më lart, konkretisht duke mbajtur në vëmendje që: (i) ligji nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit" neni 2, neni 5, germa "b" përcakton se: *"Avokatura e Shtetit përfaqëson dhe mbron interesat pasurore të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë. Në çështje të veçanta, sipas kritereve lëndore dhe sasiore, të përcaktuara në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Ministrave, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund t'ia delegojë të drejtën e përfaqësimit dhe të mbrojtjes organit të interesuar të administratës"*; (ii) në vendimin nr. ***, datë 8.4.2009, "Për miratimin e rregullores për marrëdhëniet e avokaturës së shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale" dhe "Rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e avokaturës së shtetit", ku neni 4 i saj përcakton se: *"Fusha e zbatimit të*

¹¹²Referuar vendimit nr. 00-2013-897, i vendimit (219) të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në kuptimin juridik "krushqi e afërt" është lidhja që krijohet në mes të njërit bashkëshort dhe personave në gjini të bashkëshortit tjetër. Në vështrim të dispozitave të Kodit të Familjes, Kodit Civil dhe ligjit "Për Gjendjen Civile" rezulton se jo çdo person i gjinisë së njërit bashkëshort konsiderohet se ka marrëdhënie juridike me bashkëshortin tjetër. Në zbatim të parimit "adfines inter se non sunt adfines", lidhja e krushqisë në kuptimin e saj juridik nuk krijohet ndërmjet gjinisë së njërit bashkëshort e gjinisë së bashkëshortit tjetër. Në vështrim të dispozitave të Kodit të Familjes krushqia krijohet ndërmjet këtyre subjekteve: (i) njërit bashkëshort dhe prindërit e bashkëshortit tjetër (dhëndër/nuse-vjehrr/ë); (ii) njërit bashkëshort dhe vëllezërit apo motrat e bashkëshortit tjetër; (iii) njërit bashkëshort e fëmijëve të bashkëshortit tjetër (njerku e thjeshtri).

veprimtarisë së Avokaturës së Shtetit konsiston në ofrimin e asistencës juridike për personat juridikë të mëposhtëm: a) institucionet shtetërore; b) entet publike; c) shoqëritë e krijuara ose që veprojnë sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ku aksioneri shtetëror ka të drejtë të emërojë shumicën e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë ose zotëron më shumë se gjysmën e aksioneve apo kuotave”; (iii) institucioni i Avokaturës së Shtetit është thirrur me kërkesë të palës së paditur shoqërisë aksionere “***” sh.a. P., kërkesë procedurale e pranuar nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila e ka legjitimuar të drejtë kërkesën për thirrjen dhe përfaqësimin në proces të AVSH-së, me qëllim mbrojtjen e të drejtave pasurore të shtetit, si dhe evidentohet se pozita procedurale e Avokaturës së Shtetit është një pozitë “*sui generis*”, e cila edhe pse ka për qëllim ofrimin e asistencës juridike dhe përfaqësimin, pasi sikurse rezulton edhe nga dispozita e ligjit specifik për Avokaturën e Shtetit, përfaqësimi i kryer prej saj në një proces gjyqësor, ku si palë është një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë, i referohet mbrojtjes së interesave pasurore të shtetit shqiptar.

243. Tashmë është praktikë e konsoliduar dhe e konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, se e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim e Avokaturës së Shtetit, është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe mospjesëmarrja e saj cenon mbrojtjen e interesave të shtetit. Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave publike nga ana e saj në një gjykim të filluar, është një përfaqësim dhe mbrojtje e detyrueshme dhe gjykata sipas nenit 79/a, të Kodit të Procedurës Civile, ka detyrimin që t’i njoftojnë aktet AVSH-së, me qëllim që jo vetëm të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim, por edhe të realizojë mbrojtjen efektive të interesave të shtetit, pavarësisht përfaqësimit të organit shtetëror (vendimi nr. 27, datë 27.7.2009, i Gjykatës Kushtetuese, vendim unifikues nr. 3/2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë). Gjithashtu, Kolegji Civil ka vlerësuar se është pikërisht nevoja për të ofruar mundësinë e përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetit, në mënyrë të pavarur prej interesave të organit palë në gjykim, që përbën shkak për cenimin e vendimeve në rast të mosthirrjes së AVSH-së.
244. Nga analizimi i materialeve të dosjes gjyqësore konstatohet se Gjykata e Apelit Vlorë, në respektim të procedurave ligjore të nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile, ligjit për Avokaturën e Shtetit dhe VKM-së nr. ***, ka pranuar dhe lejuar thirrjen dhe përfaqësimin e shoqërisë aksionere “***” sh.a. P.¹¹³, me qëllim formimin e drejtë të ndërgjyqësisë mes palëve, përfaqësimit, mbrojtjen dhe për realizimin e një procesi të rregullt ligjor në mbrojtje të interesave të shtetit, si dhe ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin për rigjykim me qëllim thirrjen e Avokaturës së Shtetit bazuar në nenin 466/a të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim edhe të nenit 79 të po këtij kodi.
245. Lidhur me pretendimin e denoncuesit se në çështjet e tjera me të njëjtin objekt padie nuk ishte thirrur Avokatura e Shtetit nga gjykata, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2020, për vënien në dispozicion të vendimeve: nr. ***, datë 21.12.2017; nr. ***, datë 15.7.2020 dhe nr. ***, datë 22.7.2020. Gjykata e Apelit Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 28.10.2020, vuri në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, ku nga shqyrtimi i të cilit konstatohet se:
- i. Vendimi nr. ***, datë 15.7.2020, me palë ndërgjyqëse E. Gj., palë e paditur “***” sh.a. P. me objekt padie “detyrimin e të paditurit për të paguar pagën e paditësit për periudhën 31.8.2014 – 1.8.2015; detyrimin e të paditurit për të paguar shpenzimet

¹¹³ Në zbatim të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur përsëritjen e hetimit gjyqësor. Në zbatim të nenit 79 të Kodit të Procedurës Civile është detyrë e gjykatës thirrja e Avokaturës së Shtetit, e cila më pas referuar objektit të padisë relaton me shkrim pjesëmarrjen apo delegimin e përfaqësimit sipas rastit të organit.

gjqësore dhe ato të përfaqësimit”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. ***, datë 29.12.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë. Gjykata e Apelit Vlorë¹¹⁴, me vendimin nr. ***, datë 15.7.2020, ku kryesuese ka qenë subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 29.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier”. Bazuar në Kodin e Procedurës Civile, neni 79, në ligjin nr.10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, në vendimin nr. ***, datë 8.4.2009, “Për miratimin e rregullores për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me Institucionet Shtetërore dhe Entet Publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale, neni 32 germa “d” përcakton delegimin e të drejtës së përfaqësimit dhe të mbrojtjes nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, *kur objekt gjykimi janë marrëdhëniet e punës ndërmjet institucioneve dhe personave të tretë, pavarësisht germës ‘d’ të këtij neni*”. Pretendimi i denoncuesit për mosthirrjen e Avokaturës së Shtetit në gjykimin në Apel nuk qëndron, pasi objekti i padisë është marrëdhënia e punësimit, objekt i cili bazuar në ligjin sa më sipërcituar, delegohet për përfaqësim dhe mbrojtje Entit Publik palë në proces, sipas procedurave ligjore të parashikuara.

- ii. Vendimi nr. ***, datë 22.7.2020, me palë paditëse E. G., i paditur shoqëria “****” sh.a. P., person i tretë Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatura e Shtetit, Zyra vendore Vlorë, me objekt padie “ Konstatimi i faktit të diskriminimit të paditësit, për shkak të lidhjeve familjare në formën e viktimizimit, e kryer nga ana e punëdhënësit ‘****’ sh.a. P.. Ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura duke detyruar punëdhënësin ‘****’ sh.a. P., të rikthejë paditësin në vendin e mëparshëm të punës në pozicionin e juristit pranë palës së paditur. Detyrimin e punëdhënësit ‘****’ sh.a. të dëmshpërblejë paditësin për dëmin pasuror dhe jopasuror të pësuar. Detyrimin e punëdhënësit ‘****’ sh.a. P. të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe ato të përfaqësimit me avokat”. Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me vendimin nr. ***, datë 20.4.2018, ka vendosur “Rrëzimin e padisë”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se ka rezultuar e provuar se paditësi E. G. ka qenë punëmarrës i shoqërisë “****” sh.a. P., ky i fundit me vendimin nr. ***, datë 22.8.2014 ka zgjidhur kontratën e punës, shtetasi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.4.2015, ka vendosur dëmshpërblimin e të paditurit, vendimi i cili ka marrë formë të prerë me vendimin nr. ***, datë 25.10.2016, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Më tej, paditësi duke pretenduar se shkak i zgjidhjes së kontratës ka qenë lidhja familjare me shtetasin M. G. (babai i tij) i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Paditësi, duke pretenduar faktin e diskriminimit në formën e viktimizimit të lidhjeve familjare, i është drejtuar gjykatës që të konstatojë faktin e diskriminimit dhe të detyrojë të paditurin “****” sh.a. P., që ta kthejë në vendin e punës, si dhe t’i paguajë shpërblimin e dëmit jopasuror që ka pësuar nga ky fakt. Gjykata e Apelit Vlorë, me kryesuese subjektin e rivlerësimit, pasi ka marrë në analizë të plotë të gjitha shkaqet e ankimit dhe pretendimet e shtetasit, ka vlerësuar të pabazuara në ligj e në prova pretendimet e ngritura në ankimin e paditësit dhe, në përfundim, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 20.4.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier”.

246. Në konkluzion, nga shqyrtimi i dokumentacionit të lartpërmendur konstatohet se Avokatura e Shtetit ka qenë e konsideruar si palë në procedimin *de quo*, pasi ka rezultuar

¹¹⁴ Nga analizimi i akteve dhe rrethanave të çështjes ka rezultuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është i drejtë, i bazuar në prova dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, ai duhet të lihet në fuqi, sepse me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arritur në konkluzionin se është para “gjësë së gjykuar”.

se është thirrur rregullisht si person i tretë, ndonëse përgjatë gjykimit të kësaj çështjeje nuk ka qenë prezente. Për rrjedhojë nuk rezulton i bazuar/provuar pretendimi i denoncuesit mbi mosthirrjen e Avokaturës së Shtetit si palë në shqyrtimin gjyqësor në fjalë.

23. Denoncim i datës 29.10.2020, i *, P.**

247. Njëpërmjet postës elektronike nga ***, P., është përcjellë në Komision një denoncim me të cilin sindikata i ka bërë thirrje institucioneve të *Vetting*-ut, të marrin masa që prokurorët dhe gjyqtarët e denoncuar, që po bëjnë batërdi në sallat e gjyqit të futen në listën e kalimit të hetimit sa më parë. Kjo sindikatë ka vënë në dispozicion disa fletëthirrje të Gjykatës së Apelit Vlorë, nga ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, në cilësinë e kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë, ka dhënë vendimin nr. ***, datë 15.10.2020, me objekt “*Për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje*” të subjektit të rivlerësimit gjyqtarit, S. D., bazuar në nenin 72, pika 4, neni 72 paragrafi i dytë dhe neni 73 i Kodit të Procedurës Civile, nga ku ka vendosur – “Të mos miratojë kërkesën për dorëheqje të gjyqtarit S. D., nga gjykimi i çështjes civile nr. ***, datë 8.12.2016, me palë kërkuese ***, P. me objekt vendimi ‘Rishikim vendimi’, si dhe me vendimin e datës 15.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka marrë në shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen penale që i përket kërkuesit G. T. (përfaqësues i sindikatës), me objekt “Përjashtim gjyqtari” për përjashtimin e gjyqtarëve Dh. L., S. B. dhe A. B., në përfundim ka vendosur “Rrëzimin e kërkesës së përjashtimit të gjyqtarëve, si të pabazuar as në prova dhe në ligj”.
248. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të sipërcituar dhe të depozituar nga sindikata, nuk shihen *indicie* për thellimin e hetimit administrativ, për aq kohë sa denoncuesi nuk ka parashtruar shkelje procedurale të subjektit të rivlerësimit si ato të parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 86/2016, si dhe nga shqyrtimi i vendimeve të administruara nuk vërehet ndonjë mungesë arsytimi apo arsytim i dobët nga subjekti i rivlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me denoncimet e sipërpërshkruara

249. Lidhur me denoncimet e publikut, për të cilat ishte kërkuar të jepte shpjegime, subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur argumentet dhe provat si vijon:
250. *Shtetasi A. J. i është drejtuar gjykatës me padinë me objekt fshirjen e pronës së të paditurve nga regjistrat e pasurive të paluajtshme të ZVRPP-së Berat. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore nr. ***, datë 11.4.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, nr. ***, datë 8.6.2009, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. ***, datë 5.4.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë konstatohet se gjykatat e kanë rrëzuar padinë e shtetasit A. J., jo vetëm për mungesë të legjitimitetit aktiv të paditësit, por edhe si padi të pabazuar në prova e në ligj. Edhe pas kryerjes së detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka konkluduar në bazë të bindjes se dhe pas kryerjes së aktekspertimit topografik, se pretendimi i paditësit nuk është i drejtë dhe as i bazuar në prova e në ligj, pra, në të njëjtin përfundim si Gjykata e Apelit Vlorë, e cila ka arritur në bindjen e brendshme se paditësit i mungonte interesi i ligjshëm në ngritjen e padisë. Për sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes detyra e lënë nga Gjykata e Lartë ka qenë*

e panevojshme, pasi çështja zgjidhej në gjendjen e akteve të administruara, shqyrtuara dhe analizuara nga gjykata e shkallës së parë. Edhe Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë ka konstatuar mungesën e interesit të ligjshëm të palës paditëse dhe ka vendosur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 11.4.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, vendim ky i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë.

251. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, lidhur me sa më sipër.
252. Lidhur me denoncimin nr. *** prot., të shtetasit K. B., subjekti i rivlerësimit është shprehur se: Për sa i përket çështjes civile me palë paditëse F. N. dhe të paditur shoqërinë “***” sh.p.k., me përfaqësues K. B. dhe V. B. është vërtetuar me prova shkresore dhe aktekspertime se aksidenti në punë i paditësit ka ndodhur për shkak të moszbatimit të rregullores prej palës punëdhënëse dhe vlera e përlllogaritur për pagimin e dëmit të shkaktuar ka rezultuar nga metodologjia e përdorur prej eksperteve. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit, nr. ***, datë 18.7.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”, duke i dhënë zgjidhje të bazuar në ligj dhe në prova çdo pretendimi e prapësimi. Mbi pretendimet e shoqërisë tregtare të parashtruara edhe në rekurs, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 7.12.2015, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të ushtruar nga e paditura shoqëria “***” sh.p.k. kundër vendimit nr. ***, datë 17.12.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë”.
- a) Shoqëria “***” që fillimisht ka pasur për administrator shtetasit K. B dhe V. B. ka pasur disa procese gjyqësore që lidhen me procedurën e çeljes së falimentit. Midis të tjerash, administrator i shoqërisë në faliment është caktuar shtetasi Rr. Xh. dhe është pikërisht vetëm ky shtetas që legjitimohej për të përfaqësuar shoqërinë “***”.
- b) Në lidhje me gabimin material në vendimin nr. ***, datë 20.5.2015, të Gjykatës së Apelit, subjekti sqaron se Gjykata e Apelit në seancën e parafundit gjyqësore, datë 14.5.2015 ka kryer verifikimin e prezencës së palëve dhe shkaqeve të mosparaqitjes së tyre dhe ka konstatuar se shoqëria në faliment “***” kishin dijeni për datën dhe orën e gjykimit dhe ka vendosur zhvillimin e gjykimit në mungesë të saj. Ndërkohë në seancën datë 20.5.2015, që ishte caktuar për shpalljen e vendimit, administratori i falimentit ka qenë i pranishëm dhe ka dëgjuar vendimin. Sa më sipër, pasqyrimi i faktit në pjesën hyrëse të vendimit të kërtimeve përfundimtare të palëve, ku është bërë një gabim material gjatë shkrimit të vendimit se edhe administratori i shoqërisë në faliment është shprehur për lënien në fuqi të vendimit, është një fakt që nuk ndikon aspak as në zgjidhjen në themel të çështjes në gjykimin në shkallë të dytë, por as në humbjen e afatit të ushtrimit të rekursit. Madje, administratori i shoqërisë së falimentit nuk ka ushtruar rekurs kundër këtij vendimi dhe as ka bërë kallëzim penal ndaj gjyqtarëve të trupit gjykues.
- c) Debitori K. B. ka kërkuar përjashtimin tim nga trupi gjykues për gjykimin e çështjes me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv kundër të paditurve “***” sh.a. dhe shoqërisë përmbartimore “***” sh.p.k., me argumentin se ky shtetas ka paraqitur kallëzim penal ndaj meje. Nga ana tjetër, edhe unë, kam vlerësuar si rrethanë relevante për të cilën duhet të jepja dorëheqjen nga gjykimi faktin se ky shtetas ka krijuar dyshime objektive e subjektive për mungesën e paanshmërisë time si gjyqtare në gjykimin e çështjes. Kërkesën time e kam bazuar në pikën 6, të nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile. Edhe pse, akuza e tij e ngritur ndaj meje nuk qëndronte dhe ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nuk rezulton të jetë ushtruar ndonjë mjet ankimi, si kryetari i Gjykatës së Lartë, ashtu edhe trupi gjykues që shqyrtoi kërkesën për përjashtimin tim kanë

rrezuar kërkesat, ndaj, kam vijuar të jem pjesë e trupit gjykues, duke kryer në përmbushje të ligjit detyrën time si gjyqtare.

253. *Denoncuesi “***” pretendon se Gjykata e Apelit Vlorë nuk ka marrë parasysh kërkesën për shtyrje të seancës gjyqësore, pasi juristja ka qenë me raport mjekësor dhe, si rrjedhojë, palës paditëse i janë dëmtuar interesat pasurore këtij të fundit. Shoqëria “***” ka caktuar me autorizim dy përfaqësues të saj në gjykimin e çështjes në shkallë të parë, ndaj nuk përbën justifikim të pranueshëm ligjërishit pretendimi i mospjesëmarrjes në seancë gjyqësore, kur një përfaqësues nuk mund të paraqitet për shkaqe shëndetësore, ndërkohë që nga ana tjetër ky fakt nuk e përjashtonte shoqërinë “***” nga përgjegjësia dhe detyrimi për të dërguar si përfaqësues të saj të autorizuarin tjetër. Gjithashtu, shoqëria as nuk provoi shkakun e pamundësisë së paraqitjes së të autorizuarit tjetër, ndonëse kishte detyrimin ligjor të njoftonte gjykatën për pengesën e pamundësinë për të ushtruar mbrojtjen e interesave të saj. Gjykata e Apelit e ka konsideruar shkak për zvarritje të qëllimshme të gjykimit kërkesën për shtyrje të seancës gjyqësore, nisur nga fakti që mungesa e një përfaqësuesi të vetëm për shkaqe shëndetësore nuk e pamundësonte shoqërinë për të caktuar një tjetër përfaqësues me qëllim paraqitjen në Gjykatën e Apelit. Në kuptim të nenit 175, të Kodit të Procedurës Civile, pala e paditur nuk i provoi me asnjë lloj akti shkresor apo prove vullnetin dhe përpjekjet e arsyeshme për të siguruar pranë Gjykatës së Apelit paraqitjen e përfaqësuesit tjetër apo rrethanat që do e bënë të pamundur pjesëmarrjen edhe të këtij përfaqësuesi të dytë.*
254. *Bashkëngjitur këtyre shpjegimeve ka paraqitur si provë autorizimet e shoqërisë “***” - të dy përfaqësuesve, procesverbalin e seancës gjyqësore të Gjykatës së Apelit, si dhe rekursin e paraqitur nga kjo shoqëri.*
255. *Konstatohet se shoqëria “***” ka autorizuar 2 përfaqësues për të marrë pjesë në gjykim dhe se në seancën e datës 11.10.2018, është relatuar se njeri nga përfaqësuesit ka depozituar raport mjekësor, duke kërkuar shtyrjen e seancës gjyqësore. Trupi Gjykues, pasi ka marrë edhe mendimin e palës prezente në gjykim, e cila ka kërkuar të mos pranohet kërkesa pasi është bërë me qëllim zvarritjen e procesit, ka vendosur të zhvillojë procesin në mungesë të palës paditëse. Vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe shteruese, për aq kohë sa në seancën gjyqësore nuk ishte paraqitur apo depozituar ndonjë akt shkresor nga shoqëria “***” për të siguruar pranë Gjykatës së Apelit për pamundësinë e paraqitjes së përfaqësuesit tjetër apo rrethanat që do e bënë të pamundur pjesëmarrjen edhe të këtij përfaqësuesi të dytë.*
256. *Lidhur me denoncimin e shtetasit M. G., sipas të cilit akuzon subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë dhe gjykim në kushtet e konfliktit të interesit, të cilat kanë cenuar sigurinë juridike të procesit të rregullt ligjor, duke i shkaktuar denoncuesit dëm të madh ekonomik. Denoncuesi ka siguruar të dhëna të gjendjes civile jo vetëm për mua personalisht, por edhe për persona të tjerë, pa e shoqëruar kërkesën me aktet se si ai i ka siguruar këto të dhëna personale nga institucionet shtetërore. Pretendimet e kërkuarit se kam vepruar në kushtet e konfliktit të interesit nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore. Në rastin konkret vlerësoj se pretendimet e kërkuarit se unë kam gjykuar çështjet në kushtet e konfliktit të interesit nuk janë të bazuara. Kështu neni 72 i Kodit të Procedurës Civile parashikon rastet e përjashtimit të gjyqtarit kur ai ose bashkëshorti i tij ka lidhje gjinore deri në shkallë të katërt ose lidhje krushqie deri në shkallë të dytë me palët në proces. Kërkuari pretendon se unë nuk duhet të kisha gjykuar çështjet e ngritura prej tij pasi znj. B. B., ministre e kësaj qeverie është motra e kunatës sime. Kjo lidhje e pretenduar nga kërkuari nuk përfshihet në rastet e krushqisë deri në shkallë të dytë, pasi një cilësi të tillë e kanë vetëm kunata, vjehri dhe vjehrra, thjeshtri e thjeshtra. Veç kësaj, duhet theksuar*

*se ministrja që ajo përfaqëson nuk është pronare e aksioneve të shoqërisë “***” palë e paditur. Ajo gëzon vetëm cilësinë e përfaqësueses së ministrisë përkatëse për shkak të pozicionit të punës të mbajtur prej saj. Në rastin konkret, shtetasja B. B. nuk rezulton as të jetë palë në gjykim dhe as të jetë mbrojtës i palëve. Pronar i aksioneve të shoqërisë “***” është shteti shqiptar dhe jo përfaqësuesi i ministrisë.*

257. Lidhur me vendimin nr.***, datë 21.12.2017, sqarohet se në raport është theksuar se është vendosur në pjesën “për këto arsye” si referencë ligjore nenit 466/a i Kodit të Procedurës Civile, që ka të bëjë me lënien në fuqi të vendimit dhe jo me prishjen e tij. Është i vërtetë ky konstatim i Komisionit, por shënimi i kësaj dispozite përbën një gabim material që mund të ndreqet në çdo kohë nga gjykata qoftë edhe kryesisht sipas nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile. Për më tepër, ky gabim material nuk ka sjellë asnjë pasojë mbi çështjen pasi vendimi i gjykatës për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë e kthimin e çështjes për rigjykim është i qartë si në pjesën arsyetuese dhe në dispozitivin e vendimit.

Megjithatë, në kuadër të qëndrimit të dhënë në këtë vendim, veç atyre që janë sqaruar në të, theksohet se pjesëmarrja e Avokaturës së Shtetit në proceset ku janë palë organet shtetërore ose entet publike ose shoqëritë tregtare me kapital shtetëror përbën një detyrim ligjor për gjykatën sipas nenit 79/a të Kodit të Procedurës Civile, gjë që passjellë automatikisht prishjen e çështjes dhe kthimin për rigjykim, qëndrim që është mbajtur në vendimin unifikues nr.13/2004. Gjykata e shkallës së parë nuk i kishte njoftuar aktet dhe kohën e zhvillimit të gjykimit zyrës vendore të avokaturës Vlorë, fakt ky që nuk kundërshtohet as nga denoncuesi. Sipas vendimit të Kryeministrit nr. 392/2009, në nenin 32 parashikohet se delegimi i të drejtës së përfaqësimit në gjykim nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit bëhet bazuar në kriteret e mëposhtme: ç) Kur vlera e objektit të padisë së çështjes objekt gjykimi është më e vogël se 2,000,000 (dy milionë) lekë; në rastin konkret rezulton se shuma e dëmshpërblimit e kërkuar në padi dhe gjatë gjykimit është në vlerë më të madhe se 2,000,000 lekë. I pabazuar mbetet edhe pretendimi i denoncuesit mbi zbardhjen me vonësë të vendimeve gjyqësore, fakt që provohet kopja e librit të dorëzimit të dosjeve, sipas të cilave, dorëzimi i dosjeve pas arsyetimit të vendimit nga ana ime të sekretarja gjyqësore është 5 ditë dhe nga sekretarja gjyqësore në kryesekretari brenda 5 ditëve.

258. Bashkëngjitur këtyre shpjegimeve, subjekti ka paraqitur procesverbalin gjyqësor, ku në f. 5 të tij konstatohet se av. shtetit ka pretenduar si shkelje për kthimin për rigjykim të çështjes mosthirrjen e Avokatit të Shtetit, si dhe pjesë nga libri i dorëzimit të dosjeve.

Vlerësimi i trupit gjykues

259. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fjalë rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe shteruese, si dhe nuk vërtetohet pretendimi i denoncuesit mbi zbardhjen me vonësë të vendimit të Gjykatës, pasi referuar kopjes së librit të dorëzimit, vlerësohet se vendimi është depozituar brenda afatit ligjor 5-ditor, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar me ligjin nr.122/2013, datë 18.4.2013, vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces, brenda tri ditëve nga marrja e vendimit ose në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tri ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar.
260. Si përfundim, nisur nga përmbajtja e dokumenteve të administruara dhe të shqyrtuara nga Komisioni, lidhur me denoncimet e përshkruara, si dhe nga shpjegimet e zgjeruara të subjektit, trupi gjykues vlerëson se këto të fundit rezultojnë bindëse dhe se në çështjet

gjqësore të përshkuara më sipër, nuk janë konstatuar shkelje procedurale, cenim të të drejtave të palëve apo mangësi profesionale të znj. Iliba Bezati.

Lidhur me fakte të njohura botërisht

261. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është vënë në dijeni nga mjetet e informimit publik lidhur me disa artikuj të publikuar në median *online*. Në kuadër të kryerjes së një hetimi gjithëpërfshirës, janë administruar dhe analizuar të dhënat përkatëse, nga ku është konstatuar si vijon:

24. Denoncim nga Reporter.al në *linkun* <https://wwwreporter.al/perandoria-e-biznesit-mbi-nje-krim-si-i-shpetuan-vellezerit-C.-drejtesisë/>

262. Sipas investigimit të BIRN të datës 18.6.2018 përshkruhet se ndonëse u akuzuan nga drejtësia greke dhe shqiptare për shfrytëzimin për prostitucion dhe vrasjen barbare të 24-vjeçares N. H., M. Ç. dhe Sh. Ç. i shpëtuan drejtësisë. Sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, që BIRN ka disponuar, rezulton se shtetasi M. Ç. e ka rrahur për 15 minuta shtetasen N. H. dhe më pas i ka vënë duart në fyt në dhomën e një apartamenti në lagjen “***” Athinë. Sipas vendimit të Gjykatës, i vëllai Sh. Ç., jo vetëm që nuk bëri asgjë për të shpëtuar viktimën, por e inkurajoi të vëllanë të shtonte intensitetin e dhunës. Më 28.1.2004, shtetasi Sh. Ç. arrestohet, ndërsa vëllai i tij i madh nuk gjendet nga policia. Të dhënat e dosjes gjyqësore tregojnë sipas BIRN-it se shtetasi Sh. Ç. u lirua nga burgu vetëm dy javë më pas nga Gjykata e Apelit të Vlorës, pasi la në këmbim si garanci shumë 1,000,000 lekë. Sipas BIRN - treshja e gjyqtarëve, e përbërë nga S. J., Iliba Bezati dhe M. R. argumentuan se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier e fajësonte me të drejtë shtetasin M. Ç., por provat në ngarkim të vëllait të tij, Sh. Ç., “*ishin të dyshimta, të paqarta dhe arsyetimi i shkallës së parë ishte kontradiktor*”.
263. Procesi gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier përfundoi 10 vjet pas krimit, më 8.1.2008, ku sipas vendimit shtetasi M. Ç. u dënua me 16 vjet burg dhe i vëllai, Sh. Ç. me 14 vjet burg, pasi përfituan edhe uljen e 1/3 së dënimit. Ky vendim u kundërshtua në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila brenda gjashtë muajve vendosi të rrëzojë akuzat dhe të pushojë çështjen në ngarkim të shtetasit Sh. Ç.
264. Nisur nga sa më sipër, Komisioni¹¹⁵, me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2020, i kërkoj Gjykatës së Apelit Vlorë vënien në dispozicion të vendimit nr. ***, datë 17.9.2008, me të pandehur M. Ç. dhe Sh. Ç., të akuzuar për veprat penale “vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër të kryer në bashkëpunim” dhe “shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese të kryera në bashkëpunim”. Nga shqyrtimi i vendimit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtare e trupës gjyqësore në dhënien e vendimit në të cilin është argumentuar se: “... *viktima N. H. kryente prostitucion në një shtëpi publike të licencuar, lidhur me shtetasin Sh. Ç. të shpallur të pafajshëm argumentoi se dijenia apo shoqërimi i saj i shpesh të për në shtëpinë publike nga Sh. Ç. nuk përbën provë në kuptimin që është subjekt i veprës shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese*”. Sa i përket akuzës së vrasjes me dashje në lidhje me një krim tjetër, Gjykata e Apelit Vlorë e përjashton gjithashtu rolin e shtetasit Sh. Ç., duke argumentuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e ka përfshirë “*Në mënyrë mekanike si bashkëpunëtor, ajo nuk ka përcaktuar nëse i pandehuri ka qenë pa ndërprerje në banesë në darkën e datës 13.2.1998 dhe gjatë natës që ka ndodhur ngjarja (rrahja)...*”, ka arsyetuar në vendimin e saj Gjykata e Apelit

¹¹⁵ Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2020 dhe Gjykata e Apelit Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2020 vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 29.3.2018, që i përket shtetasit T. M.; vendimin nr. ***, datë 30.10.2017, që i përket shtetasit F. Ll.; vendimin nr. ***, datë 12.11.2018, që i përket shtetasve Sh. Gj. etj.; vendimin nr. ***, datë 17.9.2008, që i përket shtetasve Sh. Ç. dhe M. Ç..

Vlorë, e cila në përfundim shpalli fajtor për krimin vetëm shtetasin M. Ç. dhe prishi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për shtetasin Sh. Ç. Vendimi i pafajësisë për shtetasin Sh. Ç. ka mbetur në fuqi edhe pasi Prokuroria kishte bërë rekurs në Gjykatën e Lartë. Në vendimin nr. ***, datë 17.9.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë nuk rezultoi të këtë informacion lidhur me lënien të lirë të shtetasit Sh. Ç., kundrejt garancisë prej 1,000,000 lekësh, sikurse shprehet BIRN¹¹⁶ në artikullin e botuar.

25. Denoncim nga Ora News TV në *linkun*: <https://www.oranews.tv/article/gjykata-e-apelit-vlorë-e-shpall-të-pafajshëm-Sh.-Gj.-11-katëshin-në-qendër-të-Vlorës>.

265. Denoncim nga televizioni “Ora News” në datën 14.11.2018, për shpalljen të pafajshëm nga Gjykata e Apelit Vlorë të ish-kryetarit të Bashkisë Vlorë, Sh. Gj. Ai akuzohej nga Prokuroria e Vlorës për katër akuza dhe më konkretisht: “shpërdorim detyre”, “falsifikim dokumentesh”, “fshehje të provave të krimit” dhe “ndërtim të paligjshëm”. Prokuroria kërkoi 9 vjet burg për shtetasin Sh. Gj. dhe nëpunësit e tjerë të Urbanistikës Vlorë. Sa më sipër, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë për vënien në dispozicion të vendimit nr. ***, datë 12.11.2018, me kryesuese të trupës A. L. dhe anëtarë P. A. dhe Iliba Bezati, me palë të pandehurit: Sh. Gj., A. H., R. M., D. B., për kryerjen e veprave penale “falsifikimi i dokumenteve” të kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, “ndërtim i paligjshëm” dhe “veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 27.7.2017, ka vendosur “Deklarimin fajtor të pandehurit Sh. Gj. për kryerjen e veprës penale ‘Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës’; deklarimin e pafajshëm të shtetasit Sh. Gj. për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”; deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Sh. Gj. për kryerjen e veprës penale “ndërtim i paligjshëm”; vënien në provë për një periudhë 2-vjeçare dhe heqjen e masës së sigurimit personal, detyrim paraqitje caktuar ndaj tij; deklarimin fajtor të shtetasit A. H., për veprën penale “falsifikim i dokumenteve” dhe vënien në provë për një periudhë 3-vjeçare; deklarimin e pafajshëm të shtetasit D. B. për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”.
266. Ka rezultuar se ky vendim është apeluar nga palët në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 27.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me ndryshimet si vijon: prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit Sh. Gj. për veprat penale “falsifikim nga personat që kanë pasur për detyrë të lëshojnë dokumentin”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal dhe për veprën penale “veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 130 i Kodit Penal; prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit A. H. për veprën penale “falsifikim i dokumenteve më shumë se një herë” dhe të veprës penale “ndërtim i paligjshëm të kryer në tokë shtetërore dhe në tokë të tjetrit”; prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes për të pandehurin R. M. për veprën penale “falsifikim të dokumenteve me më shumë se një herë” dhe të veprës penale “ndërtim i paligjshëm të kryer në tokë shtetërore dhe në tokë të tjetrit”; urdhërimin dhe heqja e sekuestros preventive dhe kthimin në favor të pronarëve të ligjshëm të sendeve të paluajtshme, sipas vendimi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe kthimin e dokumentacionit Bashkisë Vlorë (vendimet e KRRT-së nr. ***, datë 17.1.2011, formularin nr. *** dhe leje ndërtimi).
267. Nga analizimi i denoncimit të sipërpërmendur nuk rezultoi ndonjë shkelje procedurale, pasi pretendimet e ngritura në denoncimin mediatik kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe themelin e çështjes/vendimmarrjes, gjë që është në tejkalim të kompetencës lëndore të

¹¹⁶Lutem referojuni vendimit nr. ***, datë 17.9.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë në dosjen e Komisionit.

Komisionit, në procesin e rivlerësimit. Nga sa më lart nuk jepen *indicie* konkrete lidhur me pretendimet e denoncuara për gjetje specifike që do të lidheshin dhe mund të ndikonin me/në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.

26. Denoncimi nga emisioni “STOP” në *linkun*: <http://stop.tvklan.al/skandali-i-drejtesise-gjykata-pushon-ceshtjen-ndaj-G.-B.-22-nentor-2018/>

268. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni është njohur me faktin se në datën 22.11.2018, emisioni televiziv “STOP”, në TV Klan kishte transmetuar një rast që lidhej me ish-kreun e gjykatës së Gjirokastrës, z. G. B., i cili, sipas denoncimit i kishte kërkuar favore seksuale një qytetareje, në shkëmbim të ndihmës që t’i jepte në favor vendimin mbi një çështje, në gjykim nga ky i fundit. Një ditë pas transmetimit të këtij skandali, Këshilli i Lartë i Drejtësisë kishte zhvilluar një mbledhje urgjente dhe kishte liruar nga detyra gjyqtarin G. B., duke ngritur edhe grup inspektimi për rastin.
269. Nga analizimi i dokumentacionit në dispozicion, evidentohet se kjo çështje gjyqësore kaloi fillimisht për hetim në Gjykatën e Krimeve të Rënda, por kjo e fundit shpalli moskompetencë dhe ia kaloi për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për të mos pasur konflikt interesi me Gjykatën e Gjirokastrës. Prokurorja e Fierit E. H., e cila kryente hetimet, e pushoi çështjen duke bërë që ish-kreu i Gjykatës së Gjirokastrës, G. B., të dalë i pafajshëm. Gjyqtarja, O. L., e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier e prishi këtë vendim, duke kërkuar hetim të thelluar të kësaj çështjeje, vendim i cili u ankimua në Gjykatën e Apelit Vlorë.
270. Komisioni iu¹¹⁷ drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë për vënien në dispozicion të vendimit nr. ***, datë 1.3.2018, me palë kërkuese shtetasen R. I. dhe palë të interesuar Prokuroria e Rrethit Fier. Vendimi është gjykuar nga treshja me kryesuese subjektin e rivlerësimit Iliba Bezati dhe anëtarë P. A. dhe B. U., ku objekti i çështjes penale ka qenë: “*Kundërshtimi i vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 25.5.2017, të Prokurorisë së Rrethit Fier*”. Në përfundim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 1.3.2018, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 26.12.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe kthimin e akteve për vazhdimin e gjykimit në po atë gjykatë, me të njëjtin trup gjykues”.
271. Nga sa më lart nuk janë gjetur as shkelje procedurale dhe as elementë që mund të ngrinin dyshimin se subjekti i rivlerësimit mund të kishte mbajtur qëndrim favorizues - siç aludohet në denoncimin e sipërcituar - për sa kohë vendimmarrja e saj për prishjen e vendimit të pushimit të çështjes penale rezulton të jetë në sens të kundërt, pasi ka kthyer dosjen për vazhdimin e gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila nuk ishte shprehur në lidhje me shkaqet e ankimit të paraqitura nga ankuesja R. I. Për më tepër, nga këndvështrimi procedural, konstatohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, ku ishte anëtare trupe edhe subjekti, është marrë në zbatim dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 428/ç të Kodit të Procedurës Penale, që ka të bëjë me pjesëmarrjen e ankimueses në gjykim¹¹⁸.

27. Denoncimi në gazetën sot.com

¹¹⁷ Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 23.4.2020 dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 4.5.2020, vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 29.3.2018, që i përket shtetasit T. M.; vendimin nr. ***, datë 30.10.2017, që i përket shtetasit F. Ll.; vendimin nr. ***, datë 12.11.2018, që i përket shtetasve Sh. Gj. etj.; vendimin nr. ***, datë 17.9.2008, që i përket shtetasve Sh. Ç. dhe M. Ç.

¹¹⁸ Gjykata e Apelit Vlorë vendosi prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për vazhdimin e gjykimit, në Gjykatën e Fierit për aq kohë sa kohë nuk ishte shprehur në lidhje me shkaqet e ankimit të paraqitur nga ankuesja R. I., kundër vendimit të pushimit të paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier.

272. Denoncim i datës 31.10.2017 në *linkun* <https://Sot.Com.Al/Aktualitet/Atentati-M%C3%Ab-1-Tetor-N%C3%Ab-Vlor%C3%Ab-Gjykata-e-Apelit-Liron-Nga-Burgu-F-LI>, sipas të cilit bëhet fjalë për shtetasin F. Ll. që është liruar nga qelia dhe është vendosur masa e sigurisë “arrest shtëpie”. Gjykata e Apelit Vlorë ka rrëzuar kërkesën e Prokurorisë Vlorë duke ndryshuar masën e sigurisë për shtetasin F. Ll. nga “arrest me burg” në “arrest shtëpie”. Shtetasi A. Ll. u arrestua në flagrancë me akuzën “për armëmbajtje pa leje” dhe “prodhim e shitje të armëve luftarake”, pas atentatit ndaj tij, ndodhur në datë 1 tetor në rrugën transballkanike, ku mbeti i plagosur së bashku me të edhe shtetasi D. B. që ishte në automjet dhe djali 8-vjeçar i tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 4 tetor mori masën e sigurisë “arrest në burg” me afat 20 ditë, ndërsa shtetasi F. Ll. ndodhej në spital për shkak të plagëve të marra gjatë atentatit. Gjatë kësaj kohe ai nuk është shoqëruar në paraburgim, ndërsa pasi kaloi ky afat i dhënë nga Gjykata e Vlorës, u mor vendimi “arrest në shtëpi”. Ndaj masës së sigurisë “arrest në burg” është bërë ankimi, i cili është refuzuar dhe është lënë në fuqi masa e sigurisë “arrest në shtëpi”. Seancat janë drejtuar nga trupa e gjyqtarëve e përbërë nga S. N., M. B. dhe Iliba Bezati.
273. Nga dinamika e ngjarjes duket se shtetasit F. Ll. dhe D. B. ndodheshin në automjetin tip “Benz” me targa ***, ndërsa djali i F. Ll. ka qenë në afërsi të automjetit dhe banesës ku ka ndodhur ngjarja dhe ka marrë plagë në krah nga xhamat e thyer të automjetit. Shtetasi F. Ll. është vëllai i shtetasit A. Ll., njërit prej të dënuarve për masakrën e Ç. më 7.4.2015, i dënuar me 35 vite burg nga Gjykata e Apelit Vlorë.
274. Nisur nga përmbajtja e denoncimit mediatik, Komisioni administroi nga Gjykata e Apelit Vlorë vendimin nr. ***, datë 30.10.2017, të dhënë nga trupa gjyqësore të kryesuar nga S. N. dhe anëtarë M. B. dhe Iliba Bezati, të cilët kanë shqyrtuar çështjen penale me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë”, “Caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” në bazë të nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit F. Ll. (i gjykuar në mungesë). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. ***, datë 4.10.2017 ka vendosur: “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit F. Ll.; Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest me burg” me afat 20 ditë”, sipas neneve 238 dhe 245/1/ç të Kodit të Procedurës Penale, për të garantuar marrjen e provave që lidhen me kryerjen e kësaj vepre penale. Kundër këtij vendimi ka bërë ankimi prokurori, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit për - “Masën e caktimit të masës së sigurimit personal, duke caktuar si masë sigurimi atë të “arrestit me burg” duke pretenduar se nevojat e sigurimit janë të tilla që kërkojnë detyrimisht këtë masë sigurimi, gjithashtu ka paraqitur ankimi ndaj vendimit edhe i dyshuari, i cili ka kërkuar shfuqizimin e dënimit, duke vleftësuar të paligjshëm arrestimin në flagrancë.
275. Përpara shqyrtimit të ankimit, Prokurori i çështjes ka paraqitur në datën 24.10.2017, ankimin se me përfundimin e afatit 20-ditor të caktuar nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kjo e fundit ka rimarrë në shqyrtim kërkesën e prokurorit për caktimin e masës të sigurimit “arrest me burg me afat 20-ditor”) pasi ishte zëvendësuar masa e arrestit me “arrest në shtëpi”. Në këto kushte, prokurori hoqi dorë nga gjykimi. Prokurori i çështjes ka kërkuar të mos pranohet ankimi, pasi nuk ka më objekt gjykimi pas marrjes në shqyrtim të ankimit të prokurorit. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 30.10.2017, bazuar në nenet 418-420 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur “Mospranimin e ankimit”.
276. Nga dokumentacioni i administruar dhe nga dinamika gjyqësore rezulton se Gjykata e Apelit Vlorë, në zbatim të germave “ç” dhe “d”, të pikës 1, të neneve 418 dhe 420, të Kodit të Procedurës Penale, ka vlerësuar të drejtë mospranimin e ankimit të prokurorit, pasi ai kishte kërkuar ndryshimin e vendimit për masën e sigurimit personal, duke caktuar

si masë sigurimi atë të “*arrestit me burg*”, me pretendimin se nevojat e sigurimit janë të tilla që kërkojnë detyrimisht vendosjen e kësaj mase sigurimi. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka paraqitur ankim edhe i dyshuari i cili kërkoi shfuqizimin e vendimit, duke vleftësuar të paligjshëm arrestimin në flagrancë dhe moscaktimin e asnjë mase sigurimi, duke pretenduar se nuk ekzistojnë kushte dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit.

277. Nga sa më sipër nuk janë vërejtur shkelje apo *indicie* që mund të çonin në thellimin e hetimit administrativ, pasi konstatohet se në dinamikën e veprimeve të kryera nga subjekti duket se janë përmbushur elementët dhe rrethanat ligjore të parashikuara nga legjislacioni penal. Bazuar në rrethanat dhe kushtet e sipërpërmendura, Gjykata e Apelit Vlorë, në zbatim të germave “ç” dhe “d”, të neneve 418 dhe 420, të Kodit të Procedurës Penale, pasi ka konstatuar se është hequr dorë nga ankimi nga Prokurori dhe se ankimi nuk ka pasur më objekt, ka vendosur “Mospranimin e ankimit”. Për rrjedhojë, nuk është konstatuar ndonjë shkelje procedurale, favorizim, mosaplikim apo keqaplikim i dispozitave ligjore dhe, për rrjedhojë, Komisioni i gjen të pabazuara aludimet e këtij denoncimi, për sa i përket subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë çështje.

28. Denoncimi në median online, Newsbomb, i datës 9.8.2018

278. Denoncimi i publikuar në linkun <https://www.newsbomb.al/kush-është-gjyqtarja-B.-U.-që-i-dha-lirinë-vrasësit-në-vlorë-u-denoncua-nga-pd-kur-kaloi-vettingun-vendimi-i-200-ha-tokë-për-F.-Y.-130591>, i shtetasit T. M. është përfshirë në një përplasje, ku dy grupe rivale u përfshinë në një shkëmbim zjarri në Vlorë. Ky i fundit u arrestua dy herë nga policia në një hark të shkurtër kohor dhe është akuzuar për vrasje me dashje. Ndërsa Gjykata e Apelit në Vlorë nga “arrest me burg” ndryshoi masën në “arrest shtëpie”. Ishin tre gjyqtarët Iliba Bezati, P. A. dhe B. U., të cilët i mundësuan 28-vjeçarit, lehtësimin e masës së sigurisë.
279. Sa më sipër, Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë për vënien në dispozicion të vendimit nr. ***, datë 28.3.2018, të çështjes penale me të pandehur: E. Ll., T. M., G. C., me objekt: “vleftësimin e ligjshëm të veprës penale”, “vrasje me dashje” dhe “mbajtës pa leje të armëve” dhe caktimin e masës “arrest me burg” për shtetasin E. Ll.; vleftësimin e ligjshëm të arrestimit të shtetasit T. M. për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve”, caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg” vleftësimin e ligjshëm të arrestimit të shtetasit G. C., i dyshuar për veprat penale “vrasje me dashje” dhe “mbajtje pa leje të armëve, si dhe caktimin ndaj tij të masës së sigurimit “arrest me burg”. Nga shqyrtimi i vendimit konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 2.3.2018 ka vendosur: “a) Vleftësimin të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit E. Ll., caktimin si masë sigurimi personal; b) Vleftësimin të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit T. M.; Caktimin si masë sigurimi personal nga shtetasit T. M. “arrest me burg”; c) Vleftësimin të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit G. C.; ç) Caktimin si masë sigurimi personal nga shtetasit G. C., “arrest me burg”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim të tre të dyshuarit.
280. Vendimi i sipërcituar është ankimuar dhe, në përfundim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 28.3.2018, ka vendosur bazuar në nenin 249/6 të Kodit të Procedurës Penale: “*Miratimin e vendimit nr. ***, datë 2.3.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me ndryshimin: - Caktimin ndaj të dyshuarit T. M, të masës së sigurimit personal ‘arrest shtëpie’ me mbikëqyrje elektronike.*” Argumentimi i Gjykatës së Apelit Vlorë lidhur me ndryshimin e masës së sigurimit personal nga “arrest me burg”, në “arrest shtëpie me mbikëqyrje elektronike” është si vijon: “*Në përfundim të shqyrtimit të provave dhe dokumentacionit, akuzës së ngritur nga Prokuroria, ka konkluduar se në*

vështrim të përgjithshëm të provave të mbledhura nga organi i akuzës, pa dashur të hyjë në analizimin e tyre në këtë fazë gjykimi, si dhe duke parë disa rrethana të shtetasit T. M., i cili më parë nuk ka qenë i dënuar, pa precedent penal, si dhe në moshë të cilën sapo ka kaluar kufirin e miturisë, si dhe se deri në këto momente nuk janë vërtetuar ekzistenca e rrethanave rënduese në raport me veprën penale ‘vrasje me dashje dhe armëmbajtje pa leje’”. Gjithashtu, nga provat dhe rrethanat nuk është provuar se shtetasi T. M. ka pasur armë dhe ka hapur zjarr ndaj agresorëve, që ka konkluduar ndryshimin e kësaj mase sigurimi personal “në arrest shtëpie nën mbikëqyrjen elektronike” dhe sipas parashikimeve të nenit 249/6 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se: “Gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit”.

281. Nga analizimi i dokumentacionit përkatës ka rezultuar se Gjykata e Apelit Vlorë, bazuar në rrethanat paraprake dhe të provave të grumbulluara, ka çmuar se masa e sigurimit që duhet t’i caktohet personit nën hetim T. M. është “arrest në shtëpi” me mbikëqyrje elektronike si masë e përshtatshme në raport me rrezikshmërinë e veprës, si dhe me faktin se shtetasi sapo ka kaluar moshën e pjekurisë. Ndërsa sa i përket masës së sigurimit për personat e tjerë E. Ll. dhe G. C., ka cilësuar se në vlerësim dhe nga shqyrtimi i fakteve dhe provave konkrete, masa e sigurimit “arrest me burg”, e parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale është e përshtatshme me nevojat konkrete të çështjes në hetim. Në përfundim, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur në përputhje dhe në zbatim të kushteve ligjore që parashikon neni 249/6, miratimin e vendimit nr. ***, datë 2.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me ndryshimin – “Caktimin ndaj të dyshuarit T. M. masën e sigurimit personal ‘arrest shtëpie’ me mbikëqyrje e elektronike”.
282. Në konkluzion, pa kryer një vlerësim mbi themelin e vendimmarrjes, në vijim të analizimit të të dhënave të paraqitura nëpërmjet denoncimit publik, si dhe përmbajtjen e vendimit *de quo* të gjykatës në fjalë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të kushteve dhe kriterëve ligjore që përcakton edhe neni 229 i Kodit të Procedurës Penale, ka pasur/mbajtur parasysh përshtatshmërinë dhe llojin e “masës së sigurimit” në raport me shkallën e rëndësisë së faktit të ndodhur. Gjithashtu, për sa i takon ndryshimit të llojit të masës së sigurimit nga “arrest me burg” në “arrest shtëpie me mbikëqyrje elektronike” rezulton se është mbajtur parasysh dhe është vlerësuar duke mbajtur në vëmendje edhe kushtet dhe rrethanat specifike (rënduese dhe lehtësuese) të parashikuara nga nenet 229 dhe 230 të Kodit Penal, sa i takon shtetasit T. M.
283. Nga sa më sipër ka rezultuar se veprimet procedurale dhe spektri vendimmarrës në këtë rast çmohen se kanë qenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në momentin e vendimmarrjes mbi çështjen në fjalë dhe, konkretisht, në respektim dhe brenda kornizës ligjore të përcaktuar nga nenet: 237, 229 dhe 230, të Kodit të Procedurës Penale, në respektim të të drejtave të palëve. Gjithashtu, nuk janë konstatuar elementë që mund të evidentonin ndonjë konflikt të mundshëm interesi përgjatë shqyrtimit të çështjes në fjalë apo shkelje etiko-profesionale të subjektit të rivlerësimit.

LIDHUR ME DY DOSJE PROFESIONALE TË TRAJTUARA NË VIJIM TË INDICIEVE TË TJERA

29. Lidhur me çështjen penale dhe vendimin nr. *, datë 6.12.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë**

284. Në vijim të informacioneve dhe të *indicieve* të marra nga organet ligjzbatuese, Komisioni, me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2020, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit

Gjyqësor Berat, vënien në dispozicion të kopjes së dosjes gjyqësore që i përket vendimit të kësaj gjykate, si dhe me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2020, Gjykatës së Apelit Vlorë për vënien në dispozicion të vendimit nr. ***, datë 6.12.2012, e cila me shkresën nr. ***, prot., datë 6.7.2020, ka vënë në dispozicion vendimin nr. ***, datë 6.12.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Ndërkohë që me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat kishte vënë në dispozicion kopje të dosjes që i përket procedimit penal kundër shtetasit A. (F) B., si dhe vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e vendimit nr. ***, datë 6.12.2011, ku në përfundim ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 19.7.2011, të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat” dhe ka pezulluar ekzekutimin e vendimit në fjalë. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 11.7.2013, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokuroria e Apelit Vlorë, kundër vendimit nr. ***, datë 6.12.2011, të Gjykatës së Apelit Vlorë”.

285. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues çmon se pezullimi i ekzekutimit të dënimit në fjalë është vendosur në përputhje me dispozitat e neneve 59 dhe 60 të Kodit Penal. Për rrjedhojë, për sa kohë nuk konstatohen shkaqe penguese për urdhërimin e këtij pezullimi dhe nuk rezultojnë as shkelje procedurale apo cenim i të drejtave të palëve ose vendimmarrje me mungesë arsytimi, apo të keqarsyetuar, nuk konstatohen problematika që mund të lidhen me veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit. Për sa më lart, ndryshe nga sa përshkruhej nëpërmjet informacioneve të lartpërmendura, përpos dyshimeve që mund të ngrihen nga analizimi i dokumentacionit që lidhet me këtë çështje, vlerësohet se nuk rezultojnë elemente konkretë apo rrethana specifike faktiko-procedurale, që mund të çojnë në konkluzionin se ka pasur ndonjë shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit, apo ndonjë favorizim evident e konkret i të pandehurit/dënuarit, nëpërmjet qasjes favorizuese, vlerësimit të gabuar të fakteve dhe/ose ndonjë vendimmarrjeje të paarsyetuar/pabazuar, të trupit gjykues në fjalë.

30. Lidhur me çështjen penale që i përket vendimit nr. *, datën 15.6.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë**

286. Komisioni iu drejtua Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2012, vuri në dispozicion vendimin nr. ***, datë 15.6.2010, të Gjykatës së Apelit Vlorë me të pandehur shtetasin V. B., akuzuar për veprën penale “shpërdorim të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese në dhënien e vendimit, ku në përfundim ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 21.4.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit V. B.” Nga shënimi në vendim evidentohet se Gjykata e Lartë, me vendimin nr.***, datë 27.9.2012, ka vendosur “Mospranimin e rekursit”.

286. Shtetasi V. B. akuzohej se kishte shpërdoruar detyrën e tij publike si kryetari i Bashkisë Himarë, duke urdhëruar heqjen dhe çmontimin e sinjalistikës rrugore në segmentin Llogora-Qeparo, pjesë e rrugës kombëtare Vlorë-Sarandë. Sipas këtij vendimi, nga dy urdhrat e lëshuar prej kryebashkiakut, ishin dëmtuar interesat shtetërore, duke konsumuar elementë të veprës penale “shpërdorim të detyrës”, e parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal, shoqëruar kjo me dëm financiar prej rreth 1,800,000 lekësh. Tabelat rrugore ishin vendosur në kuadrin e një projekti për zhvillimin e turizmit, i shtrirë në segmentin Vlorë-Sarandë, financuar nga Banka Botërore. Përmes këtyre tabelave, evidentoheshin objektet me vlerë historike, arkeologjike e turistike të zonës, mes të cilave plazhi i Dhërmiut, kalaja e Himarës, kalaja e Porto Palermos etj. Zyrtarisht, shtetasi V. B. kishte ngritur pretendimin se këto tabela ishin vendosur pa lejen e Bashkisë Himarë, e cila ka nën administrim territorin ku kalon ky segment i rrugës kombëtare dhe sipas tij, për tabelat duhej të merrej miratimi i KRRT-së së Bashkisë Himarë.
287. Gjykata e Apelit Vlorë, me trupë gjykues me relatores subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, pasi ka analizuar aktet në dosjen gjyqësore, ka çmuar se vendimi nr. ***, datë 21.4.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka qenë rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe vlerësimit jo të drejtë të provave dhe fakteve të dosjes gjyqësore. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Vlorë ka çmuar se vendimi duhet të priset dhe çështja duhet të pushohet për faktin se veprimet dhe mosveprimet e të pandehurit V. B. nuk përbëjnë vepër penale. Ajo ka vlerësuar se edhe nëse do të pranohej për një çast se veprimet e të pandehurit kanë pasur qëllim dëmtimin e tabelave, në bazë të nenit 15 të Kodit Rrugor, këto veprime konsiderohen kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë, por nuk konsiderohen vepër penale nga legjislati i penal.
288. Nga analizimi i vendimit nr. ***, datë 15.6.2010, i Gjykatës së Apelit - ndonëse vlerësimi i vendimmarrjes në themel nuk futet në tagrat e Komisionit - rezulton se vendimi i prishjes dhe pushimit nga Gjykata e Apelit Vlorë është marrë në zbatim të drejtë të dispozitave ligjore të nenit 428, të Kodit të Procedurës Penale, pasi në asnjë moment nuk duket se është vërtetuar përgjegjësia penale e të pandehurit dhe lidhja shkak-pasoje, si dhe nuk është provuar/vërtetuar përgjatë shqyrtimit gjyqësor se: (i) veprimet e të pandehurit nuk kanë qenë në kundërshtim me përmbushjen e detyrave funksionale të tij, veprime apo mosveprime, të cilat të sillnin pasoja të rënda të interesave të shtetit; (ii) i pandehuri kishte për qëllim shkatërrimin e pronës shtetërore; (iii) nuk u provua lidhja shkakësore midis dëmit dhe veprimeve/apo mosveprimeve të tij.
289. Nga analiza e dosjes gjyqësore në fjalë duket se përgjatë gjykimit ka rezultuar se i pandehuri V. B. kishte përmbushur vetëm detyrat funksionale në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit të qeverisjes vendore”, detyra funksionale këto të ngarkuara nga ligji¹¹⁹, pa u konstatuar ndonjë shkelje.

¹¹⁹ Ligji nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit të qeverisjes vendore”, si dhe Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, neni 15.

290. Nga sa më sipër, ndonëse bëhet fjalë për rrethana që lidhen për më tepër me themelin e çështjes, nga një analizë e përgjithshme, pa u fokusuar në thelbin e vendimmarrjes, nuk kanë rezultuar elemente që mund të ngrenë dyshime të arsyeshme mbi ndonjë favorizim apo shkelje procedurale, pasi konstatohet se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë, për prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe pushimit të çështjes, duket se së paku nga këndvështrimi procedural është marrë në zbatim dhe në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara nga neni 428 i Kodit të Procedurës Penale, pasi nuk janë provuar përgjegjësi penale të të pandehurit dhe janë evidentuar gjatë procesit shkaqe ligjore që nuk lejonin fillimin e procedimit, për aq kohë sa nuk janë provuar veprime apo mosveprime të ndërmarra në kundërshtim me ligjin apo me shpërdorimin e detyrës.
291. Lidhur me sa më lart, për sa kohë nuk rezultojnë shkelje procedurale apo vendimmarrje me mungesë arsytimi apo të keqarsyetuara, nuk duket se në këtë çështje rezultojnë elementë konkretë, apo rrethana specifike faktiko-procedurale, që mund të çojnë në konkluzionin se ka pasur ndonjë shkelje procedurale nga subjekti i rivlerësimit, mosrespektim i të drejtave të palëve apo ndonjë favorizim i të pandehurit nëpërmjet qasjes jo të duhur procedurale, apo vlerësimit të gabuar dhe/ose vendimmarrje favorizuese të trupit gjykues në fjalë.
292. Gjithashtu në datën 24.02.2021, ditë në të cilën u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Iliba Bezati, u depozituan 2 denoncime konkretisht, denoncimi i shtetasës E.T. dhe i shtetasit K.Sh. Në denoncimin e parë, shtetasja pretendon mbi përfitime në mënyrë të parregullt lidhur me regjistrimin e një pasurie të paluajtshme në ASHK- Berat si dhe më një kallzim penal mbi veprimtarinë institucionale të këtij të fundit, ku subjekti i rivlerësimit kishte qënë anëtare e trupës gjyqësore. Ndërsa denoncimi i dytë i shtetasit K. Sh. referonte disa rrethana familjare/shoqërore të subjektit të rivlerësimit, duke aluduar mbi një influencim të mundshëm pranë institucionit të KPK-së, por nuk evidentonte apo përshkruante shkelje ligjore konkrete.
293. Në vijim, Komisioni me procesverbalin e datës 25.02.2021, para nisjes së procesit të vendimmarrjes, mori në shqyrtim përmbajtjen e denoncimeve të lartëpërmenduarra dhe pas konsultimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, të administruar nëpërmjet postës elektronike nga Gjykata e Apelit Vlorë, nuk konstatoi ndonjë shkelje procedurale apo ligjore nga subjekti i rivlerësimit Iliba Bezati. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi mos pasjen e nevojës për riçeljen e hetimit administrativ, për sa kohë nuk u pa nevoja për kryerjen e hapave të tjerë hetimorë, duke mbajtur në konsideratë edhe dispozitën ligjore të nenit 49, pika 6, shkronja d, e ligjit 84/2016.
294. Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet lidhur me mënyrën e të punuarit (*modus operandi*) të subjektit, nuk kanë rezultuar problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale të subjektit të rivlerësimit.
295. Për rrjedhojë, në konkluzion, trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat e sipërpërshkruara, subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, bazuar në provat që disponon në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, trupi gjykues arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, duhet të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 1.3.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Lulzim HAMITAJ
Relator

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi